FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 64

Tiranë – E premte, 10 prill 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr.11459, datë 31.3.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3541
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 9.4.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model".....	3541
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 3.4.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.....	3542
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 16, datë 3.4. 2020	Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.....	3546
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020	Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura.....	3596
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156/1, datë 10.3.2020	Për ndalimin e të gjitha lëvizjeve të udhëtarëve drejt Italisë.....	3596
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156/2, datë 11.3.2020	Për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19.....	3596
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 164, datë 12.3.2020	Për mbylljen e bareve, restoranteve, lokaleve, *fast food* dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët.....	3597
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 165 datë 12.3.2020	Për mbylljen e kabineteve/klinikave dentare.....	3597

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 168, datë 12.3.2020	"Për ndalimin/kufizimin e lëvizjeve me mjetet e transportit".....	3598
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.168/1, datë 15.3.2020	Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit.....	3598
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.168/2, datë 18.3.2020	Për kufizimin e lëvizjes me automjetet private ose shtetërore të administratës publike.....	3599
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.173/1, datë 14.3.2020	Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Greqinë.....	3599
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.177/1, datë 16.3.2020	Për kufizimin e lëvizjes në zonat urbane.....	3599
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.177/2, datë 18.3.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 177/1 datë 16.3.2020 "Për kufizimin e lëvizjes në zonat urbane".....	3600
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.190, datë 19.3.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019.....	3600
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.193, datë 20.3.2020	Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë.....	3600
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.208, datë 30.3.2020	Për një ndryshim në urdhërin nr 193 datë 20.3.2020 "Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë".....	3601
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.216, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr.190, datë 19.3.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019".....	3602
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.217, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr.164, datë 12.3.2020 "Për mbylljen e bareve, restoranteve dhe lokaleve, *fast food* dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët".....	3602
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.218, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr.160, datë 11.3.2020 "Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në të gjithë strukturat publike dhe jopublike".....	3603

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.219, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 147, datë 9.3.2020, "Për nderprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe spitalin universitar "Shefqet Ndroqi"	3603
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 220, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 158, datë 11.3.2020, "Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës".....	3604
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 221, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr.165, datë 12.3.2020 "Për mbylljen e kabineteve/klinikave dentare".....	3604
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.222, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr.132, datë 8.3.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura".....	3604
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.223, datë 1.4.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 156, datë 10.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19".....	3605
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 26.3.2020	Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë.....	3605
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 26.3.2020	Mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë, 24.3.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19", të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore".....	3607
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 324/4, datë 6.4.2020	Për shpronësim me interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit tokë truall dhe ndërtesë që preken nga realizimi nga realizimi i objekteve "Rikostruksioni i shkollës 'Thanas Bozo', ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë", Bashkia Lushnje.....	3610

DEKRET
Nr. 11459, datë 31.3.2020

PËR LEJIMIN E LËNIES SE SHTETËSISE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqitpare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Anila Avni Kühnert (Pervizi)
2. Sofije Kostaq Prifti (Resuli)
3. Xhevit Myftar Nuha
4. Senada (Sonada) Aleksa Matanoviç (Marash/Maraš/Matanovic)
5. Bogdan Zlatko Matanoviç
6. Matija Zlatko Matanović (Matanoviç)
7. Jovana Zlatko Matanoviç
8. Geri Arsim Hasa
9. Elda Man Gelaj (Malaj)
10. Albjon Shkëlqim Gelaj
1. Fatmir Halit Vata
12. Lindita Xhavit Vata (Maloku)
13. Kevin Fatmir Vata
14. Adriana Thanas Duçellari (Zguri)
15. Besnik Osman Shehu
16. Majlinda Fatmir Jovani (Karagjozi)
17. Bellina Neritan Jovani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 282, datë 9.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.5, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET MODEL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun IV, të vendimit nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"4. Përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit edhe individët ose familjet:

a) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktekspertiza e thelluar;

b) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime të lehta strukturore ose dëmtime të moderuara jostrukturore ose çarje në muret ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktkonstatimi ose aktekspertiza e thelluar;

c) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve nuk kanë dëmtim strukturor ose kanë dëmtim të papërfillshëm deri në të lehtë jostrukturor, si çarje të lehta në mure ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktkonstatimi ose aktekspertiza e thelluar.

5. Masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, mënyra e përdorimit dhe monitorimi, sipas pikës 4, të këtij vendimi, përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila, në të gjitha rastet, nuk duhet të jetë më shumë se:

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës "a", të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi;

b) 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi;

c) 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës "c", të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse të grantit, shuma e grantit të përfituar, sipas përcaktimeve të kësaj pike, i kalon përfituesit në një llogari bankare pranë një banke të nivelit të dytë.".

b) Pika 6 shfuqizohet.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bashkitë Tiranë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Kamzë, Vorë, Shijak, Krujë, Kurbin, Mirëditë dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 15, datë 3.4.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.01.2006 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën 2.4 "Të ardhura të përjashtuara", pas nënpikës 10 shtohet nënpika 10.1 me këtë përmbajtje:

1. "10.1 Të ardhurat e përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë për banesën dhe/ose truallin, brenda lidhjes gjinore në familje, bashkëshort, bashkëshorte, fëmijë, vetëm një herë ndaj një përfituesi, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria.

Në momentin e dhurimit, përveç aktit të dhurimit ose të heqjes dorë për kalimin e së drejtës të pronësisë së banesës dhe ose truallit, duhet të paraqitet dhe depozitohet pranë noterit, dokumenti/vërtetimi që provon lidhjen gjinore në familje ndërmjet palëve që mund të jenë bashkëshort/bashkëshorte, prind/fëmijë dhe anasjelltas.

Vlera e banesës dhe/ose truallit të dhuruar dhe/ose të përfituar nga heqja dorë e pasurisë brenda lidhjes gjinore në familje, për qëllime të llogaritjes së të ardhurës personale të përjashtuar nga tatimi sipas nenit 8.1 pika 11.1 të ligjit, është çmimi minimal fiskal i përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", në momentin e dhurimit. Nëse çmimi i banesës/truallit të regjistruar në regjistrin kadastral sipas aktit përkatës noterial në momentin që është blerë/përfituar kjo pasuri nga dhuruesi, është më i madh se çmimi minimal fiskal në momentin e dhurimit/heqjes dorë nga pasuria, atëherë vlera e banesës/truallit është vlera sipas aktit të regjistruar në regjistrin kadastral.

Kjo e ardhur nga dhurimi brenda lidhjes gjinore për banesën dhe/ ose truallin, është e përjashtuar vetëm një herë për një përfitues."

2. Në nënpikën 2.8.1.3 pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Ky përjashtim nuk zbatohet për individët rezidentë ose jorezidenë të cilët janë të punësuar në më shumë se një punëdhënës. Këta individë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruara nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat, zbresin, kur është rasti, tatimin e mbajtur nga punëdhënësi dhe përcaktojnë shumën e detyrimit tatimor që duhet të paguajnë për buxhetin e shtetit. Ky parashikim zbatohet për individët të cilët kanë përfituar të ardhura nga punësimi nga më shumë se një punëdhënës duke filluar nga 1 janari 2020. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve asiston në çdo rast për përllogaritjen e tatimit për individët që realizojnë të ardhura nga punësimi në më shumë se një punëdhënës dhe me qëllim asistencën e tatimpaguesve, publikon në websit-in e saj një

tabelë në format Excel-i që shërben si shembull llogaritje për çdo situatë.

Shembull

Supozojmë se individi "X" është i dypunësuar në dy subjekte, për të njëjtën periudhë tatimore (viti fiskal 2020).

-Paga bruto mujore e individit, nga puna në subjektin "A", është 60.000 lekë

-Paga bruto mujore e individit, nga puna në subjektin "B", është 30.000 lekë.

*Subjekti "A", për të ardhurat nga paga në vlerën prej 60.000 lekë që i paguan si pagë bruto punëmarrësit, mban tatim në burim për të ardhurat nga paga në vlerën 3.900 lekë në muaj (60.000 -30.000) * 13% ose 46.800 lekë në vit (12*3.900 lekë). Ndërkohë që subjekti "B", për të ardhurat nga paga në vlerën prej 30.000 (tridhjetë mijë) lekë që i paguan si pagë bruto punëmarrësit, i llogarit punëmarrësit 0 lekë për tatim mbi të ardhurat nga paga, meqenëse paga bruto prej 30.000 lekë është në kufirin përjashtues sipas përcaktimeve të ligjit.*

Ky individ i dypunësuar duhet që, brenda datës 30 prill 2021, të plotësojë deklaratën vjetore të të ardhurave në të cilën të ardhurat mujore nga paga, do të llogariten si total i të ardhurave nga paga nga të gjitha burimet e punësimit të individit. Referuar shembullit që kemi supozuar, të ardhurat nga paga bruto mujore e individit, janë në total 90.000 lekë, dhe tatimi mbi të ardhurat nga paga llogaritet të jetë 7.800 lekë në muaj (90.000 -30.000) 13% ose 93.600 lekë në vit (12*7.800 lekë), ndërkohë që tatimi mbi të ardhurat nga paga që ky individ ka paguar për një vit është 46.800 lekë. Në këtë moment individit i lind detyrimi për pagimin e pjesës tjetër të tatimit mbi të ardhurat personale nga paga, i cili është 46.800 lekë (93.600-46.800) për periudhën tatimore të deklaratës."*

3. Në pikën 3.6 "Shpenzime të panjohura", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në shkronjën "k", pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për tatimpaguesit eksportues, përjashtuar prodhuesit me material porositësi, të cilët në 3 vitet e fundit kanë realizuar mbi 70 për qind të të ardhurave nga eksporti, shpenzimet e dokumentuara, të kryera për pjesëmarrje, prezantim në panaire apo ekspozita jashtë vendit, njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 3 për qind të qarkullimit vjetor."

Në shkronjën "m", paragrafi i dytë që fillon me "shpenzimet që tejkalojnë kufirin e përcaktuar në ligjin "Për sponsorizimet"…." deri në fund të tij ku fillon fjalia "shpenzimet për dieta …", ndryshon me këtë përmbajtje:

"Nuk njihen si shpenzime të zbritshme, për qëllime tatimore, shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar.

Tatimpaguesve, persona fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin, shuma e sponsorizuar u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit.

Në veçanti, tatimpaguesve, personave fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin, shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit dhe botimet e veprat letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore, artistike e sportive, u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit.

Për tatimpaguesit persona juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, të cilat janë brenda kufirit 5 % të fitimit para tatimit të parashikuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar, për efekt të përllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, këto sponsorizime janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme nuk lejohet.

Shembull

*Një tatimpagues ka rezultuar me fitim (të tatueshëm) përpara tatimit 1.000.000.000 lekë. Shpenzimet e sponsorizimit për atë vit financiar janë 40.000.000 lekë, pra 4 % të fitimit para tatimit e cila është më pak se norma e lejuar e sponsorizimit prej 5 % e fitimit para tatimit. Për llogaritjen e tatim fitimit vlera 40.000.000 lekë do të njihet si shpenzim i zbritshëm sa trefishi i shumës së sponsorizuar pra 120.000.000 lekë. Tatim fitimi i llogaritur për t'u paguar është 132.000.000 lekë (1.000.000.000-120.000.000 leke)*15%.*

Për të përfituar njohjen si shpenzime të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar, tatimpaguesi duhet të disponojë "Autorizimin e sponsorizimit" të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Për lëshimin e autorizimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve zbatohet procedura e mëposhtme:

Autorizimi i Sponsorizimit për njohjen si shpenzim të zbritshëm për efekt të tatimit mbi fitimin të sponsorizimit me trefishin e shumës se

sponsorizuar, jepet për sponsorizimet që kryhen për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës. Çdo ekip sportiv që vërteton se është pjesë e federatave sportive të njohura sipas legjislacionit në fuqi "Për sportin", mund të jetë subjekt i një sponsorizimi nga tatimpaguesit.

Dokumentacioni që paraqet tatimpaguesi sponsorizues në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për t'u pajisur me "Autorizimin e sponsorizimit" është si më poshtë:

1. Për përfituesin e sponsorizimit paraqet se:

a) merr pjesë ose ka të drejtë të konkurrojë në nivel amator ose profesionist sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 79/2017 datë 27.04.2017 "Për sportin" dhe është pjesë e federatave sportive;

b) ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi për sportet, prej të paktën 1 viti;

c) nuk ka detyrime tatimore të pashlyera;

ç) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e evazionit fiskale, mospagimit të detyrimeve tatimore apo falsifikimit të dokumenteve;

d) ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

dh) nuk është objekt i procedurave të falimentimit dhe/ose likuidimit apo ndonjë procedure tjetër të ngjashme;

e) nuk është pezulluar me vendim gjykate.

2. Për tatimpaguesin sponsorizues paraqet:

a) një deklaratë në të cilën angazhohet të japë sponsorizim për ekipin sportiv pjesë e federatës sportive që kërkon mbështetje financiare;

b) Kontratën e sponsorizmit midis sponsorizuesit dhe përfituesit;

c) dokumentacion bankar ku vërteton shumën e sponsorizimit të transferuar në llogarinë bankare të të sponsorizuarit;

d) në çdo rast, të njoftojë organet tatimore për shumat që transferon në vijim në kuadrin e 'Autorizimit të sponsorizimit".

3.Deklarime të tjera që shoqërojnë kërkesën e tatimpaguesit sponsorizues dhe të subjektit të sponsorizuar:

a) Sponsorizuesi dhe i sponsorizuari paraqesin një program mbi zhvillimin e sportit në të cilin parashikohen: nevojat për sponsorizim, përdorimi i fondeve të sponsorizimit gjatë vitit (duke evidentuar fondet që do të përdoren për zhvillimin, përmirësimin dhe rinovimin e infrastrukturës sportive evidentimin e talenteve dhe nevojat për trajnim, mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive), si dhe përfitimet që parashikohen të vijnë nga ky sponsorizim.

b) Deklaratën e të sponsorizuarit dhe sponsorizuesit, me anë të së cilës garantojnë vërtetësinë e të dhënave të dokumenteve dhe deklarimeve të paraqitura në aplikim;

c) Autorizimin me shkrim nga sponsorizuesi dhe i sponsorizuari, që pranojnë autoritetet tatimore për të kryer të gjitha verifikimet dhe kontrollet e nevojshme dhe në çdo kohë me qëllim garantimin e ligjit dhe të rregullave të përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë mbi sponsorizimet;

ç) Vetëdeklarim se sponsorizuesi dhe i sponsorizuari nuk janë në një situatë apo rrethanë të konfliktit të interesit.

d) Dokumentacioni dhe/ose vërtetimet e kërkuara më sipër paraqitet në format origjinal ose kopje të noterizuara provuese të dokumentacionit të kërkuar.

Dhënia e "Autorizimit të sponsorizimit"

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 30 ditëve nga paraqitja e të dhënave të plota të kërkuara. Pas shqyrtimit të dokumentacionit vendos ose jo të miratojë dhënien e "Autorizimit të sponsorizimit"

Aplikimi për marrjen e "Autorizimit të sponsorizimit" refuzohet nëse:

a)Vërtetohet se aplikuesi nuk plotëson të gjithë kërkesat sipas procedurës së përcaktuar në këtë udhëzim; ose

b)Nga verifikimet dhe kontrollet të cilat mund të kryhen në çdo kohë tek sponsorizuesi dhe i sponsorizuari, vërtetohet se palët kanë paraqitur informacione, të dhëna apo dokumentacione të pavërteta në lidhje me informacionet, të dhënat apo dokumentacionin e kërkuar."

Njohja si shpenzim i zbritshëm zbatohet pas lëshimit të "Autorizimit të sponsorizimit" nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, procedurë e cila nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë kalendarike nga momenti i aplikimit, sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzimin."

Pas shkronjës "t", shtohet shkronja "u" me këtë përmbajtje:

"u. Shpenzimet për donacione të cilat tejkalojnë nivelin 5% të fitimit para tatimit, në rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore" dhe

brenda afatit të përcaktuar, të dhëna në mjete monetare të transferuara në llogaritë e thesarit, apo të dhëna në formën e pasurive të paluajtshme sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Në rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", kur tatimpaguesit japin donacione të parashikuara sipas germës "p" të pikës 1, të nenit 21 të ligjit, por edhe sponsorizime sipas germës "j" të pikës "1" të nenit 21 të ligjit, konsiderohen si shpenzime jo të zbritshme shumat që tejkalojnë përkatësisht nivelin 5 % dhe 3% të fitimit para tatimit."

4. Në pikën 3.11 "Mbartja e humbjeve", pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për tatimpaguesit, të cilët investojnë mbi 1 miliard lekë në aktive afatgjata materiale që shërbejnë për aktivitete te tatueshme, në rast se fitimi i tatueshëm në një periudhë tatimore rezulton negativ, humbjet e rezultuara dhe të njohura nga organet tatimore mund të mbarten në pesë periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit "humbja e pare më përpara se ajo e fundit".

Këta tatimpagues në momentin e dorëzimit të pasqyrave financiare brenda datës 31 mars duhet të paraqesin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore dokumentacionin përkatës që provon se vlera e investimit është mbi 1 miliard lekë dhe mbartja e humbjes është ushtruar në përputhje me parashikimet e këtij paragrafi. Dokumentacioni që shërben për vërtetimin e vlerës së investimit është sipas rastit, pasqyrat financiare të audituara nga auditues ligjorë, shoqëruar me kontratat e investimeve, planin e investimit, projektet e miratuara nga organet përkatëse, nëse kërkohet miratimi për realizimin e investimit, si dhe argumentimin e ndryshimit të llogarive përkatëse (zërave të bilancit) të aktiveve afatgjata materiale, për të provuar që shoqëria është në procesin e realizimit të investimit. Ky dokumentacion do të paraqitet për çdo vit ushtrimor deri kur të arrihet vlera e kërkuar e investimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore verifikon që mbartja e humbjes është kryer për 5 vite vetëm për tatimpaguesit, investimet e të cilëve kalojnë vlerën 1 miliard lekë."

5. Në pikën 3.11/1 "Ndryshimi i pronësisë", pas fjalisë së fundit "Pika 5 e nenit 27/1 përcakton referencën në ligjin…", shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Bazuar në pikën 6 të nenit 27/1 të ligjit, përcaktimet e mësipërme në këtë udhëzim, zbatohen në çdo rast, përveç kur ndryshimi i pronësisë (kapitalit aksionar, kuotave ose e të drejtave të votimit të një personi juridik) i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjeve të ratifikuara për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi.

6. Në fund të pikës 3.12 shtohet fjalia me përmbajtjen:

"Gjithashtu tatimpaguesi dorëzon brenda datës 31 mars, inventarin analitik të mallrave, si dhe inventarin e aktiveve afatgjata gjendje deri më datë 31 dhjetor të vitit fiskal sipas formularit bashkëlidhur këtij udhëzimi".

7. Në pikën 5.5, në fjalinë "Për faturat e palikuiduara për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit...", togfjalëshi "brenda datës 20 dhjetor të periudhës tatimore", zëvendësohet me togfjalëshin "në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën q) të pikës 3.6 të këtij udhëzimi."

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

FORMULARI I AKTIVEVE AFATGJATA

PËR NDËRTESAT												
Nr.	NIPT	Emri I Tatimpaguesit	Lloji i pasurisë	Zyra e regjistrimit	Zona Kadastrale Nr.	Numri i Pasurisë	Adresa e pasurisë	Siperfaqja	era kontab	Vlera sipas rregjistrimit	Pronari i pasurisë	Bashkpronaret e pasurise.
1												
2												
3												
4												
5												

PËR MAKINAT												
Nr.	NIPT	Emri I Tatimpaguesit	Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Pronësia	Leje qarkullimi	Kapaciteti	Vlera kontabël	Vlera e mjetit e rregjistruar	Viti i prodhimit	Bara siguruar e mjetit.
1												
2												
3												
4												
5												

UDHËZIM
Nr. 16, datë 3.4. 2020

PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT

Në zbatim të nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", ministri i Financave dhe Ekonomisë udhëzon:

Neni 1
Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për lëshimin e faturës dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit, në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 87/2019, datë 18.12.2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" (më tej referuar si "Ligji"). Ky udhëzim synon unifikimin dhe vendosjen e standardeve bashkëkohore për të garantuar trajtim të drejtë, të barabartë dhe të paanshëm, si dhe transparencë në zbatimin korrekt dhe të duhur të procedurave dhe rregullave uniforme të përcaktuara nga Ligji.

Rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim kanë për qëllim të sqarojnë kuptimin e dispozitave të Ligjit, të sigurojnë zbatimin e tyre të saktë dhe të njëtrajtshëm, si dhe të inkurajojnë respektimin vullnetar nga ana e tatimpaguesit nëpërmjet edukimit të tij.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Sipas nenit 2 të Ligjit, dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura në përputhje me Ligjin dhe legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe përcaktojnë detyrimet për lëshimin e faturës, zbatimin e procedurës së fiskalizimit në kohë, si dhe detyrime të tjera.

2. Ky udhëzim zbatohet nga organet publike, të cilët janë të detyruar të pranojnë faturat elektronike, në përputhje me nenin 25 të Ligjit, dhe nëse ato gjithashtu kryejnë veprimtari ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar për të cilat konsiderohen se janë persona të tatueshëm, zbatohen edhe detyrimet nga pika 1 e këtij neni.

3. Ky udhëzim zbatohet gjithashtu nga bankat, institucionet financiare jobanka dhe subjektet e tjera që ofrojnë shërbime pagese të faturave elektronike, sipas detyrimit të njoftimit të pagesave sipas nenit 37 të Ligjit, dhe kur kryejnë furnizime të tatueshme sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar për të cilin konsiderohet se janë persona të tatueshëm.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me terminologjinë e përdorur në ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin tatimor në fuqi.

Neni 4
Tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë

1. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura sipas nenit 4 të Ligjit janë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe/ose tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), përfshirë personat e tatueshëm, që i nënshtrohen regjimit (skemës) të bizneseve të vogla sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga

qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual.

Për shembull, bankat ose institucionet e tjera financiare jobanka konsiderohen gjithashtu si tatimpagues që lëshojnë fatura nëse i nënshtrohen tatimit mbi fitimin dhe nëse kryejnë veprimtari të tjera që nuk janë të përjashtuara nga detyrimi për lëshimin faturës, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. Organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projektit, organet publike qendrore dhe vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme duhet të lëshojnë faturë, nëse kryejnë veprimtari ekonomike.

3. Në mënyrë që të lëshojnë fatura dhe të kryejnë procesin e fiskalizimit, tatimpaguesit që lëshojnë fatura sipas nenit 4 të Ligjit, përpara fillimit të lëshimit të faturës, duhet:

a) të sigurojnë kushte për përdorimin e zgjidhjes software-ike, sipas nenit 21 të këtij udhëzimi dhe të marrin certifikatën elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

b) të japin informacione për të gjitha vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit në të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi, sipas nenit 17 të këtij udhëzimi;

c) të japin informacione për operatorët që lëshojnë fatura, sipas nenit 18 të këtij udhëzimi;

ç) të japin informacione për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike, sipas nenit 19 të këtij udhëzimi;

d) të regjistrojnë pajisjet elektronike të faturimit për lëshimin e faturave për pagesa me para në dorë, sipas nenit 17 të këtij udhëzimi.

4. Tatimpaguesi që lëshon faturë, përveç detyrimit që vjen nga pika 3 e këtij neni, me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, para fillimit të lëshimit të faturës, duhet të sigurojë gjithashtu:

a) lidhje të përhershme në internet;

b) zgjidhje të certifikuar software-ike, e cila realizon nënshkrimin elektronik duke përdorur një certifikatë elektronike, komunikimin në kohë reale me sistemin e informacionit të administratës tatimore qendrore me anë të krijimit dhe shkëmbimit të një mesazhi në format XML, si dhe printimin e faturës përfshirë kodin QR.

5. Tatimpaguesi që lëshon faturë, përveç detyrimit që vjen nga pika 3 e këtij neni, me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit për regjistrimin e shitjeve përmes pajisjeve të vetëshërbimit (automatët), siguron:

a) lidhje të përhershme në internet;

b) zgjidhje të certifikuar software-ike, e cila realizon nënshkrimin elektronik duke përdorur një certifikatë elektronike, komunikimin në kohë reale me sistemin e informacionit të administratës tatimore qendrore me anë të krijimit dhe shkëmbimit të një mesazhi XML bazuar në përmbajtjen e të dhënave të shitjeve.

6. Kur personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është një person i tatueshëm, që nuk është i vendosur dhe i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, vend në të cilin duhet të paguhet TVSH-ja dhe kur shërbimi i ofrohet një personi të patatueshëm, personi jorezident duhet të caktojë një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë si person përgjegjës për pagesën e TVSH-së. Në këtë rast, përfaqësuesi tatimor është përgjegjës për lëshimin e faturave dhe për kryerjen e procedurave të fiskalizimit, sipas Ligjit dhe udhëzimit.

Për shembull, një tatimpagues i huaj, jorezident në Republikën e Shqipërisë është i detyruar të lëshojë një faturë dhe të zbatojë procedurën e fiskalizimit kur ofron shërbime për personin e patatueshëm që banon në Republikën e Shqipërisë, kur sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar është i detyruar të paguajë TVSH-në në Republikën e Shqipërisë për ato transaksione, nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor.

Një tatimpagues jorezident, i cili ka regjistruar një përfaqësues tatimor në Shqipëri për deklarimin dhe pagesën e TVSH-së, i furnizon shërbime një enti publik jo-tatimpagues TVSH-je në Shqipëri. Faturën e fiskalizuar për këto furnizime e lëshon përfaqësuesi tatimor i regjistruar në Shqipëri. Nëse enti publik është regjistruar vetë si person i tatueshëm për TVSH-në, faturën e lëshon dhe e fiskalizon vetë enti publik person i tatueshëm.

Nuk është i detyruar të lëshojë faturë dhe ta fiskalizojë atë në bazë të Ligjit kur blerësi, i cili është një tatimpagues rezident në Shqipëri, është i detyruar të paguajë TVSH-në (pra kur aplikohet auto-ngarkesa), meqë në këtë rast vetë blerësi do të lëshojë faturën (autongarkesë) dhe është vetë blerësi që kryen procedurën e fiskalizimit të faturës.

7. Të gjithë tatimpaguesit, rezidentë ose jorezidentë, pavarësisht nga forma e organizimit, duhet të lëshojnë faturë kur furnizojnë mallra ose shërbime për organet publike, përveç:

a) kur ky tatimpagues përjashtohet nga detyrimi për të lëshuar faturë, sipas nenit 5 të Ligjit;

b) kur organi publik është subjekt i TVSH-së dhe ka detyrimin të lëshojë faturë si blerës, pra marrësi i mallrave ose shërbimeve, sipas nenit 7,

pika 2, të Ligjit dhe sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Për shembull, një kompani botuese e themeluar në Itali i shet libra një bashkie në Shqipëri. Në këtë rast fatura e shitësit, shkëmbehet ekektronikisht dhe shërben si dokument në procedurat e zhdoganimit.

Një kompani tjetër e themeluar në Itali i bën shërbime këshillimi dhe trajnimi një fondacioni publik të krijuar nga ligji në Shqipëri, i cili ushtron veprimtari ekonomike për të cilën është regjistruar në regjistrin e TVSH-së. Për këtë shërbim të marrë nga tatimpaguesi jorezident, fondacioni publik është i detyruar të lëshojë faturën (autongarkesë), sipas nenit 7, pika 2, të Ligjit.

Neni 5

Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë

1. Sipas nenit 5 të Ligjit, tatimpaguesit të cilët përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar dhe fiskalizuar fatura për furnizimet që kryejnë, janë si më poshtë:

a) prodhuesit bujqësorë, nëse janë ose jo, subjekte të skemës së kompensimit në përputhje me ligjin e TVSH-së;

b) tatimpaguesit që shesin bileta ose abone për transport pasagjerësh në sektorin e transportit publik urban brenda qytetit (autobusë) në përputhje me vendimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, nëse kjo biletë ose abone i shitet pasagjerëve direkt nga drejtuesi i mjetit ose nga një person i autorizuar;

c) personat fizikë të regjistruar në Administratën Tatimore si "ambulantë".

2. Sipas nenit 97 të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, lëshimi i një fature nuk kërkohet në rastin e furnizimeve të shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas shkronjave nga "a" në "e", të nenit 53, të këtij ligji.

Për shembull, bankat dhe institucionet e tjera jo-financiare nuk janë detyruara të lëshojnë faturë për ofrimin e shërbimeve të përjashtuara sipas ligjit për TVSH-në.

3. Personave, të cilëve u referohen pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk kanë detyrimin që të regjistrojnë vendin e ushtrimit të aktivitetit të biznesit, operatorët, prodhuesin dhe mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike, ose të përmbushin ndonjë detyrim tjetër, sipas Ligjit. Sidoqoftë, nëse përveç këtyre aktiviteteve të përjashtuara kryejnë edhe veprimtari të tjera për të cilat janë të detyruar të lëshojnë një faturë në bazë të Ligjit, atëherë janë të detyruar të lëshojnë fatura dhe të zbatojnë procedurën e fiskalizimit për ato aktivitete të tjera, jo të përjashtuara dhe të përmbushin të gjitha detyrimet bazuar në Ligj. Tatimpaguesit e referuar në pikën 1, shkronja "b" duhet të njoftojnë administratën tatimore për shumën totale të biletave të shitura gjatë çdo dite për të cilat nuk është lëshuar dhe fiskalizuar faturë individuale, në formën e faturës përmbledhëse të fiskalizuar, jo më vonë dhe para fundit të ditës tjetër, për llogaritjen e TVSH-së dhe detyrimeve të tjera tatimore, si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera sipas Ligjit.

4. Kur individi kryen një shitje rastësore, për shembull kryerja e një shërbimi të rastësishëm dhe jo të përsëritur tek një tatimpagues, shet ar ose send tjetër personal, nëse transaksioni përbën thjesht ushtrimin e të drejtës së pronësisë nga mbajtësi i tij dhe nuk është i regjistruar në regjistrin tregtar, atëherë blerësi, i cili është tatimpagues që lëshon fatura, lëshon autofaturë pa llogaritur TVSH-në në rastin e blerjeve nga individë të paregjistruar.

Neni 6

Rregulla të përgjithshme për lëshimin e faturës

1. Sipas nenit 6 të Ligjit, çdo tatimpagues duhet të lëshojë faturë për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve. Fatura duhet të lëshohet nga tatimpaguesi që ka bërë furnizimin, por gjithashtu mund të lëshohet në emrin e tij dhe për llogari të tij nga marrësi i mallrave dhe shërbimeve, pra blerësi (vetëfaturim) ose nga një palë e tretë e autorizuar (për shembull kontabilisti).

2. Tatimpaguesi duhet të lëshojë një faturë për:

a) furnizimet me mallra dhe shërbime që i janë kryer një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) çdo pagesë paraprake që merr përpara se të bëhen furnizimet e lartpërmendura të mallrave;

c) çdo pagesë paraprake për shërbimet që merr përpara se të përfundojnë apo kryhen shërbimet;

ç) furnizimet me mallra të dërguara drejt një vendi tjetër (eksport);

d) çdo furnizim tjetër të mallrave dhe shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë (për shembull zbatohet për individët - konsumatorë të fundit).

3. Rregullat për fiskalizimin e faturave të lëshuara nga jorezidentët në Republikën e Shqipërisë:

a) personat pa adresë të përhershme në Republikën e Shqipërisë (jorezidentët) dhe të pa regjistruar në regjistrin tregtar janë të detyruar, që nëpërmjet përfaqësuesit tatimor të lëshojnë dhe fiskalizojnë faturat nëse detyrimi për pagesën e TVSH-së lind në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

b) nëse kompania jorezidente ka një degë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë:

i. dega e regjistruar në Republikën e Shqipërisë duhet të lëshojë dhe fiskalizojë faturat;

ii. përjashtimisht kur dega që furnizuesi ka në Republikën e Shqipërisë nuk merr pjesë në atë furnizim, atëherë zbatohet përcaktimi sipas shkronjës "a" të kësaj pike.

4. Administrata tatimore kontrollon përmbushjen e kushteve për zbritje ose përjashtime të tatimeve dhe/ose taksave në bazë të faturave të fiskalizuara, në përputhje me legjislacionin tatimor përkatës.

5. Faturat për shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve janë dokumentet bazë ku bazohen regjistrimet e mëtejshme për llogaritjet e detyrimeve tatimore.

Neni 7

Rregulla të veçanta për lëshimin e faturës

1. Tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë një faturë dhe ta fiskalizojë atë për përdorimin e mallrave që janë pjesë e pasurisë së biznesit, për qëllim privat të tij apo të stafit të tij, apo për qëllime të ndryshme nga ato të veprimtarisë së tij ekonomike, në qoftë se ka zbritur tërësisht apo pjesërisht TVSH-në në blerje të këtij malli apo elementeve që përbëjnë mallin dhe duhet të ngarkojë TVSH-në në atë furnizim, për furnizimin e mallrave të prodhuara, ndërtuara, nxjerra, përpunuara, blera ose furnizimin e shërbimeve gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij ekonomik për t'u përdorur për qëllime të këtij aktiviteti ose furnizimeve të tjera të ngjashme, për rastet e vetëfurnizimeve sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. Në rastet kur blerësit lëshojnë fatura, në marrëveshje me shitësin ose kur kjo është e detyrueshme sipas nenit 7, pika 2, të Ligjit, atëherë blerësi kryen edhe procedurën e fiskalizimit të faturës së lëshuar. E njëjta gjë vlen edhe kur fatura lëshohet nga një person i tretë i autorizuar ose nga përfaqësuesi tatimor.

3. Në rastet e furnizimeve rastësore të marra nga individë të ndryshëm që nuk kanë cilësinë e tregtarit, përfshirë prodhuesit bujqësorë që nuk janë pjesë e skemës së kompensimit, tatimpaguesi (pra blerësi) lëshon një autofaturë pa llogaritur TVSH-në. Kjo faturë duhet të vërtetohet nga individi furnizues nëpërmjet nënshkrimit dhe të dhënave të tjera identifikuese të tij si emër/mbiemër dhe numër personal identifikimi, të cilat duhet të regjistrohen në faturë. Tatimpaguesi, si marrës i furnizimit është i detyruar që të shënojë në faturën e përgatitur për veten e tij edhe NIPT-in e tij. Fatura e lëshuar nga blerësi, person i tatueshëm si subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, është dokumenti që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Për shembull, një shoqëri tregtare paguan një individ vendas ose të huaj (që nuk është i regjistruar në organet tatimore shqiptare) për një shërbim rastësor konsulence, përkthimi dhe shërbime të ngjashme, etj. Në këtë rast, shoqëria përfituese e shërbimit përpilon një faturë me të dhënat identifikuese të individit shitës të shërbimit, vlerën e shërbimit dhe tatimin që mbahet në burim të llogaritur për pagesën e këtij shërbimi.

Neni 8

Momenti i lëshimit të faturës

1. Bazuar në nenin 8 të Ligjit, fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) në rastin kur blerësi ose marrësi i mallrave apo shërbimeve lëshon një autofaturë pa llogaritur TVSH-në për mallrat ose shërbimet e blera nga individë që nuk janë tregtarë dhe nuk janë të regjistruar në administratën tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura, si dhe për mallrat e blera nga prodhuesit bujqësorë, fatura lëshohet nga blerësi menjëherë në kohën e dorëzimit të mallrave ose ofrimit të shërbimeve;

b) në rast se blerësi ose marrësi i shërbimeve lëshon një faturë autongarkesë për shërbimet e ofruara nga një person i tatueshëm jorezident, për

furnizimet e shërbimeve për të cilat TVSH-ja është e pagueshme nga marrësi i furnizimit, sipas paragrafit 2, të nenit 86, të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, fatura lëshohet nga blerësi jo më vonë se dita e 10-të e muajit pas muajit në të cilin është bërë shërbimi (përveç rastit kur fatura lëshohet nga shitësi në formë elektronike dhe shkëmbehet me blerësin përmes platformës qendrore të faturave).

Edhe nëse fatura lëshohet nga blerësi, për shembull në 8 maj, por ka lidhje me shërbimet e marra në prill, kjo faturë do të përfshihet në librat e tij të blerjes dhe shitjes, dhe në deklaratën e TVSH-së për muajin prill.

c) në rastin kur blerësi parapaguan, përpara kryerjes së furnizimit të mallrave ose shërbimeve nga shitësi, atëherë shitësi duhet të lëshojë faturën menjëherë, por jo më vonë se 72 orë pas marrjes së pagesës. Pra, pasi paratë janë paguar dhe janë të disponueshme në llogarinë bankare të shitësit, shitësi ka 72 orë kohë për t'i lëshuar një faturë blerësit.

Për shembull, nëse blerësi i ka paguar shitësit përmes llogarisë së tij bankare në datën 1 maj dhe shitësi e merr atë në llogarinë e tij bankare në 4 Maj, atëherë shitësi duhet të lëshojë faturën jo më vonë se data 7 Maj.;

ç) nëse mallrat furnizohen pa transport, atëherë shitësi duhet të lëshojë faturën në momentin kur mallrat i janë vënë në dispozicion blerësit.

Për shembull, nëse mallrat shiten direkt në dyqan, fatura duhet të lëshohet menjëherë kur blerësi merr mallin.

Nëse mallrat furnizohen me transport, atëherë shitësi duhet të lëshojë një faturë menjëherë përpara se të kryhet transporti, pasi fatura duhet të shoqërojë transportin e mallrave nga burimi në destinacionin e tij.

Në situatën e "shitjes derë më derë" kur shitësi nuk e di saktësisht se cili blerës dhe cili artikull do të blihet në vend, duhet të lëshojë faturën e shitjes në momentin kur shet mallrat tek blerësi;

d) një faturë gjithashtu mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime të mallrave ose shërbimeve të ofruara në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, të realizuara ndërmjet tatimpaguesit që lëshon fatura dhe klientit të tij, gjatë të njëjtit muaj kur janë kryer furnizimet. Në këtë rast, fatura duhet të lëshohet çdo muaj, jo më vonë se dita e 10-të e muajit që pason muajin në të cilin është kryer furnizimi dhe të regjistrohet në librat e shitjes së muajit të cilit i përket furnizimi.

Sidoqoftë, një faturë periodike nuk mund të lëshohet për furnizimet e kryera në bazë të procedurave të prokurimit publik, kur duhet të lëshohet një faturë elektronike, e cila duhet të lëshohet pas çdo dorëzimi të mallrave ose shërbimeve, siç është rënë dakord nga palët në marrëveshje;

dh) personi i tatueshëm që kryen një furnizim shërbimesh është i detyruar të lëshojë një faturë për furnizimin në momentin e kryerjes së shërbimit.

2. Për furnizime të shërbimeve sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të tilla si shërbimet e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike, por jo vetëm, për persona të patatueshëm, që kanë adresën e tyre të përhershme ose banojnë në Republikën e Shqipërisë, furnizuesi i huaj nëpërmjet përfaqësuesit të tij tatimor në Republikën e Shqipërisë lëshon fatura për furnizimet e shërbimeve të kryera për çdo blerës, person të patatueshëm dhe zbaton procedurën e fiskalizimit në përputhje me Ligjin në momentin e furnizimit. Përfaqësuesi tatimor është personalisht përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet për të cilat detyrohet personi i përfaqësuar, përfshirë detyrimin për të lëshuar faturat për çdo blerës sipas procedurës së fiskalizimit.

Shembull

Gjatë muajit tetor, një furnizues i huaj i vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë furnizon shërbime elektronike (aplikacione, lojëra elektronike, software, shërbime database, web-hosting etj.) ndaj personave të patatueshëm në Shqipëri, të cilët kryejnë online pagesën nëpërmjet instrumenteve të ndryshme të pagesës online. Përfaqësuesi tatimor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim përmbushjen e detyrimit të personit të përfaqësuar, lëshon faturë për çdo person të patatueshëm (i identifikuar sipas të dhënave të instrumentit të pagesës, por jo vetëm), jo më vonë se data 10 nëntor (duke referuar periudhën e faturimit 1-31 tetor), si dhe duke ngarkuar në këtë mënyrë TVSH-në e pagueshme për furnizimet e tatueshme në Shqipëri për muajin tetor, për çdo furnizim shërbimi të kryer. Fatura lëshohet nga përfaqësuesi tatimor për blerësin e shërbimit, person i patatueshëm dhe i nënshtrohet rregullave të fiskalizimit sipas parashikimeve të Ligjit dhe këtij udhëzimi, si dhe regjistrohet në librin e shitjeve të muajit tetor.

3. Në rastin kur tatimpaguesi që lëshon fatura kryen veprimtari të ndryshme në të njëjtën adresë (për shembull një hotel i cili ka edhe një restorant, SPA, klub nate etj.) dhe klienti paguan për të gjitha

shërbimet (për shembull për një natë akomodimi, përdorimin e SPA-së, konsumimi në restorant etj.) në momentin e largimit, atëherë tatimpaguesi që lëshon faturë, duhet të lëshojë fatura/porosi të veçanta për çdo furnizim me mallra ose shërbime dhe në çdo faturë detyrimisht të vendosë si mënyrë pagese "porosi" dhe titullin në faturë "Faturë tatimore/porosi". Kur klienti paguan, (për shembull në momentin e largimit) tatimpaguesi duhet t'i lëshojë atij një faturë përmbledhëse me referencë të gjitha faturat e veçanta të lëshuara dhe fiskalizuara, si dhe të përfshira në faturën përmbledhëse (pra të përfshijë NSLF-të e secilës faturë të veçantë). Faturat e veçanta të referuara në faturën përmbledhëse, nuk do të regjistrohen në librin e shitjeve të tatimpaguesit. Fatura përmbledhëse do të regjistrohet në librin e shitjeve dhe do të merret në konsideratë për qëllim të llogaritjes së TVSH-së.

Shembull

Një klient mbërrin dhe rezervon një dhomë në hotel më datë 25 maj dhe largohet nga hoteli më datë 5 qershor. Gjatë kësaj kohe merr shërbime nga restoranti, sauna, SPA etj., shërbime të cilat i ngarkon për ti likuiduar në faturën e hotelit. Për faturat e veçanta të lëshuara për çdo shërbim nga data 25 maj deri në 5 qershor, në datën 5 qershor do të lëshohet një faturë përmbledhëse që do të regjistrohet në librin e shitjeve të muajit qershor, e cila do të merret në konsideratë për llogaritjen e TVSH-së në shitje për muajin qershor (moment në të cilin shërbimi është kryer dhe është lëshuar fatura përmbledhëse). Fatura përmbledhëse e shërbimeve të hotelit, përmban shumën totale të llogaritur për të gjitha faturat e veçanta që janë lëshuar për çdo shërbim të kryer prej hotelit deri në momentin e largimit të klientit, prej hotelit. Është e rëndësishme që fatura përmbledhëse të referojë të gjitha faturat e veçanta të lëshuara klientit.

Nëse për shërbimet e veçanta që klienti ka marrë gjatë qëndrimit në hotel, klienti ka likuiduar faturën në momentin e kryerjes së shërbimit dhe nuk ia ka ngarkuar faturës së qëndrimit në hotel, për shembull ka marrë shërbimin e restorantit në 30 maj dhe e ka likuiduar faturën e fiskalizuar, atëherë kjo faturë do të regjistrohet në librin e shitjeve të muajit maj, muaj në të cilin është lëshuar fatura. Këto shërbime nuk përfshihen në faturën përmbledhëse që i lëshohet klientit në momentin e kryerjes së shërbimit të hotelit në datën 5 qershor kur ai largohet nga hoteli.

Përjashtimisht, nëse në momentin e rezervimit të hotelit ose në momentin e mbërritjes së klientit në hotel (data 25 maj ose më parë) është arkëtuar parapagim i plotë ose i pjesshëm prej hotelit, fatura e fiskalizuar me TVSH-në përkatëse lëshohet në momentin e arkëtimit të parapagimit sipas përcaktimeve në Ligj dhe në këtë udhëzim, si dhe deklarohet në librat e shitjes dhe blerjes në muajin në të cilin është arkëtuar parapagimi (maj ose me parë në varësi të datës kur është arkëtuar parapagimi). Në këtë rast në momentin kur lëshohet fatura përmbledhëse (5 qershor) për shërbimin e kryer, stornohet vlera e faturës së fiskalizuar në momentin e parapagimit (25 maj) dhe llogaritet dhe deklarohet TVSH-ja për vlerën shtesë pas stornimit.

Për tatimpaguesit, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës bar-kafe, restorant, mensa, ku konsumohen pije dhe ushqime, lëshimi i faturës duhet të bëhet në të njëjtin moment me furnizimin e porosisë për klientin. Me porosi të kryer nuk kuptohet porosia nga çdo person, por porosia e kryer për çdo tavolinë. Ndërkohë, nëse klientët nga e njëjta tavolinë kryejnë një porosi të dytë, atëherë me dorëzimin e porosisë lëshohet dhe fatura e dytë, e cila edhe mund të mos printohet. Përgjithësisht, nëse klienti nuk paguan menjëherë për çdo porosi, por paguan totalin e porosive në momentin e largimit, atëherë çdo faturë e veçantë e lëshuar për çdo porosi duhet të ketë si metodë pagese të shënuar "porosi" dhe titulli në faturë duhet të jetë "Faturë tatimore/porosi". Në momentin e largimit të klientit, në të cilin kryhet edhe pagesa, tatimpaguesi duhet t'i lëshojë klientit një faturë përmbledhëse dhe ta fiskalizojë atë, e cila të përmbajë si referencë dhe të përfshira në të, të gjitha faturat e veçanta të lëshuara dhe të fiskalizuara (pra NSLF-të e secilës faturë të veçantë). Fatura përmbledhëse e fiskalizuar, do të regjistrohet në librin e shitjeve të tatimpaguesit dhe do të merret në konsideratë për qëllim të llogaritjes së TVSH-së në shitje. Në këtë rast, çdo faturë/porosi e veçantë dhe fatura përmbledhëse duhet të fiskalizohen në momentin e lëshimit.

4. Për qëllime të pikave 4, 5 dhe 6 të këtij neni, termat "tollon" dhe "tollon njëqëllimësh" kanë kuptimin:

"Tollon" kupton një instrument për të cilin ekziston detyrimi të pranohet si kompensim ose kompensim i pjesshëm për furnizimin e mallit ose shërbimit, me qëllim përdorimin e tij në një moment të mëvonshëm, kur realizohet furnizimi i mallit ose shërbimit. Të dhënat identifikuese të furnizuesit të mundshëm shënohen në këtë dokument përfshirë termat dhe kushtet e përdorimit të këtij instrumenti;

"Tollon njëqëllimësh (NjQ)" kupton tollonin ku vendi i furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ai është lëshuar, si dhe TVSH-ja për tu paguar për këto mallra dhe shërbime është deklaruar në momentin e lëshimit të tollonit.

Tatimpaguesit që furnizojnë ose rishesin tollonë me një qëllim përdorimi (tollon NjQ, për shembull tollonat për furnizimin me karburant), duhet të lëshojnë faturat dhe t'i fiskalizojnë kur lëshohet tolloni edhe për secilën rishitje të atij tolloni. Përshkrimi i mallrave të furnizuar në këto raste duhet të jetë "tollon me një qëllim për 'emrin dhe sasinë e mallrave ose shërbimeve' me numrin serial xxx", dhe në varësi të mënyrës së pagesës (me para në dorë ose jo) dhe llojit të transaksionit (midis dy tatimpaguesve, ose në transaksione me organin shtetëror, ose transaksione me individin) fatura duhet të printohet në letër ose të dërgohet në formë elektronike. Numri serial i tollonit do të jetë NIPT-i i lëshuesit, viti i lëshimit dhe numri rendor i tollonave të lëshuar gjatë atij viti.

5. Kur tolloni NjQ (i cili është deklaruar në shitje dhe është fiskalizuar në momentin që është shitur nga lëshuesi i tij ose rishitësi i tollonit) përdoret për furnizimin me mallra ose shërbime për konsumatorin përfundimtar, marrësi i tollonit (pra tatimpaguesi që furnizon mallra ose shërbime) lëshon dhe fiskalizon faturën dhe tek mënyra e pagesës, në mënyrë të detyrueshme, duhet të shtojë "Tollon NjQ" dhe numrin serial të tollonit. Kjo faturë në librin e blerjeve të blerësit dhe librin e shitjeve të shitësit nuk do të merret parasysh për llogaritjen e tatimit. Në rastin kur vlera e mallrave të furnizuara është më e madhe se vlera e tollonit, atëherë për çdo pagesë shtesë nga klienti përfundimtar mbi vlerën e tollonit do të deklarohet në të njëjtën faturë të lëshuar për furnizimin, pra shitësi nuk do të duhet të lëshojë një faturë tjetër, por thjesht duhet të specifikojë në të njëjtën faturë shumën e saktë të paguar me tollonin dhe me mënyra të tjera pagese. Shuma shtesë e paguar nga konsumatori do të merret ne konsideratë për llogaritjen e tatimit.

6. Kur furnizimi i mallrave paguhet me kartën e kompanisë të tatimpaguesit, të lëshuar nga tatimpaguesi që furnizon mallrat, në momentin e furnizimit, shitësi lëshon faturën dhe informacioni identifikues i blerësit duhet të vendoset në faturë (NIPT-i, emri/emri dhe mbiemri). Nëse fatura përmbledhëse i lëshohet blerësit deri në datën e fundit të muajit, bazuar në faturat e veçanta të furnizimit (për të cilat duhet të referohet NSLF e faturave të veçanta) gjatë muajit dhe në këto kushte vetëm fatura përmbledhëse do të merret në konsideratë për llogaritjen e tatimeve. Megjithatë, të gjitha faturat (për çdo furnizim dhe fatura përmbledhëse) duhet të fiskalizohen në momentin e lëshimit.

7. Fatura periodike e parashikuar në pikën 6, të nenit 8, të Ligjit është një përjashtim nga rregullat e përgjithshme dhe parashikohet për furnizime të caktuara të mallrave ose shërbimeve, të cilat furnizohen rregullisht ose vazhdimisht, për shembull në industrinë e ndërtimit, për furnizimin me energji elektrike, shërbimin e telekomunikacionit, furnizimin me ujë, shërbimin mujor me qira etj. Periudha mund të jetë një muaj ose më pak se një muaj (për shembull nëse furnizimi për shërbimet ose mallrat fillon ose përfundon në mes të muajit). Në këtë rast, tatimpaguesi që lëshon faturë duhet të shkruajë detyrimisht në faturë datën e periudhës me të cilën lidhet kjo faturë (në të cilën është bërë shërbimi) dhe data e lëshimit të faturës do të jetë data në të cilën është krijuar dhe lëshuar fatura. Fatura do të regjistrohet në librin e shitjes dhe librin e blerjes në të njëjtën datë/periudhë si data/periudha e shënuar në faturë, dhe jo në muajin e datës së lëshimit të faturës.

Shembulli 1

Blerësi blen një kartë dhuratë në një dyqan, të cilin më pas ia jep një personi tjetër si dhuratë. Personi i fundit sjell kartën e dhuratës në dyqanin e shitësit dhe blen artikuj në vlerën e shkruar në kartën e dhuratës dhe në vend që ta paguajë me para ose me kartë krediti, e paguan me kartën e dhuratës. Shitësi në këto raste duhet të lëshojë dhe fiskalizojë dy fatura: e para kur është shitur karta e dhuratës dhe e dyta kur karta e dhuratës është shkëmbyer për mallra ose shërbime (në këtë të fundit është e detyrueshme të shkruhet në faturë që metoda e pagesës është tollon (tollon me një qëllim-me qëllim të përcaktuar). Vetëm fatura e parë do të merret në konsideratë për llogaritjen e tatimeve dhe automatikisht do të ruhet në librin e shitjeve të shitësit (dhe në librin e blerjeve të blerësit, nëse blerësi është person i tatueshëm).

Shembulli 2

Një tatimpagues që ka një bar organizon një koncert në ambientet e barit dhe shet bileta të cilat përfshijnë 2 pije që mund të merren në bar. Nëse të gjitha pijet që mund të merren në bar shiten me të njëjtin çmim dhe aplikohet e njëjta normë e TVSH-së, ky mund të konsiderohet si një

tollon për vetëm një qëllim (me qëllim të përcaktuar). Fatura lëshohet në momentin kur shitet bileta dhe në përshkrimin për mallrat duhet të shënohet: hyrje për koncert dhe tollon për 2 pije. TVSH-ja tarifohet në shumën e marrë nga shitësi i biletës. Kur klienti merr 2 pijet në bar, atëherë lëshohet një faturë dhe për mënyrën e pagesave ajo deklarohet tollon NJQ. Kjo faturë e fundit do të fiskalizohet edhe në momentin e lëshimit, megjithatë shuma nuk do të merret parasysh për llogaritjen e tatimeve, sepse vetëm shuma nga fatura e parë do të merret në konsideratë.

Nëse niveli i TVSH-së është i ndryshëm për pijet dhe për hyrjen në koncert, atëherë në faturë duhet të tregohet qartë shuma e tatueshme e pijeve dhe biletave për koncertin.

Neni 9

Të dhënat e përgjithshme të faturës

1. Elementet e detyrueshme të faturës përcaktohen në nenin 9 të Ligjit dhe elementet e detyrueshme të faturës me TVSH përcaktohen në Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Fatura që lëshohet dhe printohet për klientin duhet të ketë elementet e mëposhtme të paraqitur me këtë renditje:

a) kreu i faturës:

i. titulli "Faturë tatimore";

ii. emri/emri dhe mbiemri i shitësit;

iii. adresa e shitësit;

iv. NIPT-i i shitësit.

b) të dhënat teknike të faturës:

i. data dhe koha e lëshimit të faturës (orën dhe minutat);

ii. numri i faturës;

iii. kodi i operatorit;

iv. kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

v. udhëzimet për pagesën, për shembull mënyra e pagesës, monedha dhe kursi i këmbimit nëse fatura nuk lëshohet në monedhën lekë, si dhe afatet e pagesës në rast se pagesa nuk bëhet në momentin e lëshimit të faturës;

c) të dhënat e blerësit:

emri/emri dhe mbiemri, adresa dhe NIPT-i. Ky informacion kërkohet vetëm nëse blerësi është:

i. një tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ose TVSH-së, në përputhje me ligjet e fushës;

ii. një person ligjor;

iii. një individ që blen pasuri personale me një vlerë individuale mbi 500,000 LEK; ose

iv. në raste të tjera, kur blerësi kërkon që të shënojë të dhënat e tij në faturë.

ç) të dhënat e mallrave dhe shërbimeve të furnizuara:

i. sasinë dhe përshkrimin e mallrave që shiten dhe/ose përshkrimin e shërbimeve që kryen, si dhe çmimet për njësi;

ii. shuma e plotë;

iii. shtesa ose zbritje të aplikuara (informacion mbi kompensimin ose pagesën), nëse aplikohet;

iv. shuma totale për t'u paguar.

d) fundi i faturës:

i. data ose periudha në të cilën është kryer furnizimi i mallrave ose shërbimeve ose data në të cilën është bërë parapagimi, të cilit i referohet pika 1, e nenit 7, të Ligjit, për aq sa kjo datë mund të përcaktohet dhe nëse është e ndryshme nga data e faturës;

ii. shënim mbi dispozitën e aplikueshme të ligjit për TVSH-në, që përcakton përjashtimin nga TVSH-ja ose çdo shënim apo dispozitë ligjore kur është e detyrueshme dhe kërkohet nga legjislacioni në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar;

iii. numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF), i shprehur si kod alfanumerik;

iv. numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF), i shprehur si kod alfanumerik; dhe

v. kodin QR me të dhënat përkatëse sipas këtij udhëzimi.

3. Përveç elementëve të pikës 2 të këtij neni, fatura duhet të përmbajë në raste të veçanta edhe elementët e mëposhtëm:

a) në rast të eksportit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në rast se blerësi është një tatimpagues ose një person juridik në vendin e tij të rezidencës:

i. numrin identifikues tatimor (lëshuar në vendin e rezidencës së blerësit);

ii. emrin/emrin dhe mbiemrin e blerësit; dhe

iii. adresën e blerësit.

b) në rast të eksportit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në rast se blerësi është një individ, i cili nuk është tatimpagues në vendin e tij të rezidencës: emrin e tij të plotë dhe adresën ku do të dërgohen mallrat.

c) kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimet e marra nga shitësi:

i. shënimi "vetëfaturim";

ii. informacioni për numrin unik të identifikimit, emri/emri dhe mbiemri dhe adresa e shitësit.

4. Përveç elementëve të detyrueshëm të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, tatimpaguesit që lëshojnë fatura mund të përfshijnë gjithashtu:

i. kodin e artikullit sipas nomeklaturës së kombinuar të mallrave;

ii. të dhëna të tjera në faturë në përputhje me nevojat e tyre.

5. Tatimpaguesit subjekte të TVSH-së, duhet të lëshojnë fatura me TVSH që përmbajnë elementët e përshkruar në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë dhe në formë të printuar duhet të kenë strukturën, sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.

6. Data dhe ora e lëshimit të faturës është data kur fatura është krijuar dhe printuar ose dërguar klientit në formë elektronike. Në rast të fiskalizimit të mëvonshëm, data në të cilën është lëshuar faktikisht fatura (krijuar dhe dorëzuar klientit) duhet të jetë data e lëshimit të faturës dhe jo data kur ajo dërgohet për fiskalizimin e mëvonshëm.

7. Për qëllimin e procesit të fiskalizimit, në mesazhin e fiskalizimit, një zbritje ose ulje çmimi duhet të raportohet për secilin artikull, pavarësisht nëse një zbritje është dhënë për një artikull individual ose për shumën totale të faturës.

8. Për qëllimin e fiskalizimit, mënyra e pagesës ndahet në 2 grupe:

a) pagesa me para në dorë, të kryera me:

i. kartëmonedha dhe monedha;

ii. kartë krediti dhe debiti;

iii. çek;

iv. tollon vetëm për një qëllim përdorimi (me qëllim të përcaktuar-tollon NjQ);

v. kartat e kompanisë së tatimpaguesit;

vi. porosi (në raste të veçanta kur lëshohet faturë përmbledhëse).

b) pagesa pa para në dorë:

i. nga llogaria bankare e tatimpaguesit;

ii. faktoring;

iii. kompensimi (për shembull, ndërmjet llogarive të tatimpaguesve, llogari të arkëtueshme/ pagueshme);

iv. transferimi i të drejtave ose borxheve;

v. heqja dorë nga borxhet;

vi. pagesa në natyrë (klering);

vii. pagesa të tjera pa para në dorë.

Nëse blerësi paguan duke përdorur një kombinim të metodave të pagesave të përmendura më sipër, atëherë është e detyrueshme të regjistrojë informacionin për shumën e paguar me secilën metodë pagese. Sidoqoftë, nuk është e mundur të lëshohet një faturë për kombinimin e pagesave me para në dorë dhe pagesave pa para në dorë.

Nëse shitësi lëshon një faturë bashkë me një urdhër pagese, të cilin klienti mund ta paguajë drejtpërdrejt nga llogaria bankare, ose nëpërmjet e-banking të tij, ose në institucione të tjera financiare jobanka, ose të ngjashme, atëherë mënyra e pagesës do të konsiderohet pagesë pa para në dorë.

9. Nëse pagesa nuk është bërë në momentin e lëshimit të faturës, atëherë afati i pagesës përcaktohet detyrimisht në faturë (pra data e fundit e periudhës në të cilën fatura duhet të paguhet).

10. Fatura e lëshuar nga përfaqësuesi tatimor duhet të përmbajë emrin dhe numrin unik të identifikimit të shitësit të huaj, si dhe emrin dhe NIPT-in e përfaqësuesit tatimor.

11. Sipas pikës 9, të nenit 9, të Ligjit, faturat që nuk janë fiskalizuar sipas këtij Ligji nuk mund të përdoren si një dokument i vlefshëm tatimor për të justifikuar shpenzimet e biznesit. Blerësi mund të verifikojë nëse fatura e marrë është e fiskalizuar, thjesht duke skanuar kodin QR në faturë ose duke hyrë në llogarinë e tij në platformën qendrore të faturave dhe duke kontrolluar nëse fatura është e regjistruar në librin e tij të blerjeve. Nëse po, kjo gjë provon se fatura është fiskalizuar dhe regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore dhe mund të njihet për qëllime tatimore.

12. Nëse pajisja elektronike nuk mund të gjenerojë një kod QR për shkak të ndonjë keqfunksionimi të saj dhe fatura fiskalizohet, kjo e fundit printohet dhe duhet t'i jepet klientit. Kjo faturë do të konsiderohet si faturë e parregullt për shitësin duke qenë se nuk ka të gjitha elementet dhe i nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, për elementë të parregullt të faturës.

Neni 10

Gjenerimi i Numrit Identifikues të Veçantë të Faturës

1. Sistemi i informacionit të administratës tatimore gjeneron numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF) pasi procesi i verifikimit të faturës

të përfundojë me sukses dhe ia dërgon atë tatimpaguesit që lëshon fatura si konfirmim të informacionit të faturave të pranuara në mënyrë të rregullt, sipas nenit 20, pika 3, e Ligjit.

2. NIVF i përcaktuar në mënyrën e përshkruar në këtë nen është unik për secilën faturë.

3. Shkurtesa NIVF përdoret për numrin identifikues të veçantë të faturës shënuar në faturë dhe llogaritet me metodën IUU (identifikues unik universal).

4. NIVF përbëhet nga 32 karaktere, të cilat mund të jenë numrat nga 0 në 9 dhe shkronjat nga "a" në "f" , të cilat shprehen në pesë grupe të ndara nga një vizë në mes "-", në formën 8-4-4- 4-12.

5. Sipas nenit 9 të Ligjit, për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturave të lëshuara, elementi i detyrueshëm i secilës faturë është, ndër të tjera, NIVF, i cili identifikon në mënyrë unike çdo faturë dhe konfirmon që fatura është regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

6. NIVF i caktohet secilës faturë të paraqitur individualisht në kohën e faturimit, pavarësisht nga mënyra e pagesës së faturës (me ose pa para në dorë).

Neni 11

Gjenerimi i Numrit të Sigurisë së Lëshuesit të Faturës

1. Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) është një kod alfanumerik që konfirmon lidhjen midis tatimpaguesit faturues dhe faturës së lëshuar.

2. NSLF krijohet nga tatimpaguesi kur ai gjeneron një faturë, pra automatikisht nga zgjidhja software-ike që ai përdor për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, si dhe ia dërgon atë administratës tatimore qendrore si një element të faturës në mesazhin në format XML. Pas verifikimit nga sistemi i informacionit të administratës tatimore qendrore, tatimpaguesi duhet ta printojë NSLF-në në faturë apo ta përfshijë atë në faturën që ia dërgon blerësit në formë elektronike, së bashku me elementet e tjerë të detyrueshëm.

3. NSLF përcaktohet nga informacioni i faturës, i cili:

a) siguron unikalitetin e faturës për:

i. numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit (NIPT) që lëshon faturën;

ii. datën dhe orën e lëshimit të faturës;

iii. numrin e faturës;

iv. kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

v. kodin e zgjidhjes software-ike të përdorur për lëshimin e faturës;

vi. kodin e pajisjes elektronike të faturimit (për transaksione me para në dorë);

vii. shumën totale të faturës;.

b) siguron vërtetësinë e tatimpaguesit që lëshon faturën, nënshkrimin elektronik me çelësin privat të certifikatës elektronike, të cilën e ka marrë nga AKSHI për qëllim të fiskalizimit.

4. NSLF për faturat pa para në dorë përcaktohet sipas pikës 3 të këtij neni, por nuk përmban informacion mbi kodin e pajisjes elektronike të faturimit.

5. Nëse fatura lëshohet përmes platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenet 22 dhe 27 të Ligjit, atëherë NSLF gjenerohet nga sistemi i informacionit të administratës tatimore qendrore.

6. Në rastin e vetëfaturimit, NSLF përcaktohet sipas blerësit, i cili është në këto raste edhe lëshuesi i faturës.

7. NSLF, si një element i detyrueshëm i faturës, përdoret:

a) gjatë inspektimit tatimor për verifikimin e faturës së lëshuar, ku tatimpaguesi vërteton, në bazë të elementëve të tjerë të faturës, të përdorur për gjenerimin e NSLF, se ai është lëshuesi i faturës, pra ka lëshuar faktikisht faturën në fjalë, e cila mund të jetë me ose pa NIVF;

b) kur blerësi dëshiron të verifikojë faturën në përputhje me nenin 35 të Ligjit dhe në të gjitha rastet kur një faturë është lëshuar pa një NIVF.

8. Në situatat kur, pas verifikimit të faturës, përcaktohet që tatimpaguesi ka lëshuar faturën vetëm me NSLF dhe pa NIVF, që do të thotë se ai nuk e ka regjistruar faturën në administratën tatimore qendrore në procesin e fiskalizimit dhe nëse ai nuk e fiskalizon më pas brenda afatit të parashikuar në Ligj, atëherë aplikohen masat e përcaktuara të sanksioneve nga ligji për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

9. Kur kryhet procedura e fiskalizimit të një fature të marrë nga një tatimpagues rezident i Republikës së Shqipërisë, prej një shitësi nga jashtë për importin e mallrave të përmendur në nenin 20, pikat 7 dhe 10 të Ligjit, NIVF përcaktohet sipas informacionit të blerësit në mënyrën e përmendur

në pikën 3 të këtij neni, por pa informacionin e kodit të pajisjes elektronike të faturimit.

10. Për llogaritjen e NIVF-së përdoret kodifikimi UTF-8 (*Unicode Transformation Format 8*).

11. Nënshkrimi elektronik kryhet duke përdorur një certifikatë elektronike të vlefshme për fiskalizimin, e cila i është lëshuar tatimpaguesit nga AKSHI.

12. Me përdorimin e funksionit hash kriptografik MD5 (sipas standardit RFC 1321 Algoritmi i MD-Mesazhit-Digest) gjenerohet rezultati i mëposhtëm: 32 karaktere alfanumerike të shkruara në një format heksadecimal (numrat nga 0 në 9 dhe shkronjat nga "a" në "f"), i cili do të jetë një element i detyrueshëm i faturës dhe i printuar në faturë.

Neni 12
Gjenerimi i Kodit QR

1. Për të siguruar lehtësisht verifikimin e faturës së lëshuar, duhet të gjenerohet një kod QR për të gjitha faturat. Kodi QR është një element i detyrueshëm i faturës si në rastin kur fatura raportohet me sukses në administratën tatimore qendrore dhe fiskalizohet (fatura ka marrë një NIVF), dhe në rastet kur fatura nuk mund të fiskalizohet (për shkak të mungesës së internetit, disponueshmërisë së serverit të shërbimit fiskalizues etj.).

2. Kodi QR printohet në letër së bashku me elementët e tjerë të detyrueshëm të faturës sipas nenit 9 të Ligjit për të gjitha faturat për pagesa me para në dorë, ndërsa për faturat elektronike do të printohet vetëm kodi QR për rastet e furnizimit të mallrave me transport, ku kodi QR i printuar shërben si një dokument transporti për mallrat e furnizuara.

3. Zgjidhja software-ike e përdorur për lëshimin e faturave dhe fiskalizimin e tyre duhet të krijojë automatikisht një URL në formatin e specifikuar në specifikimet teknike të publikuara në faqen e internetit të administratës tatimore qendrore.

Neni 13
Të dhënat shtesë për faturën elektronike

Fatura elektronike, sipas nenit 10 të Ligjit, ka disa elemente shtesë, të cilat përshkruhen hollësisht në udhëzimin për faturën elektronike dhe specifikimet teknike.

Neni 14
Fatura e thjeshtë

1. Faturat e thjeshta pa TVSH sipas nenit 11 të Ligjit mund të lëshohen nëse përmbushen të dy kushtet si më poshtë:

a) tatimpaguesi që lëshon fatura i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë; dhe

b) fatura e lëshuar për mallrat ose shërbimet e furnizuara, paguhet me para në dorë në momentin e furnizimit.

2. Faturat e lëshuara sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë shënimin që tatimpaguesi nuk ka detyrimin për të llogaritur TVSH-në në shitje për furnizimet e mallrave ose shërbimeve të kryera prej tij. Në këtë mënyrë, blerësi do të marrë dijeni për statusin e shitësit dhe nëse këtij të fundit i lejohet të lëshojë një faturë të thjeshtë pa TVSH.

3. Faturat e thjeshtuara të paguara me para në dorë duhet të printohen në letër (përveç rastit kur ato mund të dërgohen në mënyrë elektronike sipas pikës 3, të nenit 23, të Ligjit). Megjithatë numri i faturës, kodi i operatorit, kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, mënyra e pagesës dhe kursi i këmbimit nuk janë të detyrueshme të printohen, por do t'i dërgohen administratës tatimore qendrore së bashku me elementët e tjerë të faturës gjatë procedurës së fiskalizimit dhe blerësi do të jetë në gjendje t'i përdorë ato duke skanuar kodin QR në faturë. Si përjashtim, për transaksionet e këmbimit valutor, gjithashtu monedha dhe kursi i këmbimit duhet të printohen në faturë.

Neni 15
Numri i faturës

1. Sipas nenit 12 të Ligjit, numri i faturës, pra rregulli i sekuencës së faturës, përcaktohet në mënyrë të pavarur nga tatimpaguesi duke zgjedhur njërin nga modelet e mëposhtme:

a) në rang të çdo vendi të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, pavarësisht nga mënyra e pagesës me ose pa para në dorë. Kjo nënkupton se, çdo vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit që lëshon fatura do të ketë numrin rendor të faturave të vetin, pavarësisht nga numri i pajisjeve elektronike të faturimit të përdorura në atë

vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Në fund të vitit, numri i fundit i faturës në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit duhet të tregojë numrin total të faturave të lëshuara ose të lidhura me atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

b) në rang të çdo vendi të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe e ndarë sipas mënyrës së pagesës (me ose pa para në dorë) në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Kjo nënkupton se, faturat do të kenë numra faturash veç për faturat me para në dorë dhe veç për faturat pa para në dorë, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

c) në rang të çdo pajisjeje elektronike të faturimit për faturat me para në dorë në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe veç për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit për faturat pa para në dorë. Kjo nënkupton se, çdo pajisje elektronike faturimi në një vend të ushtrimit të veprimtarisë së ushtrimit të biznesit do të ketë numrin rendor të faturave të vetin dhe për faturat pa para në dorë do të jetë një numër rendor i veçantë për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit me të cilin lidhet fatura.

2. Numri i faturës, në fillim të çdo viti kalendarik, ose në fillim të veprimtarisë ekonomike në një vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, ose në fillim të përdorimit të pajisjes elektronike të faturimit, ose në fillim të lëshimit të faturave sipas Ligjit, fillon nga numri 1- numri i vitit (për shembull për vitin 2021 fatura e parë e lëshuar do të ketë numrin 1-2021) dhe vazhdon pa anashkaluar rendin numerik të numrave për çdo vit individualisht, bazuar në rregullat e sekuencave të miratuara sipas pikës 1 të këtij neni. Numri rendor nuk është i detyrueshëm të miratohet nga administrata tatimore qendrore, duke qenë se numërimi duhet të fillojë çdo vit nga numri 1 dhe duhet të ndjekë rendin 2, 3, 4, . n.

3. Formati i numrit të faturës është si vijon:

a) për faturat e paguara me para në dorë: numri rendor - viti kur lëshohet fatura - kodi i pajisjes elektronike të faturimit (për shembull 1-2021-m0256789as)

b) për faturat e paguara pa para në dorë: numri rendor - viti kur lëshohet fatura (për shembull 1-2021).

4. Për faturat e paguara me para në dorë, kodi elektronik i pajisjes së faturimit është ai që gjenerohet nga administrata tatimore qendrore në përputhje me nenin 17 të këtij udhëzimi.

5. Qëllimi i numrit të faturës i përcaktuar në këtë nen është të monitorojë numrin e faturave të lëshuara. Për të identifikuar në mënyrë unike çdo faturë dhe regjistrimin e tyre në librat e shitjes/blerjes duhet të përdoret NIVF.

Neni 16

Të dhënat e tatimpaguesve që lëshojnë fatura

Në përputhje me nenin 13 të Ligjit, çdo tatimpagues aktiv, që ka detyrim te lëshojë fatura, duhet të identifikohet në regjistrin e tatimpaguesve, në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore, si tatimpagues që lëshon fatura. Siç përcaktohet në Ligj, ky proces do të jetë automatik.

Neni 17

Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe i pajisjeve elektronike të faturimit

1. Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit

1.1. Tatimpaguesi që lëshon fatura duhet t'i japë informacion administratës tatimore për secilin vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ku ai lëshon fatura, përpara se të fillojë të lëshojë fatura në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, në përputhje me nenin 14 të Ligjit. Tatimpaguesit që nuk janë të detyruar të lëshojnë fatura sipas nenit 5 të Ligjit, nuk janë të detyruar të japin informacione për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit pranë administratës tatimore qendrore, si dhe informacione të tjera të përcaktuara në Ligj. Përjashtim bëjnë rastet kur personi fizik ose juridik kryen gjithashtu veprimtari për të cilat është i detyruar të lëshojë një faturë. Në këto raste, ai duhet të japë informacion për të gjitha vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ku do të lëshohen fatura për furnizimin e mallrave ose shërbimeve që nuk janë të përjashtuara nga detyrimi i faturimit, si dhe të gjitha informacionet e tjera të përcaktuara në Ligj.

1.2. Të gjitha informacionet rreth vendeve të reja të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, si dhe ndryshimet në të dhënat ekzistuese, do të dërgohen përmes platformës qendrore të faturave, të cilën tatimpaguesi mund ta aksesojë duke përdorur certifikatën elektronike të lëshuar nga AKSHI.

1.3. Në rastin kur tatimpaguesi kryen më shumë se një aktivitet në të njëjtin vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, atëherë ai është i detyruar që nëpërmjet platformës qendrore të faturave, të hedhë të dhënat e veprimtarisë kryesore, përkatësisht të veprimtarisë që gjeneron të ardhurat më të larta në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, si dhe gjithashtu të vendosë të dhënat për aktivitetet e tjera që ai kryen si veprimtari ndihmëse.

1.4. Në rastin kur tatimpaguesi kryen veprimtari tregtare me të cilën operon 24 orë në ditë (bar, dyqan online, aplikacionet e telefonave inteligjentë etj.), mund të specifikojë si orar pune 00:00-24:00.

1.5. Nëse tatimpaguesi operon në një zonë ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje e përhershme në internet dhe nuk mund të raportojë informacionet që parashikohen në këtë nen përmes platformës qendrore të faturave, atëherë ai mund ta dorëzojë informacionin për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit përmes formularit "Informacione për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit", i cili është i bashkangjitur në Shtojcën 1 të këtij udhëzimi, drejtpërsëdrejti ose me anë të postës në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar. I njëjti formular përdoret si për të dërguar të dhënat herën e parë, po ashtu dhe për dorëzimin e ndryshimeve, por në rastin e dërgimit të ndryshimeve, në formular duhet të shkruhet vetëm kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, numri unik i identifikimit i tatimpaguesit që lëshon fatura dhe të dhënat e ndryshuara.

1.6. Nëse tatimpaguesi, si vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit deklaron automjetin që përdor për kryerjen e aktivitetit të biznesit (për shembull për shitjen e mallrave derë më derë, transportin e pasagjerëve kur bileta mund të blihet në automjet etj.), atëherë ai duhet të dërgojë gjithashtu edhe informacionin për targën e automjetit (ose çdo numër tjetër regjistrimi të mjetit, nëse sipas ligjeve përkatëse nuk ka detyrimin për të pasur targë, siç janë anijet).

1.7. Pas marrjes së dhënave të detyrueshme për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sistemi i informacionit të administratës tatimore gjeneron një kod unik për këtë vend, e shfaq atë dhe e ruan në konfirmimin e regjistrimit, në platformën qendrore të faturave, në llogarinë personale të tatimpaguesit që lëshon fatura. Zbatimi i kësaj procedure nuk nënkupton pajisjen e tatimpaguesit me një numër NIPT-i apo një numër serial të ri.

1.8. Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është një kod alfanumerik, unik në nivel tatimpaguesi, që përbëhet nga 10 karaktere.

1.9. Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, i përmendur në pikën 1.7. të këtij neni, duhet të tregohet nga tatimpaguesi në çdo faturë të lëshuar dhe fiskalizuar.

1.10. Në të dhënat për secilin vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit që duhet të dërgohen në administratën tatimore në përputhje me pikën 1.1. të këtij neni, duhet të paraqiten:

a) Përsa i përket llojit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të përcaktojë nëse është ndërtesë, truall ose automjet, duke dhënë gjithashtu informacion për destinacionin e përdorimit si tregti, shërbime, prodhim/përpunim, magazinim, mbajtje apo mbarështim të gjësë së gjallë, tregti online etj.

b) Përsa i përket llojit të veprimtarisë, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të cilësojë llojin e veprimtarisë sipas klasifikimit kombëtar të veprimtarive, veprimtaritë kryesore dhe ato dytësore, nëse ka;

c) Përsa i përket orarit të punës, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të përcaktojë: orarin normal të punës (për shembull nga e hëna në të premte), orarin e punës në ditë të veçanta të javës (për shembull të shtunën dhe të dielën, etj.), llojin e orarit të punës në aktivitete që organizohen një herë, dy herë ose në formë tjetër (për shembull për mbajtjen e seminareve ose shitjet në panair në një periudhë të caktuar etj.), të dhëna për përjashtimet nga orari normal i punës në data të caktuara (për shembull gjatë pushimeve etj.) ose në raste të tjera. Në rastin e tregtisë online, tatimpaguesi mund të përcaktojë si orar pune 0 deri në 24 orë. Në rastin e orarit të ndryshueshëm të punës, tatimpaguesi duhet të përcaktojë orarin normal të punës dhe te fusha e shënimeve duhet të shënojë se ka orar pune të ndryshueshëm dhe të japë një përshkrim të shkurtër;

ç) Përsa i përket datës së mbylljes së veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të shënojë datën e mbylljes ose ndërprerjes së veprimtarisë vetëm nëse ai e di këtë datë në momentin e regjistrimit (për shembull nëse është

aktivitet sezonal ose aktivitet i përkohshëm, si për shembull një seminar 2-ditor, panair etj.);

d) Përsa i përket të dhënave të sipërfaqes (metra katrorë) të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të deklarojë sipërfaqen e hapësirës fikse që nënkupton sipërfaqen totale të hapësirës së përdorur, përfshirë hapësirën e jashtme (në ambient të hapur) dhe të brendshme (në ambient të mbyllur) në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (për shembull hapësira e brendshme e një restoranti dhe hapësira e jashtme);

dh) Përsa i përket të dhënave mbi statusin e tatimpaguesit dhe situatën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

i)Statusi i tatimpaguesit është i njëjtë me statusin që tatimpaguesi ka në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore;

ii)Për situatën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë tatimpaguesi duhet të japë informacion nëse është "i hapur" apo "i mbyllur".

e) Përsa i përket deklarimit mbi pronësinë e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi duhet të zgjedhë njërën nga alternativat "në pronësi", "me qira" ose "marrëveshje të tjera". Në rast se vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është me qira, tatimpaguesi qiramarrës duhet të regjistrojë informacione mbi qiradhënësin, më specifikisht, numrin personal të identifikimit ose NIPT-in, si dhe emrin dhe mbiemrin e tij.

1.11. Faturat mund të lëshohen edhe jashtë orarit të punës, nëse për shembull, në momentin e mbylljes së biznesit ka akoma klientë në dyqan, por këto duhet të jenë raste specifike dhe nëse përsëriten çdo ditë, atëherë tatimpaguesi duhet të paraqesë në platformën qendrore të faturave informacionin për orarin e ri të punës.

1.12. Regjistrimi i adresës ku ushtrohet veprimtaria e biznesit në regjistrin tregtar, i ndryshimeve të adresës dhe i informacioneve të tjera është një procedurë e ndryshme nga regjistrimi i vendeve të ushtrimit të aktivitetit të biznesit, sipas këtij neni për qëllime të fiskalizimit dhe nuk do të ndikohet nga dispozitat e Ligjit dhe të këtij udhëzimi. Kjo do të thotë që tatimpaguesi do të regjistrojë ndryshimet në regjistrin tregtar ose në administratën tatimore qendrore, në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin përkatës, pavarësisht nga detyrimi sipas këtij neni.

2. Regjistrimi i pajisjes elektronike të faturimit dhe pajisjeve të vetëshërbimit (automatët)

2.1. Për qëllime të fiskalizimit, gjatë lidhjes për herë të parë të pajisjes elektronike të faturimit ose pajisjes së vetëshërbimit (automatët) me sistemin e informacionit të administratës tatimore, duke përdorur shërbimin e fiskalizimit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të dorëzojë në administratën tatimore të dhëna për pajisjen elektronike të faturimit që përdoren për pagesa me para në dorë dhe të dhëna për pajisjen e vetëshërbimit (automatët). Kjo lidhje duhet të bëhet jo më vonë se 24 orë para lëshimit të faturës së parë.

2.2. Në lidhjen për herë të parë të përmendur në pikën 2.1. të këtij neni, tatimpaguesi dorëzon informacionin e nevojshëm për zbatimin e procesit të fiskalizimit, përkatësisht:

a) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit në të cilin ndodhet pajisja elektronike e faturimit;

b) numrin rendor të pajisjes elektronike të faturimit ose të pajisjes së vetëshërbimit (automatët), të specifikuar nga vetë tatimpaguesi, të cilin tatimpaguesi është i detyruar ta tregojë në atë pajisje;

c) kodin e zgjidhjes software-ike që përdoret në pajisjen elektronike të faturimit ose në pajisjen e vetëshërbimit për të lëshuar fatura dhe për të kryer procedurën e fiskalizimit, i cili gjenerohet nga AKSHI gjatë procedurës së certifikimit dhe që duhet të integrohet në zgjidhjen software-ike nga prodhuesi i zgjidhjes software-ike (në këtë mënyrë, këto të dhëna duhet të plotësohen automatikisht);

ç) kodin e mirëmbajtësit të zgjidhjes software-ike që kryen shërbimin e mirëmbajtjes, i cili gjenerohet nga AKSHI pas regjistrimit të mirëmbajtësit;

d) datën kur do të përdoret pajisja elektronike e faturimit ose pajisja e vetëshërbimit (automatët);

e) datën deri kur pajisja elektronike e parave në dorë ose makina vetë-shërbimi (automat) do të jetë në përdorim (nëse dihet në atë moment); dhe

ë) llojin e pajisjes elektronike të faturimi: "standarde" ose "pajisje vetëshërbimi (automat)".

2.3. Pas marrjes së informacionit të përmendur në pikën 2.2. të këtij neni, administrata tatimore gjeneron kodin e pajisjes elektronike të faturimit ose pajisjes së vetëshërbimit (automatët), e cila i

dërgohet tatimpaguesit përmes të njëjtit kanal komunikimi, drejtpërsëdrejti te pajisja elektronike e faturimit ose pajisja e vetëshërbimit (automat) nga e cila janë dërguar të dhënat sipas pikës 2.2. të këtij neni.

2.4. Kodi i përmendur në pikën 2.3. të këtij neni është një kod unik afranumerik, i përbërë nga 10 karaktere. Pajisjet elektronike të faturimit përdoren për lëshimin e faturave për pagesat me para në dorë, kështu që kodi printohet në çdo rast të lëshimit të këtyre faturave.

2.5. Kodi i përmendur në pikën 2.3. të këtij neni duhet të përfshihet nga tatimpaguesi që lëshon fatura në numrin e çdo fature të lëshuar për pagesat me para në dorë ose në rastin e shitjeve përmes pajisjeve të vetëshërbimit (automatët).

2.6. Si rrjedhim nga pika 2.1. e këtij neni, nëse tatimpaguesi kryen veprimtari në një vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit që ndodhet në një zonë ku nuk mund të vendoset një lidhje interneti, në përputhje me nenin 31 të Ligjit, atëherë ai mund t'i dërgojë të dhënat e përmendura në pikën 2.2. të këtij neni në administratën tatimore në mënyrë elektronike në platformën qendrore të faturave, ose në zyrën vendore të administratës tatimore ku është regjistruar, ose ku ka vendbanimin e përhershëm, ose me anë të postës përmes formularit "Regjistrimi i pajisjes elektronike të faturimit", i cili është i bashkëngjitur në Shtojcën 3 të këtij udhëzimi. I njëjti formular përdoret për regjistrimin e pajisjes së vetëshërbimit, në të njëjtat rrethana. Formulari përdoret për të dërguar të dhënat herën e parë, si dhe për të dërguar ndryshimet dhe çregjistrimin e pajisjes elektronike të faturimit ose të makinës së vetëshërbimit. Kodi i pajisjes elektronike të faturimit ose pajisjes së vetëshërbimit (automat) do të ruhet në platformën qendrore të faturave në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit.

2.7. Regjistrimi i një pajisjeje elektronike të faturimit për pagesa me para në dorë dhe i një pajisjeje vetëshërbimi (automat) bëhet vetëm në fillim të përdorimit. Nëse ka një ndryshim në të dhënat e paraqitura në regjistrimin e parë, në përputhje me pikën 2.2. të këtij neni ose nëse pajisja elektronike e faturimit për pagesa me para në dorë ose pajisja e vetëshërbimit (automat) nuk përdoret më, tatimpaguesi është i detyruar të raportojë ndryshimin përmes shërbimit të fiskalizimit, ose me anë të platformës qendrore të faturave, ose në formën e përcaktuar në pikën 2.6. të këtij neni, para se të rifillojë përdorimin e pajisjes, brenda 72 orëve nga ndryshimi i ndodhur.

2.8. E njëjta pajisje elektronike e faturimit për pagesa me para në dorë me të njëjtin kod nuk mund të përdoret në më shumë se një vend të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit. Nëse vendi i ushtrimit të veprimtarisë të biznesit është i mbyllur dhe pajisja elektronike e faturimit për pagesa me para në dorë transferohet nga ai vend i ushtrimit të veprimtarisë të biznesit në një vend tjetër të ushtrimit të veprimtarisë tregtare të të njëjtit tatimpagues, atëherë së pari, tatimpaguesi duhet të çregjistojë këtë pajisje dhe pastaj ta regjistrojë përsëri me të dhënat e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të ri dhe sistemi i informacionit i administratës tatimore do të gjenerojë një kod të ri elektronik të pajisjes së parave në dorë i lidhur me kodin e vendit të ri të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit.

2.9. Grupi i të dhënave të paraqitura në mesazhin e kërkesës për regjistrimin e pajisjes elektronike të faturimit për pagesa me para në dorë dhe regjistrimit të pajisjes së vetëshërbimit (automatët), si dhe mesazhi i përgjigjes janë një pjesë thelbësore e këtij udhëzimi dhe janë përcaktuar në specifikimet teknike të publikuara në faqen e internetit të administratës tatimore Qendrore.

Neni 18

Regjistrimi i operatorëve

1. Tatimpaguesi është i detyruar të paraqesë informacion në administratën tatimore për secilin individ që do të përdorë pajisjen elektronike të faturimit dhe do të lëshojë fatura për konsumatorët (për shembull për arkëtarin, kamerierin, shitësin etj.), pavarësisht nëse ky individ është vetë tatimpaguesi apo një punonjës që punon për tatimpaguesin.

2. Nëse procesi i lëshimit të faturave elektronike i nënkontraktohet një kompanie private të kontabilitetit, një konsulenti fiskal ose një personi tjetër që ofron konsulencë fiskale apo shërbime kontabiliteti, atëherë operatori është ai tatimpagues që ofron atë lloj shërbimi, duke vepruar si një palë e tretë e autorizuar nga tatimpaguesi për të lëshuar fatura për llogari dhe në emër të tij.

3. Në rastin e pajisjeve të vetëshërbimit (automatët), operatori është vetë tatimpaguesi, pra

pronari i pajisjeve të vetëshërbimit që ofron këtë lloj furnizimi të mallrave dhe shërbimeve.

4. Tatimpaguesi i paraqet administratës tatimore të dhënat e mëposhtme për secilin operator sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni:

a) emrin dhe mbiemrin e individit dhe numrin e tij personal të identifikimit;

b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit person fizik/person juridik, sipas pikës 2 të këtij neni, në rastet e veprimtarisë së nënkontraktimit të veprimtarisë së lëshimit të faturave dhe NIPT-in të tij;

c) NIPT-in e tij në rastet e pajisjeve të vetëshërbimit;

ç) datën e fillimit të lëshimit të faturës;

d) datën deri kur personi i raportuar do të jetë operator, nëse kjo datë dihet në momentin e regjistrimit.

5. Të dhënat sipas pikës 4 të këtij neni do të dorëzohen nga tatimpaguesit që lëshojnë fatura në mënyrë elektronike, në platformën qendrore të faturave, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave nga operatori. Përjashtim bëjnë rastet kur tatimpaguesi që lëshon fatura nuk mund të përdorë platformën qendrore të faturave, sepse nuk ka lidhje të përhershme në internet, siç parashikohet në nenin 31 të Ligjit. Në këtë rast, të dhënat për secilin operator duhet të hidhen në formularin "Informacioni mbi operatorët", i cili është bashkëngjitur në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi dhe të dorëzohen në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është regjistruar, dorazi ose me postë, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave nga operatori. I njëjti formular përdoret si për dorëzimin e të dhënave për herë të parë, po ashtu dhe për dorëzimin e ndryshimeve në të dhëna.

6. Pas dërgimit të të dhënave sipas pikës 5 të këtij neni, sistemi i informacionit të administratës tatimore gjeneron kodin e operatorit, i cili lidhet me numrin personal të identifikimit ose NIPT-in e operatorit.

7. Kodi i operatorit është një kod i veçantë i cili do të përdoret për të identifikuar çdo operator që lëshon fatura. Kodi krijohet nga sistemi i informacionit të administratës tatimore pasi operatori është regjistruar për herë të parë në sistem dhe ruhet në regjistrin e administratës tatimore. Pasi individi regjistrohet në sistem si operator, në vijim do të ketë të njëjtin kod operatori, edhe nëse punon për tatimpagues të ndryshëm.

8. Në faturë shfaqet vetëm kodi i operatorit, me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të personit që lëshon faturat në cilësinë e operatorit.

9. Kodi i operatorit është gjithashtu një element i detyrueshëm në secilin mesazh të faturës që dërgohet në sistemin e informacionit të administratës tatimore gjatë procedurës së fiskalizimit. Kjo do të thotë që, nëse me të njëjtën pajisje elektronike të faturimit, punojnë dy ose më shumë operatorë që lëshojnë fatura, secili prej tyre duhet të vendosë kodin e tij në secilën faturë që lëshon.

10. Tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të japë gjithashtu informacion për ndërprerjen e punës së një personi që vepron si operator, në mënyrën e përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, brenda 24 orëve pas ndodhjes së ndryshimit.

11. Informacioni në lidhje me kodin e operatorit mund të shihet nga tatimpaguesi që lëshon fatura në konfirmimin e regjistrimit të operatorit, që ruhet në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e tij të përdoruesit.

Neni 19

Regjistrimi i prodhuesve dhe mirëmbajtësve të software-ve

1. Çdo prodhues dhe mirëmbajtës i software-it duhet të regjistrohet në regjistrin specifik të prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike, të menaxhuar nga AKSHI. Procedura e regjistrimit përshkruhet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

2. Çdo tatimpagues duhet të njoftojë administratën tatimore qendrore për zgjidhjen software-ike të përdorur për lëshimin e faturave, si dhe për prodhuesin dhe mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike.

3. Regjistrimi i prodhuesit të software-it dhe zgjidhjes softuerike kryhet në secilin fiskalizim, pasi të dhënat e zgjidhjes softuerike të përdorur janë pjesë integrale e të dhënave për fiskalizimin e faturës. Ndërsa, të dhënat për mirëmbajtësin duhet të regjistrohen gjatë regjistrimit të të dhënave për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ose në nivelin e secilës pajisje elektronike të faturimit, nëse tatimpaguesi ka mirëmbajtës të ndryshëm.

Neni 20
Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes

1. Duke përdorur platformën qendrore të faturave, tatimpaguesi që lëshon fatura mund të kontrollojë në çdo kohë:

a) të gjitha faturat e lëshuara, për të cilat ai ka kryer procesin e fiskalizimit, pra që janë të regjistruara në bazën e të dhënave të administratës tatimore; dhe

b) të gjitha faturat në të cilat ai paraqitet si blerës, pra që përmbajnë NIPT-in e tij.

2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shfaqen në formën e librit të blerjeve dhe librit të shitjeve.

3. Tatimpaguesi nuk ndryshon përmbajtjen e faturës në platformën qendrore të faturave, por mund të përfshijë informacion shtesë në faturën e regjistruar, me qëllim identifikimin e rubrikës përkatëse në librin e blerjeve ose librin e shitjeve ku fatura duhet të deklarohet.

4. Tatimpaguesi që lëshon fatura, mund të shohë në llogarinë e tij të përdoruesit në platformën qendrore të faturave, parregullsitë e hasura gjatë verifikimit të pranimit të faturave, sipas nenit 23 të këtij udhëzimi.

5. Kategorizimi i faturave në rubrika të veçanta do të bazohet në të dhënat e faturës. Kategoria që nuk mund të caktohet automatikisht bazuar në të dhënat e faturës, do të duhet të ndryshohet manualisht nga tatimpaguesi përmes platformës qendrore të faturave. Sidoqoftë, vlera e faturës dhe të dhënat e tjera të faturave të paraqitura në administratën tatimore gjatë procedurës së fiskalizimit, nuk mund të ndryshohen në platformën qendrore të faturave.

6. Të dhënat e faturave në librin e blerjeve dhe librin e shitjeve duhet të jenë ekzaktësisht të njëjta me të dhënat në faturat që i janë lëshuar blerësit dhe ato nuk mund të ndryshohen në platformën qendrore të faturave. Nëse disa nga të dhënat e faturës janë të pasakta, tatimpaguesi që ka lëshuar faturën në fjalë do të duhet të lëshojë një faturë korrigjuese. Vlerat e faturës nuk mund të ndryshohen në platformën qendrore të faturave dhe as në librin e blerjeve dhe shitjeve, si dhe nëse ekziston një gabim në shumën e faturës (pavarësisht nëse fatura është me ose pa TVSH) duhet të lëshohet një faturë korrigjuese.

7. Meqenëse libri i shitjeve dhe blerjeve plotësohet automatikisht, tatimpaguesi do të duhet vetëm ta kontrollojë atë dhe të japë informacione shtesë nëse është e nevojshme (për shembull nëse fatura konsiderohet si investim).

8. Transaksioni që nuk është regjistruar në administratën tatimore nuk mund të shtohet në libër nëse fatura nuk është fiskalizuar. Në këtë rast, blerësi mund t'i raportojë Administratës Tatimore që një shitës ka lëshuar fatura që nuk janë fiskalizuar dhe administrata tatimore do ta kontrollojë atë tatimpagues. Për importimin, fiskalizimi do të bazohet në deklaratën doganore të dërguar nga administrata doganore në administratën tatimore.

9. Libri i shitjeve dhe libri i blerjeve mund të shkarkohen nga tatimpaguesi, në platformën qendrore të faturave.

10. Koha për lëshimin e faturës është e përcaktuar me Ligj dhe pasi procesi i fiskalizimit të përfundojë, të dhënat duhet të regjistrohen automatikisht në librin e shitjeve dhe blerjeve, bazuar në datën e lëshimit të faturës ose nëse lëshohet një faturë përmbledhëse, bazuar në periudhën e përcaktuar në faturë.

11. Nëse blerësi nuk pranon faturën elektronike në momentin e verifikimit të saj, të dërguar nga shitësi nëpërmjet platformës qendrore të faturave, atëherë kjo faturë nuk do të regjistrohet në librin e blerjes së blerësit, por do të regjistrohet vetëm në librin e shitjeve të shitësit. Shitësi do të duhet të lëshojë një faturë korrigjuese nëse do të duhet të anulojë transaksionin nga libri i tij i shitjeve. Vetëm për këtë rast, fatura korrigjuese nuk do të regjistrohet në librin e blerjes së blerësit, pasi fatura origjinale që po korrigjohet gjithashtu nuk është e regjistruar në librin e tij të blerjes.

12. Tatimpaguesi mund të rishikojë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve. Pavarësisht kësaj të drejte për rishikim të librave, tatimpaguesi nuk mund të shtojë në libra, fatura që nuk janë fiskalizuar apo që nuk përmbajnë NIPT-in e tij.

13. Të dhënat nga librat e blerjeve dhe shitjeve do të përdoren për të plotësuar automatikisht deklaratën e TVSH-së.

Neni 21

Pajisjet fiskale dhe zgjidhja software-ike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit

1. Zgjidhja software-ike për procedurën e fiskalizimit

1.1. Zgjidhja software-ike e përmendur në nenin 3, shkronja "k", të Ligjit, nënkupton programin e përshtatshëm për zbatimin e Ligjit dhe të këtij udhëzimi që përdoret nga tatimpaguesi dhe që është e certifikuar nga AKSHI dhe administrata tatimore qendrore.

1.2. Zgjidhja software-ike për pagesa me para në dorë përmban shërbimet e mëposhtme të fiskalizimit:

a) regjistrimin e një pajisjeje elektronike të faturimit;

b) regjistrimin e vlerës fillestare të parave në arkë dhe ndryshimet gjatë ditës;

c) fiskalizimi i faturave të lëshuara.

1.3. Zgjidhja software-ike për pagesa pa para në dorë përmban një shërbim fiskalizimi për fiskalizimin e faturave.

1.4. Zgjidhja software-ike për pajisjet e vetëshërbimit (automatët) përmban një shërbim fiskalizimi për regjistrimin e pajisjeve të vetëshërbimit dhe fiskalizimin e të dhënave të shitjeve.

1.5. Specifikimet teknike për zgjidhjen software-ike publikohen në faqen e internetit të administratës tatimore.

1.6. Nuk nevojitet memorie specifike fiskale (WORM) për procesin e fiskalizimit. Sidoqoftë, secila faturë e lëshuar duhet të ruhet nga tatimpaguesi që lëshon fatura, në sistemin e tij elektronik të informacionit (në kujtesën e pajisjeve elektronike të përdorura për lëshimin e faturave, ose në një server tjetër, ose në kujtesë të jashtme) gjatë periudhës së ruajtjes të përcaktuar në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, për të garantuar që fatura mund të paraqitet, nëse kërkohet, brenda një kohe të arsyeshme, në të njëjtën mënyrë siç kërkohet menjëherë, përfshirë në rastin pas procesit të konvertimit, në një formë të lexueshme në ekran ose e printuar. Duhet të jetë e mundur që të kontrollohet se informacioni ndërmjet skedarit origjinal elektronik dhe dokumentit të lexueshëm nuk ka ndryshuar.

1.7. Kërkesa për mjedis fizik me siguri të lartë lidhet me mjedisin e kompjuterit ku ruhet certifikata digjitale. Kompanitë e TI-së duhet të garantojnë se ekzistojnë kontrolle për aksesin sipas standardit të industrisë, të cilat parandalojnë nxjerrjen/eksportimin e paautorizuar të certifikatës digjitale.

1.8. Zgjidhja e software-it mund të përdoret në çdo pajisje elektronike, pavarësisht nga mënyra e pagesës së faturës dhe nuk nevojitet asnjë autorizim nga administrata tatimore qendrore ose autoritet tjetër për këtë pajisje elektronike. Gjithashtu, faturat mund të printohen në çdo printer.

1.9. Çdo faturë do të fiskalizohet vetëm një herë, në shumicën e rasteve nga lëshuesi i faturës, por në raste të veçanta të përcaktuara me ligj, kur shitësi nuk e fiskalizon faturën, atëherë procedurën e fiskalizimit duhet ta kryejë blerësi.

2. Testimi i sistemit të fiskalizimit para fillimit të lëshimit të faturave

2.1. Sipas Ligjit, tatimpaguesi që lëshon fatura mund të kryejë testimin e të dhënave të faturës dhe mesazhit të faturës që duhet t'i dërgohet administratës tatimore gjatë procedurës së fiskalizimit, duke marrë certifikatën për mjedisin e provës në përputhje me nenin 23 të këtij udhëzimi.

2.2. Sistemi i provës duhet të zbatohet përmes procedurës së parashikuar në nenin 23 të këtij udhëzimi.

2.3. Testimi i procesit të shkëmbimit të mesazheve do të bëhet në një mjedis prove, duke hyrë në sistemin e informacionit të administratës tatimore, në përputhje me nenin 23 të këtij udhëzimi.

2.4. Procesi i testimit të informacionit të të dhënave të faturës do të kryhet sipas procedurës së përmendur në pikën 2.3 të këtij neni, së bashku me verifikimin shtesë të të dhënave të faturës, sipas një grupi specifik të rregullave dhe kthimit të një mesazhi që tregon se janë përmbushur rregullat.

3. Kërkesat e memories

3.1. Sipas nenit 3, shkronja "k", të Ligjit, pajisjet fiskale me qëllim të kryerjes së procedurës së fiskalizimit për faturat për shitjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve të paguara me para në dorë, përbëhen nga një pajisje elektronike e faturimit e aftë të ruajë të gjithë informacionin në memorie të sigurt në lidhje me të dhënat fiskale për faturat e lëshuara dhe të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara (për shembull, gjendjen e parave në arkë).

3.2. Memoria e sigurt, përkatësisht vendruajtja e mbrojtur, duhet të jetë një lloj WORM (Shkruaj një herë, Lexo shumë herë), do të thotë që asnjë e dhënë nuk mund të ndryshohet pasi të shkruhet brenda memories dhe gjithashtu nuk duhet të jetë e mundur që e dhëna të fshihet ose të rishkruhet, por funksionaliteti i leximit të ruhet pa kufi dhe mund të bazohet ose në hardware (për shembull kartë SD, memorie fiskale ose të ngjashme) ose në ndarjen e siguruar virtuale të memories ekzistuese të pajisjes.

3.3. Kapaciteti i memories duhet të jetë së paku 4 GB për çdo pajisje elektronike të parave *cash* që përdoret për lëshimin e faturave.

3.4. Nëse përdoret ndarja virtuale e memories së sigurt, Firmware-i për një memorie të tillë të siguruar virtuale, duhet të nënshkruhet me një certifikatë të vlefshme të njohur vetëm për prodhuesin, që do të thotë se mund të ngarkohet vetëm një herë gjatë procesit të prodhimit. Në rast se një certifikatë e tillë bëhet e njohur publikisht, ajo nuk do të jetë më e vlefshme dhe prodhuesi do të duhet të përmirësojë/zëvendësojë të gjitha pajisjet e tilla në terren.

3.5. Në rastin e një zgjidhje hardware ose për pajisjen elektronike të parave të gatshme me zgjidhje software-ike përbërëse dhe memorie të sigurt për lëshimin e faturave dhe procedurës së fiskalizimit ose memorie thjesht të siguruar (memoria e jashtme HW, pra karta e sigurt ose e ngjashme), të gjithë çipet përbërës të kontakteve të memories ose media të tjera (përveç portës së komunikimit) nuk duhet të jenë të arritshme për përdoruesit, pra për tatimpaguesin që lëshon fatura. Është e nevojshme të përdoret një material i përshtatshëm jo i heqshëm, i cili do të mbrojë hyrjen fizike në media që përdoret për ruajtje të mbrojtur. Prodhuesi duhet të sigurojë që një zgjidhje e tillë të mbrohet nga sulmuesit e jashtëm, të cilët mund të modifikojnë të dhënat e ruajtura.

3.6. Prodhuesi i zgjidhjes software-ike për pajisjet elektronike të faturimit, mund të zgjedhë të hartojë ose të përdorë mjete të tjera të përshtatshme dhe të sigurta për mbrojtjen e të dhënave, për shembull teknologjia e palëve të treta, ku lloji i memories WORM sigurohet nga një proces prodhimi standard (për shembull, kartat SD të specializuara). Në rast të përdorimit të teknologjisë së palëve të treta (pra karta SD) komunikimi midis kujtesës së palës së tretë dhe zgjidhjes së software-it duhet të jetë i koduar, duke përdorur teknologji të përshtatshme (pra PKI). Prodhuesi duhet të sigurojë që të gjitha mesazhet e shkëmbyera midis zgjidhjes software-ike të certifikuar dhe ruajtjes së mbrojtur nuk mund të modifikohen, interceptohen, kopjohen ose preken diku tjetër përpara se ato të shkruhen përgjithmonë në memorien e sigurt. Prodhuesi duhet të sigurojë që një sulmues i jashtëm ose një software i jashtëm malware apo virus nuk mund të ndërpresë komunikimin midis zgjidhjes software-ike të certifikuar dhe memories së siguruar, për shembull duke krijuar memorie sekondare virtuale të fshirë ose me ndonjë metodë për të mashtruar software-in për të ruajtur të dhëna në ndonjë memorie tjetër, përveç memories së siguruar.

3.7. Prodhuesi i zgjidhjes software-ike të certifikuar duhet të përdorë metodën e duhur unike për ruajtjen e të dhënave të përhershme në memorien fiskale. Nëse një zgjidhje e jashtme software-ike e certifikuar (aplikacion *cloud*) përdoret për lëshimin e faturave dhe procedurën e fiskalizimit, duhet të komunikojë në mënyrë të koduar me memorien e sigurt.

3.8. Certifikata digjitale e lëshuar nga AKSHI duhet të kopjohet në memorien e sigurt. Memoria e sigurt do të përmbajë hapësirë për të paktën 20 të dhëna autentifikimi dhe identifikimi (certifikata digjitale), ku gjithmonë përdoren vetëm grupet e të dhënave të fundit të autentifikimit dhe identifikimit. Të dhënat e autentifikimit dhe identifikimit të ngarkimit duhet të jenë të arritshme si parazgjedhje.

3.9. Certifikata digjitale e tatimpaguesit (pjesë e të dhënave të vërtetimit) duhet të përdoret kur nënshkruhen mesazhe të të dhënave vetëm nga memoria e sigurt dhe nëse memoria nuk është e arritshme, tatimpaguesi nuk mund të nënshkruajë mesazhin e të dhënave.

3.10. Në rastin kur nuk ka më hapësirë të lirë për mbushjen e memories së sigurt, zgjidhja e software-it nuk lejon që tatimpaguesi të krijojë, lëshojë dhe printojë fatura që duhet të ruhen ndryshe në memorien e mbrojtur, derisa memoria e tillë e mbushur të zëvendësohet me memorie të re. Tatimpaguesi duhet të ruajë memorien e mbushur për gjithë periudhën për ruajtjen e faturave, sipas kërkesave të Ligjit. Zgjidhja software-ike duhet të ketë mekanizëm paralajmërues që tatimpaguesi të jetë në gjendje të zëvendësojë ose shtojë memorie shtesë nëse është e nevojshme.

3.11. Verifikimi i kërkesave të memories të përshkruara në këtë nen do të jetë pjesë e procedurës së certifikimit të zgjidhjes software-ike për lëshimin e faturave dhe procedurën e fiskalizimit.

Neni 22
Certifikata elektronike

Procedura për marrjen e një certifikate digjitale për autentifikimin e tatimpaguesit që lëshon fatura dhe për nënshkrimin elektronik të çdo mesazhi fiskalizimi, përshkruhet në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 23
Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës

1. Procesi i shkëmbimit të të dhënave mes tatimpaguesit që lëshon fatura dhe administratës tatimore

1.1. Procesi i shkëmbimit të të dhënave midis tatimpaguesit dhe sistemit të informacionit të administratës tatimore për qëllimin e fiskalizimit të faturës fillon kur operatori krijon një faturë në pajisjen elektronike, e cila do t'i lëshohet blerësit.

1.2. Procesi i shkëmbimit të të dhënave, sipas pikës 1.1. të këtij neni, përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

a) pika e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura (e cila mund të jetë pajisja elektronike e përdorur ose sistemi i përdorur i informacionit) përgatit informacionet për faturën dhe bazuar në to, llogarit numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF);

b) pika e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura duhet të përgatisë mesazhin e kërkesës XML dhe ta nënshkruajë atë elektronikisht me çelësin privat të certifikatës elektronike të aplikacionit, lëshuar për tatimpaguesin që lëshon fatura me qëllim të fiskalizimit;

c) pika e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura nis një komunikim të sigurt me një drejtim, ndërsa serveri i administratës tatimore paraqitet me certifikatën e serverit;

ç) pasi të jetë vendosur me sukses komunikimi i sigurt, bëhet një thirrje e shërbimit të fiskalizimit;

d) sistemi i informacionit të administratës tatimore merr dhe përpunon mesazhin e kërkesës. Nëse kërkesa përpunohet me sukses, sistemi i administrimit të administratës tatimore përgatit një mesazh përgjigjeje XML që përmban NIVF, e nënshkruan në mënyrë elektronike me çelësin privat të aplikacionit të certifikatës digjitale dhe e dërgon në pikën e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura;

dh) pika e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura merr një mesazh përgjigjeje dhe verifikon nënshkrimin elektronik me çelësin publik të certifikatës elektronike të aplikacionit;

e) operatori që lëshon fatura, pas kësaj do të printojë faturën dhe do t'ia dorëzojë konsumatorit (për transaksione me para në dorë) ose do t'ia dërgojë faturën në formë elektronike konsumatorit (për transaksione pa para në dorë, siç përcaktohet në nenet 24 dhe 25 të Ligjit), me NIVF si një nga elementët e detyrueshëm të secilës faturë.

2. Lëshimi i faturave kur ndodh një gabim gjatë procesit të fiskalizimit

2.1. Nëse gabimi i mëposhtëm ndodh kur përpunohet mesazhi i kërkesës, siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni, gabimi i sistemit ndodh gjatë përpunimit të kërkesës, ose ka një gabim teknik, ose gabimi lidhet me certifikatën digjitale, sistemi i informacionit të administratës tatimore qendrore do të kthejë një mesazh XML si përgjigje për pajisjen elektronike të tatimpaguesit që lëshon faturë, i cili përmban përshkrimin e gabimit. Në këtë rast, mesazhi i përgjigjes nuk përfshin NIVF-në dhe:

a) operatori në pajisjen elektronike të faturimit ia lëshon faturën klientit pa NIVF;

b) operatori në pajisjen elektronike që lëshon fatura elektronike ose mirëmbajtësi i software-it, do të korrigjojë gabimin dhe do të përsërisë procesin derisa të marrë NIVF-në. Mesazhi i përsëritur XML duhet të jetë i njëjtë me një shënim shtesë, që tregon se është një veprim i përsëritur. Nëse ky shënim mungon ose NSLF është e ndryshme nga NSLF e printuar në faturën e lëshuar, mesazhi do të regjistrohet si një proces krejtësisht i ndryshëm i lëshimit të faturës. Në rast të transaksionit pa para në dorë, kur duhet të lëshohet një faturë elektronike, vetëm pasi fatura është fiskalizuar me sukses, shitësi mund të lëshojë dhe t'i dërgojë blerësit faturën elektronike.

2.2. Procesi i lëshimit të faturave të klientit në rastin e transaksioneve me para në dorë nuk duhet të pengohet nga një gabim i sistemit ose teknik. Sidoqoftë, tatimpaguesi që lëshon fatura është i detyruar të përsërisë procesin e përmendur sipas

pikës 1 të këtij neni dhe të dërgojë mesazhin më pas, jo më vonë se 48 orë, nga momenti i lëshimit të faturës pa NIVF.

2.3. Nëse gjatë përpunimit të kërkesës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, ndodh ndonjë gabim tjetër i përmendur në pikën 9 të këtij neni, përveç atyre të përmendur në pikën 2.1 të këtij neni, sistemi i informacionit të administratës tatimore qendrore do të kthejë një përgjigje, mesazh XML, e cila përmban një përshkrim gabimi. Në këtë rast, mesazhi i përgjigjes nuk do të përmbajë një NIVF dhe operatori nuk mund të lëshojë faturën tek klienti derisa të zgjidhë gabimin dhe të përsërisë procedurën e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

2.4. Vetëm kur tatimpaguesi që lëshon fatura merr mesazhin e përgjigjes së saktë nga sistemi i informacionit të administratës tatimore që përmban NIVF, ai mund të jetë i sigurt se fatura është raportuar në administratën tatimore.

2.5. Tatimpaguesit, të cilët sipas ligjit për procedurat tatimore, janë në regjistrin pasiv të administratës tatimore, nuk duhet të lëshojnë ose marrin fatura për qëllime biznesi, përveçse kur ata ndryshojnë statusin e tyre. E njëjta gjë vlen edhe nëse tatimpaguesit kanë aplikuar për çregjistrimin e aktivitetit të biznesit dhe kanë çregjistruar aktivitetin e tyre të biznesit.

3. Koha maksimale e marrjes së mesazhit të përgjigjes

3.1. Koha maksimale (afati kohor) që pikës së hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura i duhet të presë një mesazh përgjigjeje nga sistemi i informacionit të administratës tatimore, përcaktohet nga vetë tatimpaguesi.

3.2. Tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të bëjë një vlerësim të kohës, duke marrë parasysh llojin dhe disponueshmërinë e lidhjes në internet që ai/ajo përdor dhe kohën e pranueshme për marrjen e një përgjigjeje. Vlerësimi gjithashtu duhet të marrë në konsideratë kohën maksimale prej 2 sekondash gjatë së cilës sistemi informativ i administratës tatimore duhet të përpunojë mesazhin e kërkesës dhe të kthejë mesazhin e përgjigjes (koha që nga momenti kur mesazhi i kërkesës hyn në sistem deri sa të dalë mesazhi i përgjigjes nga sistemi).

4. Grupi i të dhënave për fiskalizimin

4.1. Grupi i të dhënave për procesin e fiskalizimit të faturës, i cili dërgohet gjatë secilit proces të fiskalizimit të faturës në sistemin e informacionit të administratës tatimore, është specifikuar në specifikimet funksionale të shërbimit të fiskalizimit, të publikuar në faqen e internetit të administratës tatimore qendore.

4.2. Procedura e fiskalizimit për importimin e mallrave do të përdorë të dhënat që i janë dërguar administratës tatimore nga administrata doganore në deklaratën doganore, kështu që fiskalizimi i faturave nga jashtë do të bazohet në të dhënat e paracaktuara dhe tatimpaguesi do të duhet të shtojë vetëm informacionin që mungon, sipas nenit 25 të këtij udhëzimi, nga fatura e tatimpaguesit të huaj. Fiskalizimi do të bazohet në deklaratën doganore, kështu që vetëm pasi të marrë deklaratën doganore lind detyrimi për fiskalizimin e faturës.

5. Protokollet dhe mekanizmat e sigurisë për shkëmbimin e mesazheve

5.1. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura duhet të sigurojnë mbështetje në pajisje (hardware) dhe programe (software) për shkëmbimin e mesazheve me pikën e hyrjes së sistemit të informacionit të administratës tatimore, si dhe për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.

5.2. Zgjedhja e pajisjeve është përgjegjësi e tatimpaguesit dhe ky informacion nuk është i nevojshëm të raportohet në administratën tatimore. Zgjedhja e software-it është gjithashtu përgjegjësi e tatimpaguesit, por ai mund të zgjedhë vetëm një software që është i certifikuar nga AKSHI dhe administrata tatimore qendrore. Informacioni mbi prodhuesit e software-ve dhe zgjidhjen software-ike të zgjedhur duhet t'i raportohet administratës tatimore:

a) gjatë regjistrimit të parë provë në sistemin e fiskalizimit të pajisjes elektronike të faturimit për transaksione me para në dorë;

b) në formularin "Informacion për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit", përcaktuar në nenin 17 të këtij udhëzimi në nivelin e çdo vendi të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (vetëm mirëmbajtësi i zgjidhjes software-ike) dhe për transaksionet me para në dorë në formularin "Regjistrimi i pajisjeve elektronike të faturimit", të përcaktuar në nenin 17 të këtij udhëzimi, kur tatimpaguesi që lëshon fatura kryen veprimtari biznesi në zonën ku nuk ka lidhje në internet;

c) si element i detyrueshëm, në secilin mesazh kërkese gjatë procedurës së fiskalizimit për faturat elektronike.

6. Kërkesat online (në internet)

6.1. Në mënyrë që të mund të lidheni me sistemin e informacionit të administratës tatimore, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme online:

a) lloji i rrjetit: Internet;

b) portet e kërkuara të hapura TCP (Transferimi i Protokollit të Kontrollit) sipas CIS – 8849;

c) shpejtësi e mjaftueshme interneti.

6.2. Tatimpaguesi që lëshon fatura, përcakton xhiron e duhur në mënyrë të pavarur në bazë të numrit të mesazheve për sekondë në momentin e ngarkesës maksimale.

6.3. Zgjidhja software-ike e tatimpaguesit për të realizuar procedurën e fiskalizimit të përcaktuar në nenin 21 të këtij udhëzimi, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Standardet e Krijimit të Klientëve ËS-I;

b) Lloji i dokumentit të shërbimit-fjalë për fjalë; dhe

c) Protokolli i aplikimit të SOAP/HTTPS (SOAP 1.1).

7. Protokolli i komunikimit

7.1. Sistemi i informacionit të administratës tatimore, për qëllimet e procedurës së fiskalizimit të faturave të lëshuara, është i disponueshëm në dy mjedise:

a) mjedisi i provës; dhe

b) mjedisi i prodhimit.

7.2. Mjedisi i provës dhe prodhimit të sistemit të informacionit të administratës tatimore ndryshojnë nga adresat dhe certifikatat e ndryshme të pikës së hyrjes.

7.3. Regjistri i Certifikatave Elektronike të AKSHI-t do të jetë ofruesi i PKI-së dhe AKSHI do të lëshojë dy certifikata të ndryshme për mjediset e provës dhe të prodhimit.

7.4. Përdorimi i certifikatës nga ana e sistemit të informacionit të administratës tatimore në pikën e hyrjes është:

a) vendosja e një lidhjeje të sigurt me sistemin e informacionit;

b) nënshkrimi elektronik i mesazheve.

7.5. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet sistemit të informacionit dhe pikës së hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura bëhet përmes një shërbimi në internet duke përdorur mesazhe XML.

7.6. Komunikimi me sistemin e informacionit mbrohet nga një kodim i sigurt në fushën e transportit.

7.7. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura, hyjnë në sistemin e informacionit të administratës tatimore CIS, duke filluar një lidhje të sigurt me një drejtim.

7.8. Duke përdorur një kanal të sigurt, tatimpaguesit shkëmbejnë mesazhe me pikën e hyrjes së administratës tatimore.

7.9. Shkëmbimi i të dhënave është në sinkron, që do të thotë se pika e hyrjes i përgjigjet menjëherë kërkesës së përdoruesit.

7.10. Formati i mesazhit të vendosur për të dhënat e kërkesës dhe të dhënat e përgjigjes për faturën specifikohet përmes skemës XML, skemë e cila specifikohet në specifikimet teknike të publikuara në faqen zyrtare të administratës tatimore.

8. Verifikimi i mesazheve të marra nga sistemi i informacionit të administratës tatimore

8.1. Pas marrjes së mesazhit nga pika e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura gjatë procedurës së fiskalizimit, sistemi i informacionit të administratës tatimore zhvillon procedurën e verifikimit bazuar në kërkesat e paracaktuara që duhet të përmbushë mesazhi pranues. Procesi i verifikimit për të gjitha mesazhet e pranuara mund të ndahet në dy kategori:

a) verifikimi që bëhet menjëherë pas marrjes së një mesazhi XML dhe para se të ruhet mesazhi në bazën e të dhënave (verifikim në kohë reale);

b) verifikimi që bëhet më pas, pas lëshimit të NIVF-së dhe dërgimit të mesazhit të përgjigjes në pikën e hyrjes së tatimpaguesit, si dhe pasi të ruhet mesazhi në bazën e të dhënave (verifikimi dytësor).

8.2. Verifikimi në kohë reale përfshin:

a) verifikimin e autorizimit (pra verifikimi elektronik i nënshkrimit dhe verifikimi i certifikatës elektronike);

b) verifikimin e formalitetit [verifikimi i mesazhit XML në lidhje me skemën e përshkruar XML, përfshirë verifikimin nëse tatimpaguesi ka plotësuar të gjithë elementët e kërkuar nga skema dhe verifikimin e madhësisë së mesazhit (nuk duhet të jetë më i madh se 150 kB dhe jo me shumë se 1000 artikuj)];

c) verifikimin e bazës (pra, verifikimin e të dhënave të faturave të paraqitura), i cili përfshin:

i. verifikimin nëse tatimpaguesi që lëshon faturën është subjekt i TVSH-së, dhe më pas verifikon se nuk ka TVSH të ngarkuar, nëse tatimpaguesi nuk është subjekt i TVSH-së;

ii. verifikimin e mënyrës së pagesave, pra nëse është në përputhje me shumën maksimale të pagesës të parashikuar në përputhje me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë;

iii. verifikimin e "vetëfaturimit", pra duhet të plotësohen fushat e blerësit.

8.3. Verifikimi dytësor përfshin:

a) kontrollin e ndryshimeve kohore ndërmjet kohës së lëshimit të faturës të deklaruar në faturë dhe kohës së fiskalizimit, në krahasim me intervalin mesatar të kohës dhe me afatet kohore të përcaktuara në ligj (48 orë ose 5 ditë);

b) kontrollin e numrit të faturës (për shembull strukturën e numrit, numrin rendor, përsëritjen e të njëjtit numër etj.);

c) kontrollin numerik për qëllime të TVSH-së (për shembull, baza e tatueshme, shuma e TVSH-së, shuma totale me TVSH etj.);

ç) kontrollin numerik në përgjithësi për korrektësinë e të dhënave të paraqitura;

d) kontrollin e faturës korrigjuese dhe faturës përkatëse të ndryshuar, pra të korrigjuar;

dh) verifikimin nëse tatimpaguesi që lëshon faturat është në regjistrin pasiv të tatimpaguesve;

e) kontrolle të tjera (kontrollin e kodit të pajisjes elektronike të faturimit, kontrollin e kodit të operatorit, kontrollin e kodit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, kontrollin e kodit të zgjidhjes software-ike, kontrollin e NSLF-së etj.).

8.4. Nëse gjatë procedurës së verifikimit në kohë reale ka ndodhur një gabim, sistemi i informacionit të administratës tatimore nuk gjeneron NIVF dhe duhet të përgatisë një mesazh përgjigjeje me përshkrimin e gabimit të hasur, e nënshkruan atë në mënyrë digjitale dhe e dërgon në pikën e hyrjes së tatimpaguesit që lëshon fatura, i cili më pas do të kryejë procedurën siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

8.5. Nëse gjatë procedurës së verifikimit dytësor ka ndodhur një gabim, sistemi i informacionit të administratës tatimore përgatit një mesazh përgjigjeje me referencë NIVF të faturës së verifikuar dhe me përshkrimin e gabimit të hasur, e firmos në mënyrë digjitale dhe e dërgon atë te tatimpaguesi që lëshon fatura, në llogarinë e tij të përdoruesit në platformën qendrore të faturave. Tatimpaguesi që lëshon fatura është i detyruar ta korrigjojë gabimin dhe nëse është e nevojshme, në varësi të llojit të gabimeve, të lëshojë një faturë korrigjuese, para mbylljes së librit të shitjeve dhe blerjeve për muajin në të cilin ose për të cilin lëshohet fatura, të përsërisë procesin e fiskalizimit dhe t'i dërgojë faturën e korrigjuar blerësit.

9. Lista e mesazheve të gabimit

9.1. Gjatë procedurës së fiskalizimit të faturës së lëshuar dhe procedurës së verifikimit në kohë reale sipas pikës 8.2 të këtij neni, sistemi i informacionit të administratës tatimore mund të dërgojë një nga mesazhet e mëposhtme të gabimit:

a) çështje teknike, të cilat duhet të riparohen nga prodhuesi ose mirëmbajtësi i software-it:

- përjashtimi ka ndodhur gjatë nxjerrjes së mesazhit të marrë XML gjatë kontrollit të madhësisë;
- përjashtimi ka ndodhur gjatë nxjerrjes së mesazhit të marrë XML gjatë vlefshmërisë XML përkundrejt XSD;
- mesazhi i marrë XML nuk kreu validimin XSD;
- përjashtimi ka ndodhur gjatë nxjerrjes së mesazhit të marrë XML gjatë kontrollit të nënshkrimit;
- mesazhit të marrë XML i mungon elementi i nënshkrimit XML;
- mesazhit të marrë XML i mungon elementi XML "RegisterInvoiceRequest";
- përjashtimi ka ndodhur gjatë nxjerrjes së elementit të nënshkrimit XML gjatë kontrollit të nënshkrimit;
- siguroi më shumë se një element nënshkrimi XML;
- u nënshkrua elementi i gabuar XML;
- metodë e gabuar nënshkrimi e specifikuar;
- metodë e gabuar kanonizimi;
- metodë e gabuar tretjeje;
- nënshkrim kriptografik i gabuar;
- llogaritja e tretjes është e gabuar;
- nënshkrimi i përgjithshëm i gabuar;
- ka më shumë elementë kyç (keyInfo) nga sa duhen;
- mungon kodi i zgjidhjes software-ike.

b) çështje materiale dhe substancash që duhet të korrigjohen nga tatimpaguesi:

- mesazhi i marrë XML tejkalon madhësinë e lejuar (nëse ka shumë artikuj në faturë dhe rrjedhimisht mesazhi është më i madh se 150 kB, tatimpaguesi që lëshon fatura në vend të një, lëshon dy ose më shumë fatura për të përmbushur kërkesën e madhësisë së mesazhit);
- certifikata e dhënë nuk është e llojit X509 (në

këtë rast tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të marrë një certifikatë të re digjitale nga AKSHI);

- certifikata e dhënë nuk është e vlefshme (në këtë rast tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të marrë një certifikatë të re digjitale nga AKSHI);

- certifikata nuk është lëshuar nga AKSHI (në këtë rast tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të marrë një certifikatë të re digjitale nga AKSHI);

- certifikata ka skaduar (në këtë rast tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të marrë një certifikatë të re digjitale nga AKSHI);

- krahasoni NIPT-in në XML me NIPT-in në certifikatë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të përdorë një nënshkrim të saktë digjital ose të marrë një certifikatë të re digjitale nga AKSHI. Në rastin kur lëshuesi është një palë e tretë e autorizuar, atëherë kjo duhet të jetë e regjistruar në administratën tatimore qendrore);

- shuma e faturës është shumë e madhe për t'u paguar me para në dorë (do të thotë që shuma totale e faturës është më e lartë se shuma maksimale që mund të paguhet me para në dorë në përputhje me ligjin për procedurat tatimore. Pra, blerësi nuk mund të paguajë me para në dorë dhe tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të lëshojë një faturë elektronike, sipas nenit 24 të Ligjit);

- Shitësi nuk i nënshtrohet TVSH-së (kjo do të thotë që shitësi nuk mund të ngarkojë TVSH-në në faturë, përveç nëse regjistrohet në regjistrin e TVSH-së, ose nëse nuk lejohet sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar);

- Shitësi i nënshtrohet TVSH-së (kjo do të thotë që shitësi duhet të ngarkojë TVSH-në në sasinë e tatueshme të deklaruar në faturë, përveç nëse furnizimi i vërtetë i mallrave ose shërbimeve përjashtohet nga tatimi, sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar. Në rastin e fundit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të tregojë në faturë dispozitën e zbatueshme të këtij ligji që përcakton përjashtimin);

c) përjashtimi i serverit të brendshëm - gabimi i sistemit gjatë përpunimit të kërkesës. Në këtë situatë, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të përsërisë procedurën e fiskalizimit në një kohë të mëvonshme.

9.2. Gjatë procedurës së fiskalizimit të faturës së lëshuar dhe procedurës së verifikimit bazuar në pikën 8.3. të këtij neni, sistemi i informacionit të administratës tatimore mund të dërgojë një nga mesazhet e mëposhtme të gabimit:

a) koha e lëshimit të faturës devijon nga intervali mesatar kohor (ky është më shumë një mesazh paralajmërues, në mënyrë që tatimpaguesi të mund të kontrollojë nëse data dhe ora e vendosur në pajisjen ose zgjidhjen e software-it të përdorur për lëshimin e faturave janë të sakta dhe të përditësuara);

b) koha e lëshimit të faturës është jashtë afateve të përcaktuara në ligj (tatimpaguesi që lëshon fatura do të kontrollojë nëse data dhe ora e caktuar në pajisjen ose zgjidhjen e software-it të përdorur për lëshimin e faturave janë të sakta dhe të përditësuara, si dhe njofton Administratën Tatimore për arsyet e këtij devijimi, nëse ai nuk e ka bërë akoma);

c) numri i faturës nuk është i saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë strukturën e numrit dhe numrin vijues, si dhe të korrigjojë gabimin);

ç) fatura me këtë numër të faturës është lëshuar dhe fiskalizuar më parë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë atë faturë dhe nëse kjo është shkaktuar nga një gabim i fiskalizimit të dyfishtë, duhet të lëshojë një faturë korrigjuese me shumë negative dhe ta fiskalizojë atë. Në raste të tjera, ai duhet të veprojë sipas gabimit të hasur);

d) shuma totale e faturës nuk është e saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë llogaritjen e shumës së faturës dhe të lëshojë një faturë korrigjuese dhe më pas ta fiskalizojë atë);

dh) shuma e TVSH-së nuk është e saktë [tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë llogaritjen e shumës së TVSH-së (për shembull, shkalla e TVSH-së së aplikuar, TVSH-ja e llogaritur në secilin artikull dhe shuma e TVSH-së për normën e tatueshme etj.) dhe të lëshojë një faturë korrigjuese, si dhe ta fiskalizojë atë];

e) kodi i software-it nuk është i saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë kodin dhe ta korrigjojë nëse nuk është i saktë ose të kontaktojë prodhuesin e software-it);

ë) kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nuk është i saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë kodin e dërguar në mesazhin XML tek administrata tatimore qendrore dhe atë të gjeneruar nga sistemi i informacionit i administratës tatimore të ruajtur në platformën qendrore të faturave dhe ta korrigjojë nëse nuk është e korrigjuar ose të kontrollojë të dhënat në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të ruajtur në platformën qendrore të faturave);

f) kodi i operatorëve nuk është i saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë kodin e dërguar në mesazhin XML për administratën tatimore dhe atë të gjeneruar nga sistemi i informacionit të administratës tatimore të ruajtur në platformën qendrore të faturave dhe ta korrigjojë nëse nuk është korrigjuar ose të kontrollojë të dhënat për operatorin e ruajtur në platformën qendrore të faturave);

g) kodi i pajisjes elektronike të faturimit nuk është i saktë (tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë kodin e dërguar në mesazhin XML për administratën tatimore dhe atë të gjeneruar nga sistemi i informacionit të administratës tatimore të ruajtur në platformën qendrore të faturave dhe ta korrigjojë nëse nuk është i saktë ose të kontrollojë të dhënat në pajisjen e ruajtur në platformën qendrore të faturave);

gj) referenca e faturës korrigjuese nuk ekziston (tatimpaguesi ka mundur që, së pari të fiskalizojë faturën korrigjuese para fiskalizimit të faturës origjinale me të cilën lidhet ose ka bërë një referencë të gabuar, dhe duhet t'i korrigjojë këto parregullsi, pra të fiskalizojë faturën origjinale ose të korrigjojë referencën për faturën origjinale);

h) faturë korrigjuese dhe faturë origjinale nga tatimpagues të ndryshëm (fatura origjinale dhe fatura korrigjuese që e korrigjon dhe ka një referencë për të, të ketë të dhëna të ndryshme për shitësin që ka lëshuar faturën, kështu që faturat duhet të korrigjohen);

i) NSLF nuk është e saktë (është një çështje teknike që duhet të korrigjohet nga prodhuesi ose mirëmbajtësi i zgjidhjes software-ike të përdorur për lëshimin e faturës);

j) shitësi është në regjistrin pasiv (kjo do të thotë që shitësi nuk mund të lëshojë faturën përpara se të aktivizojë statusin e tij nga administrata tatimore qendrore, sipas procedurës së parashikuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore të tij);

k) blerësi është në regjistrin pasiv (kjo do të thotë që shitësi nuk mund t'ia lëshojë faturën atij blerësi, përpara se blerësi të aktivizojë statusin e tij nga administrata tatimore qendrore, sipas procedurës së parashikuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore të tij);

l) të tjera.

Neni 24

Fiskalizimi i transaksioneve të shkëmbimeve valutore

1. Zyrat e autorizuara të këmbimit të valutave duhet të lëshojnë një faturë të thjeshtuar me përmbajtjen e parashikuar në nenin 11 të Ligjit dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit gjatë kryerjes së transaksioneve të këmbimit të valutave, si dhe detyrime të tjera sipas Ligjit.

2. Zyrat e autorizuara të këmbimit janë të detyruara të konvertojnë sasinë e parave të blera të huaja në ekuivalentin e lekut me kursin e këmbimit me të cilin është kryer transaksioni i blerjes dhe ekuivalenti i deklaruar i lekut për qëllimin e fiskalizimit të faturës duhet të shprehet në faturën e fiskalizuar, me shenjën "-" para shumës së parave.

3. Për transaksionet e shitjeve në valutë, zyrat e autorizuara të këmbimit kërkojnë të raportojnë shumën e parave në lekë që marrin nga klienti për qëllime të fiskalizimit. Në këtë rast nuk ka nevojë të deklaroni shenjën "+" para shumës së parave të gatshme.

4. Fatura pas fiskalizimit do të printohet dhe do t'i jepet klientit dhe do të tregojë shumën në lekë, me shenjën përkatëse, e cila gjithashtu dërgohet gjatë procedurës së fiskalizimit në një mesazh XML, në mënyrë elektronike, në sistemin e informacionit të administratës tatimore.

5. Në faturë gjithashtu duhet të tregohet veçmas shuma e komisionit nëse aplikohet dhe shuma përfundimtare në lekë duhet të deklarohet pa përqindjen që, për shembull një zyrë shkëmbimi mund të marrë nga klienti për shërbimin e këmbimit. Pra, në thelb, shuma totale në lekë duhet të jetë shuma e saktë e marrë nga klienti ose që i është dhënë klientit për shkëmbimin e valutës së huaj.6. Përmbajtja e faturës në shkëmbimin e shërbimit për valutë është si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Shembull i të dhënave
1	Titulli: "Faturë e thjeshtuar"	
2	Numri i faturës (nuk nevojitet të printohet)	1-2020-bf132he962
3	Kodi i operatorit (nuk nevojitet të printohet)	ab1258697d
4	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (nuk nevojitet të printohet)	ëer5236879
5	Mënyra e pagesës (nuk nevojitet të printohet)	Kartëmonedha
6	Shuma e lekut ("-" për blerjen e valutës së huaj, pa shenjë për shitje të valutës së huaj)	(-) 36.703,26
7	Data e lëshimit të faturës	10.5.2020.
8	Koha e lëshimit të faturës	15:05:01
9	NIPT-i i tatimpaguesit (që ka zyrën e këmbimit)	L120345I
10	Emri i tatimpaguesit	Moneta
11	Adresa e tatimpaguesit	Rruga Toptani 3
12	Qyteti i tatimpaguesit	Tirana
13	Vendi i tatimpaguesit	Shqipëri
14	NIPT-i i blerësit (nëse është person i tatueshëm)	L123456P
15	Emri i blerësit (nëse është person i tatueshëm)	Jeronimo
16	Adresa e blerësit (nëse është person i tatueshëm)	Rrugaxxxx
17	Qyteti i blerësit (nëse është person i tatueshëm)	Tirana
18	Vendi i blerësit (nëse është person i tatueshëm)	Shqipëri
19	Përshkrimi i artikullit	Blerje e valutës së huaj/Shitje e valutës së huaj
20	Valuta (shkurtim sipas listës së kursit të këmbimit të publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë)	Valuta e huaj që do të këmbehet (EUR, USD, HRK…)
21	Shuma e parave që do të këmbehet	300
22	Komisioni: 1%	
23	Kursi i këmbimit	123,58
24	Shuma totale në LEK	37.074,00
25	Shuma totale e paguar për konsumatorin	36.703,26 LEK
26	Deklarata: Përjashtimi nga TVSH-ja bazuar në nenin 53, shkronja "d", të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	
27	NSLF	877246-3432-523235-23525
28	NIVF	121-4545-55435-23435235-252
29	Kodi QR	

Shembulli 1.

Blerja e valutës së huaj (në para në dorë)

Zyra e këmbimit mori një kërkesë nga një individ për të shkëmbyer 100,00 EUR në LEK. Zyra e këmbimit duhet të lëshojë një faturë për shërbimin e shkëmbimit, ta fiskalizojë atë, ta printojë dhe t'ia japë klientit. Komisioni i mbajtur nga zyra e këmbimit të valutës është 1%.

Faturë-Th

Moneta
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Data dhe koha: 05/08/2020, 20:01:24
Shuma në LEK: - 12.201,75 LEK

Shërbimeve	Monedha	Shuma	Kursi i këmbimit	Shuma totale në LEK
Blerje e valutës së huaj	EUR	100	123,25	12.325,00

Komisioni: 1% (123,25 LEK)

Shuma totale paguar klientit: 12.201,75 LEK

NSLF: 877246-3432-523235-23525
NIVF: 121-4545-55435-23435235-252

Përjashtuar nga TVSH-ja bazuar në nenin 53, shkronja "d", të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shembulli 2.

Shitja e valutës së huaj (në para në dorë)

Zyra e këmbimit mori një kërkesë nga një individ që dëshiron të blejë 100 EUR. Zyra e këmbimit duhet të lëshojë një faturë për shërbimin e shkëmbimit, ta fiskalizojë atë, ta printojë dhe t'ia japë klientit.

Faturë-Th

Moneta
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Data dhe koha: 05/08/2020, 20:01:24
Amount of LEK: 12.325,00 LEK

Shërbimeve	Monedha	Shuma	Kursi i këmbimit	Shuma totalenë LEK
Shitje e valutës së huaj	EUR	100	123,25	12.325,00

Shuma totale paguar klientit: 100,00 EUR

NSLF: 877246-3432-523235-23525
NIVF: 121-4545-55435-23435235-252

Përjashtuar nga TVSH-ja bazuar në nenin 53, shkronja "d", të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

7. Grupi i të dhënave për procesin e fiskalizimit të faturës, i cili dërgohet gjatë secilit proces të fiskalizimit të faturës për shërbimin e këmbimit valutor në sistemin e informacionit të administratës tatimore, specifikohet në specifikimet funksionale të shërbimit të fiskalizimit, të publikuar në faqen e internetit të administratës tatimore qendrore.

Neni 25

Fiskalizimi i faturave të huaja për mallrat e importuara

1. Sipas nenit 20 të Ligjit, tatimpaguesit që i nënshtrohen TVSH-së, ose tatimit mbi fitimin, ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, duhet të fiskalizojnë çdo faturë të marrë nga një person i huaj që nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedura e fiskalizimit do të kryhet në platformën qendrore të faturave.

3. Në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit (importuesit) në platformën qendrore të faturave, janë të dukshme të dhënat nga fatura e personit të huaj bazuar në deklaratën doganore. Tatimpaguesi (importuesi) për secilën faturë, bazuar në numrin rendor të deklaratës, për secilën zyrë doganore, e cila është caktuar në momentin kur deklarata është pranuar, shton të dhënat e mëposhtme direkt në platformë:

a) emri i shitësit;

b) numri i identifikimit tatimor të shitësit;

c) adresa e shitësit (rruga, qyteti, vendi);

ç) kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit (importuesit), vend i cili ka të bëjë me mallrat e furnizuara;

d) lloji i faturës (paguar me para në dorë ose pa para në dorë);

dh) numri i faturës (nga fatura e jorezidentit);

e) kodi i artikullit sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave;

ë) data e lëshimit të faturës;

f) mënyra e pagesës; dhe

g) përshkrimi i njësisë, njësisë matëse, sasisë për njësi dhe çmimit për njësi, në situatën kur vetëm të

dhënat për grupin e produkteve përcaktohen në të dhënat e deklaratës.

4. Tatimpaguesi (importuesi) duhet të kryejë procedurën e fiskalizimit, sipas këtij neni, pas vendosjes së mallrave nën procedurën e qarkullimit të lirë nga Autoriteti Doganor, por jo më vonë se 3 ditë pas vendosjes së mallrave nën këtë procedurë.

5. Pas fiskalizimit, nëse verifikimi ka qenë i suksesshëm, sistemi i informacionit i administratës tatimore gjeneron NIVF, i cili do të ruhet në librin e blerjeve të tatimpaguesit (importuesit) në platformën qendrore të faturave, së bashku me të dhënat e tjera të faturës së personit të huaj.

6. Në rast të rishikimit të deklaratës doganore, si rezultat i rivlerësimit doganor ose kontrollit të pas-zhdoganimit, brenda afatit të përcaktuar në kodin doganor, blerësi që ka përfunduar procesin e fiskalizimit do të korrigjojë menjëherë të dhënat e faturës në platformën qendrore të faturave bazuar në deklaratën doganore të rishikuar.

Shembull për procedurën e fiskalizimit të faturës së importit të mallrave:

Një tatimpagues shqiptar kryen një blerje jashtë vendit (Itali). Fatura e furnizuesit të huaj duhet të fiskalizohet nga importuesi duke kryer procedurën e fiskalizimit si më poshtë:

-Mallrat vijnë në kufi, autoriteti doganor lëshon deklaratën doganore, të ngarkuar me TVSH në import dhe dërgon të dhënat nga deklarata doganore në sistemin e informacionit të administratës tatimore në format XML;

-Disa nga të dhënat e deklaratës doganore (të specifikuara në tabelën e këtij shembulli) do të transferohen nga C@TS në platformën qendrore të faturave;

-Tatimpaguesi (importuesi) do të duhet të hyjë në platformën qendrore të faturave duke përdorur certifikatën e tij elektronike të lëshuar nga AKSHI dhe në llogarinë e tij të përdoruesit do të ketë një fushë të veçantë lidhur me fiskalizimin e faturave për mallrat e importuara;

-Tatimpaguesi do të klikojë këtë fushë dhe në këtë mënyrë do të hapet një listë e të gjithë mallrave të importuara, pra deklarata doganore e marrë dhe do të duhet të kontrollojë një nga një për të shtuar informacionin e munguar dhe ta fiskalizojë atë. Kërkimi do të bazohet në kombinimin e numrit rendor të deklaratës për çdo zyrë doganore me datën e regjistrimit të deklaratës;

-Pas zgjedhjes së një deklarate doganore, aplikacioni do të shfaqë të dhënat e specifikuara në tabelën më poshtë dhe tatimpaguesi do të duhet të shtojë këtë informacion:

-Emri i shitësit;

-Numri identifikues fiskal i shitësit, të lëshuar në vendin e tij të rezidencës;

-Adresa e shitësit (rruga, qyteti, shteti);

-Kodi i vendit të tij të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, me të cilin lidhet fatura e huaj, pra në të cilin mallrat janë furnizuar;

-Lloji i faturës (paguar me para në dorë ose pa para në dorë);

-Numri i faturës (numrin e faturës së vendosur në faturën e huaj);

-Data në të cilën fatura është lëshuar nga shitësi i huaj;

-Mënyra e pagesës (pra si do ta paguajë këtë faturë); dhe

-Informacioni për çdo artikull të blerë dhe të vendosur në faturën e huaj, përshkrimi për njësinë, njësinë matëse, sasinë për artikull dhe çmimin për njësi, në situatën kur vetëm të dhënat për grupet e produkteve janë specifikuar në të dhënat e deklaratës.

-Pas shtimit të të dhënave, ai duhet t'i ruajë ato dhe të klikojë "fiskalizo".

-Në këtë moment, sistemi i informacionit të adminisratës tatimore do të krijojë automatikisht kodet NSLF dhe NIVF, si dhe do t'i regjistrojë në bazën e të dhënave dhe në librin e tij të blerjeve bazuar në "datën e pranimit të deklaratës".

Shuma e TVSH-së do të merret nga deklarata doganore kështu që tatimpaguesi nuk do të ketë mundësinë që ta ndryshojë atë.

Informacioni nga deklarata doganore i marrë nga sistemi i informacionit të Administratës Tatimore në format XML, që do të përdoret në Platformën Qendrore të Faturave			Fusha e fiskalizimit
Emri	**Përshkrimi**	**Vlerat**	**Emri**
NumerRegjistrimi	Numri rendor i deklaratës për çdo zyrë doganore	R 0001 ……	-
DateRregjistrimi	Data e regjistrimit të deklaratës		-
NumerPranimi	Numri rendor i deklaratës për çdo zyrë doganore. Ky numër vendoset në moment kur deklarata është pranuar.	P 0001 ….	-
DatePranimi	Data e pranimit të deklaratës.		Data e lëshimit të faturës
Nipt-i	NIPT-i i tatimpaguesit		NIPT-i i blerësit
EmriKompanise	Emri i tatimpaguesit		Emri i blerësit
NumriArtikullit	Numri i artikujve të ndryshëm në deklaratë		Shuma totale e çdo njësie të faturës për çdo rang TVSH-je (pika A)
Cmimi	Shuma e faturës		Shuma totale pa TVSH
PershkrimiMallit	Përshkrimi i mallrave		Përshkrimi i njësive
VlFaturePlus-Transport	Shuma e fanturës, përfshirë transportin		
VleraRregullimit	Rregullime në shumën e faturës me çmimin e references		
VleraStatistikore	Baza e taksës		Shuma totale e çdo njësie të faturës për çdo

Monedha	Kodi i këmbimit, si e lëshuar nga Banka e Shqipërisë		Monedha
Kursi	Këmbimi mujor i valutës si i lëshuar nga Banka e Shqipërisë		Kursi i këmbimit
Emer Njesia Sup1	Emri i njësisë matëse	Lista e emrave të kodeve të njësive shtesë	Njësia matëse
Sasia njësia Sup1	Sasia. Seksioni 41 i deklarimit.		Sasinë
Shuma e tatimit1	Shuma totale. Seksioni 47 i deklarimit.		TVSH
Kodi i mallit	Kodi i nomenklaturës		Kodin e artikullit

Neni 26

Fiskalizimi i faturës elektronike për shërbimin e ofruar nga jorezidentët ndaj tatimpaguesit rezident

1. Sipas nenit 20 të Ligjit, tatimpaguesit që i nënshtrohen TVSH-së, ose tatimit mbi fitimin, ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, duhet të fiskalizojnë çdo faturë të marrë nga një person i huaj që nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë në formën e faturës elektronike, përmes platformës qendrore të faturave, për furnizimin e shërbimeve.

2. Procedura e fiskalizimit do të kryhet në platformën qendrore të faturave.

3. Në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit (blerësit) në platformën qendrore të faturave, do të jenë të dukshme të dhënat nga fatura elektronike e personit të huaj, e cila shkëmbehet përmes platformës qendrore të faturave dhe për këtë arsye është në përputhje me specifikimet teknike të dhëna në Standardet Shqiptare (SSH) të publikuara nga autoriteti për standardizim. Tatimpaguesi (blerësi), pasi të pranojë faturën, do të shtojë përshkrimin e shërbimeve në gjuhën shqipe, nëse fatura është lëshuar në gjuhë të huaj, direkt në platformë, si dhe kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit, ndaj të cilit lidhet fatura e jorezidentit (shërbimet e ofruara). Tatimpaguesi (blerësi) llogarit TVSH-në dhe deklaron faturën e lëshuar prej tij si autongarkesë sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.

4. Tatimpaguesi, pra blerësi vendas i shërbimit, i cili ka marrë një faturë elektronike nga jashtë, do të zhvillojë procedurën e fiskalizimit jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin është dhënë shërbimi.

5. Pas fiskalizimit, nëse verifikimi ka qenë i suksesshëm, sistemi i informacionit i administratës tatimore qendrore gjeneron NIVF, i cili do të ruhet në librin e blerjeve të tatimpaguesit (blerësit) në platformën qendrore të faturave, së bashku me të dhënat e tjera të faturës elektronike të jorezidentit.

Neni 27

Shitjet nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatët)

1. Pajisje e vetëshërbimit (automat) që realizon qarkullim nga shitja e mallrave ose shërbimeve të përmendura në nenin 21 të Ligjit, konsiderohet çdo pajisje e automatizuar, ku gjatë furnizimit të mallrave ose shërbimeve dhe mbledhjes së pagesave nuk merr pjesë një individ në cilësinë e shitësit. Pajisjet e vetëshërbimit për qëllim të fiskalizimit nuk konsiderohen të jenë bankomatet e bankave apo e-banking (shërbimet bankare elektronike).

2. Pajisja e vetëshërbimit (automat) kryen procesin e fiskalizimit duke raportuar të dhënat e shitjeve në kohën e shitjes së mallrave ose shërbimeve në sistemin e informacionit të administratës tatimore përmes lidhjes në internet.

3. Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, procesi i fiskalizimit të të dhënave të shitjeve të cilat janë kryer me xhitona dhe mjete të ngjashme, nuk do të kryhet nga pajisja e vetëshërbimit në të cilën ato përdoren, pasi procesi i fiskalizimit të faturës duhet të kryhet në momentin e shitjes së xhitonave dhe mjeteve të ngjashme.

4. Çdo pajisje vetëshërbimi konsiderohet si një pajisje elektronike faturimi për shitje me para në dorë, për të cilën do të zbatohen përkatësisht dispozitat e nenit 14 të Ligjit dhe nenit 17 të këtij udhëzimi për garantimin e të dhënave për pajisjet elektronike të faturimit.

5. Kur dorëzohen të dhënat në lidhje pajisjen e vetëshërbimit (automat) sipas pikës 4 të këtij neni, tatimpaguesi duhet të tregojë adresën ku ndodhet pajisja e vetëshërbimit ose adresën e saj më të afërt (vendndodhja gjeografike) dhe gjithashtu përshkruan vendndodhjen e saktë në një hapësirë të caktuar.

6. Në secilën pajisje vetëshërbimi (automat), tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të vendosë një afishe me kodin QR të printuar që përmban të dhënat e mëposhtme:

a) NIPT-in e tatimpaguesit;

b) kodin e pajisjes elektronike të faturimit, të krijuar nga sistemi i informacionit të administratës tatimore pas lidhjes së parë të pajisjes së vetëshërbimit me sistemin e informacionit të administratës tatimore për qëllime fiskalizimi, sipas nenit 17 të këtij udhëzimi.

7. Dispozitat e nenit 23 të këtij udhëzimi do të zbatohen në përputhje me rrethanat për protokollet dhe mekanizmat e sigurisë, modelet e aplikimit për dërgimin dhe nënshkrimin e mesazheve elektronike, mesazheve standarde të gabimit dhe

protokolleve për trajtimin e parregullsive me qëllim të kryerjes së procesit të fiskalizimit të të dhënave.

8. Meqenëse nuk ka asnjë detyrim që të printohet fatura për çdo shitje përmes pajisjes së vetëshërbimit, mesazhi që kërkon fiskalizimin e të dhënave të shitjeve rregullohet si më poshtë:

a) numri i faturës përcaktohet në mënyrë rendore në nivelin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

b) çdo shitje e mallrave ose shërbimeve të bëra regjistrohet dhe llogaritet si një numër fature (numri i transaksionit); dhe

c) NIPT-i i tatimpaguesit konsiderohet si kodi i operatorit.

9. Nëse pajisja e vetëshërbimit është e vendosur në një zonë ku nuk është e mundur të vendosni një lidhje të përhershme në internet ose ka një ndërprerje të përkohshme në shërbimin e komunikimit me sistemin e informacionit të administratës tatimore, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të sigurojë ruajtjen e të dhënave në shitje dhe të kryejë procedurën mujore të fiskalizimit, sipas nenit 31 të Ligjit ose duhet të kryejë procedurën e fiskalizimit pas eliminimit të problemit ose lidhjes së rivendosur, brenda 48 orëve.

10. Tatimpaguesit që operojnë në sektorë të veçantë të ekonomisë, siç janë sektori i hidrokarbureve dhe kryejnë shitje përmes makinave të vetëshërbimit (automat), duhet të mundësojnë printimin e faturave kur kryejnë shitje përmes këtyre pajisjeve.

11. Përpara fillimit të shitjeve nga pajisjet e vetëshërbimit (automat), tatimpaguesi duhet të paraqesë informacionin për depozitën e parave në arkë në fillim të ditës së parë të punës. Si një masë e thjeshtuar, tatimpaguesi nuk është i detyruar që ta bëjë këtë veprim në vijim të çdo dite tjetër, por duhet të regjistrojë vetëm veprimet kur tërheq para nga arka (pajisja e vetëshërbimit) apo kur shton para në arkë, të cilat nuk janë si rezultat i shitjeve të kryera.

Neni 28

Procedura e thjeshtëzuar për fiskalizimin e faturave

1. Procedura e thjeshtuar e fiskalizimit, sipas neneve 22 dhe 27 të Ligjit, është në dispozicion për tatimpaguesit që lëshojnë fatura, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, për:

a) faturat për transaksionet me para në dorë;

b) faturat për transaksionet pa para në dorë.

2. Në procedurën e thjeshtuar të fiskalizimit, tatimpaguesit mund të përdorin platformën qendrore të faturave për të krijuar, lëshuar dhe fiskalizuar faturat, si dhe në rastet e faturave elektronike për dërgimin e faturës elektronike blerësit dhe anasjelltas për marrjen e faturës elektronike nga shitësi. Tatimpaguesi do të duhet të marrë nga AKSHI një certifikatë digjitale dhe do të përdoret si një emër përdoruesi dhe fjalëkalim për hyrje në Platformën Qendrore të Faturave. Kështu që, tatimpaguesi do të duhet të ketë vetëm një pajisje elektronike (laptop, telefon inteligjent etj.), një lidhje interneti dhe një printer (nëse dëshiron të shtypë faturën) për lëshimin dhe fiskalizimin e faturës.

3. Gjatë procedurës së lëshimit dhe fiskalizimit të faturave, sipas pikës 2 të këtij neni, tatimpaguesi që është i detyruar të lëshojë fatura, kryen veprimet si më poshtë:

a) ai mund të hyjë në platformën qendrore të faturave duke përdorur certifikatën elektronike të lëshuar nga AKSHI;

b) hedh të dhënat e faturës direkt në platformën qendrore të faturave në modelin përkatës të faturës;

c) pas verifikimit të saktësisë së të dhënave të paraqitura ose të shkruara, sistemi i informacionit i administratës tatimore gjeneron NIVF-në e NSLF-në, që ia paraqet tatimpaguesit menjëherë pas verifikimit;

ç) pasi të marrë NIVF, tatimpaguesi që lëshon fatura:

i. për transaksione me para në dorë printon faturën dhe ia jep konsumatorit ose e dërgon në formë elektronike;

ii. për transaksione pa para në dorë, kur klienti është një individ ose një person që nuk është tatimpagues që lëshon fatura në bazë të Ligjit, printon faturën dhe ia jep konsumatorit ose e dërgon atë në formë elektronike me pëlqimin e tij;

iii. për transaksione pa para në dorë, kur klienti është një tatimpagues tjetër që lëshon fatura në bazë të Ligjit, ai lëshon faturën në formën e faturës elektronike dhe ia dërgon konsumatorit, përmes platformës qendrore të faturave.

4. Procedura e thjeshtuar e fiskalizimit nënkupton që tatimpaguesi që është i detyruar të lëshojë fatura sipas Ligjit:

a) nuk është i detyruar të instalojë dhe regjistrojë pajisjet e posaçme elektronike për transaksione me para në dorë;

b) nuk është i detyruar të instalojë ose përdorë ndonjë zgjidhje të veçantë software-ike për procedurën e fiskalizimit;

c) nuk është i detyruar të paraqesë informacion për mbajtësin e software-it.

5. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura në bazë të pikës 1 të këtij neni, gjithashtu mund të paraqesin në platformën qendrore të faturave informacionin për depozitën e parave në arkë në fillim të ditës së parë të punës. Si një masë e thjeshtuar, tatimpaguesi nuk është i detyruar që ta bëjë këtë veprim në vijim të çdo dite tjetër, por duhet të regjistrojë vetëm veprimet kur tërheq para nga arka apo kur shton para në arkë, të cilat nuk janë si rezultat i shitjeve të kryera.

Neni 29

Fatura për pagesat me para në dorë

1. Fatura duhet të printohet në letër (çfarëdo formati letre) në transaksionet me konsumatorët individë dhe në transaksionet me para në dorë me tatimpagues të tjerë. Sidoqoftë, nëse ofrohen shërbime elektronike ose furnizimi i mallrave/shërbimeve kontraktohet dhe ngarkohet përmes një aplikacioni celular, dyqani në internet ose të ngjashme, fatura nuk ka pse të printohet në letër, por mund t'i dërgohet blerësit ose marrësit të faturës, me postë elektronike ose si faturë elektronike.

Për shembull, në rast të shitjes në distancë nëse klienti (një individ) paguan me kartën e tij të kreditit, atëherë kjo konsiderohet se është pagesa e parave në dorë, sipas nenit 3 të Ligjit, por fatura nuk duhet të printohet në letër, në vend të kësaj, shitësi mund t'ia dërgojë blerësit me postë elektronike në formë PDF.

2. Në rast pagese pa para në dorë, për transaksionet me konsumatorët individë, fatura mund të printohet në letër ose të dërgohet me postë elektronike ose si faturë elektronike. Blerësi duhet të japë pëlqimin e tij për marrjen e faturës me postë elektronike ose në formë elektronike.

Neni 30

Fatura elektronike për pagesa pa para në dorë në transaksionet me organet publike

1. Detyrimi për të lëshuar dhe marrë një faturë elektronike lind në dy raste, sipas neneve 24 dhe 25 të Ligjit:

a) për furnizimin e mallrave ose shërbimeve në transaksionet ku shitësi dhe blerësi janë tatimpagues (subjekte të TVSH-së, ose tatimit mbi fitimin, ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për bizneset e vogla, sipas legjislacionit tatimor në fuqi), por vetëm nëse fatura paguhet ose do të paguhet pa para në dorë;

b) në transaksionet me çdo organ publik, ku organi publik është marrësi, pra blerësi i mallrave ose shërbimeve.

2. Një faturë elektronike duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimit në nenin 10 të Ligjit. Përveç këtyre, një faturë elektronike, duhet të lëshohet dhe gjithashtu të merret në një format elektronik. Formati duhet të jetë në përputhje me Standardet Shqiptare (SSH) siç janë publikuar nga institucioni përgjegjës për standardizimin. Kjo nënkupton se, jo të gjitha faturat e krijuara në një format elektronik mund të konsiderohen se janë "fatura elektronike" që plotësojnë kërkesat e neneve 24 dhe 25 të Ligjit. Faturat e krijuara në format elektronik, për shembull, nëpërmjet një software kontabiliteti ose nëpërmjet një software shkrimi, që dërgohen dhe merren në letër, nuk janë fatura elektronike.

Neni 31

Platforma qendrore e faturave

1. Platforma qendrore e faturave është krijuar, zhvilluar, mirëmbajtur dhe administruar teknikisht nga AKSHI, ndërsa të dhënat e shkëmbyera nëpërmjet kësaj platforme administrohen nga administrata tatimore.

2. Tatimpaguesi që lëshon faturë mund të aksesojë platformën qendrore të faturave duke përdorur certifikatën digjitale të lëshuar nga AKSHI, të cilën do ta përdorin gjithashtu për të lëshuar fatura dhe për të kryer procedurën e fiskalizimit.

3. Platforma qendrore e faturave ka dy qëllime kryesore:

a) implementimin e procesit të fiskalizimit;

b) shkëmbimin e faturave elektronike.

4. Për implementimin e procesit të fiskalizimit, tatimpaguesi që lëshon fatura në platformën qendrore të faturave mund të kryejë:

a) dërgimin e informacionit të kërkuar në përputhje me Ligjin (mbi vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, mbi operatorët, mbi mirëmbajtësit e zgjidhjes software-ike, etj.);

b) rishikimin e të gjitha faturave të fiskalizuara në të cilat ai paraqitet si blerës ose si shitës në librin e blerjeve ose në librin e shitjeve;

c) dërgimin e informacionit mbi të gjitha pagesat e marra të faturave elektronike;

ç) në qoftë se përmbushin kriteret e vendosura në Vendimin e Këshillit të Ministrave, në platformën qendrore të faturave gjithashtu mund të krijojnë faturë, kryejnë procedurën e fiskalizimit, lëshojnë një faturë ose një faturë elektronike dhe të dërgojnë e të marrin një faturë elektronike;

d) të shohin dhe të shtojnë të dhëna shtesë në librat e shitjeve dhe të blerjeve.

Neni 32

Ndërprerja e lidhjes elektronike (internetit)

1. Tatimpaguesi që lëshon fatura, i cili nuk arrin të rivendosë funksionimin e shërbimit fiskal, pra lidhjen me sistemin e informacionit të administratës tatimore me qëllim të kryerjes së procedurës së fiskalizimit, në përputhje me nenin 29 të Ligjit, brenda 48 orëve, duhet të informojë administratën tatimore përmes formularit "Raportimi i pamundësisë së vendosjes së një lidhjeje me shërbimin fiskal", i cili është në Shtojcën 4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Formulari në përputhje me pikën 1 të këtij neni, do të dorëzohet elektronikisht përmes platformës qendrore të faturave ose personalisht në zyrën vendore kompetente të administratës tatimore ku është i regjistruar, nëse tatimpaguesi nuk mund të hyjë në platformën qendrore të faturave.

3. Së bashku me formularin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të paraqesë bashkëngjitur edhe dokumentacionin që mund të vërtetojë arsyen e pamundësisë për të rivendosur lidhjen me internetin (për shembull konfirmimi i ofruesit të internetit etj.), në të njëjtën mënyrë siç vepron me formularin sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Nëse është e pamundur që lidhja të bëhet brenda 48 orëve, pasi të ketë informuar administratën tatimore sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi mund të vazhdojë të lëshojë fatura pa NIVF dhe pa procedurë fiskalizimi, deri sa të rivendoset lidhja përsëri. Pas rifillimit të funksionimit, ai fiskalizon të gjitha faturat e lëshuara në modalitetin off-line (jashtë linje). Nëse ndërprerja në lidhjen në internet është hasur gjatë muajit dhe rilidhja nuk është bërë deri në ditën e 10-të të muajit vijues, atëherë tatimpaguesi duhet të paraqesë të gjitha faturat e pafiskalizuara në administratën tatimore qendrore, sipas nenit 31 të Ligjit dhe nenit 34 të këtij udhëzimi.

Neni 33

Ndërprerja e punës së pajisjes fiskale për zbatimin e fiskalizimit

1. Në rast të mosfunksionimit të plotë të pajisjeve fiskale të përdorura për lëshimin e faturave, tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë fatura në përputhje me nenin 4 të Ligjit, kanë detyrimin të lëshojnë fatura nga blloku i veçantë i faturave, në përputhje me nenin 30 të Ligjit.

2. Blloku i veçantë i faturave shtypet nga autoritetet tatimore apo nga shoqëri private të autorizuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe shpërndahet nga autoritetet tatimore. Këto dokumente duhet detyrimisht të jenë në formën e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Kriteret që duhet të plotësojnë personat, që autorizohen për shtypjen e këtyre dokumenteve, kushtet e shtypjes dhe standardet e sigurisë janë sipas përcaktimit në Vendimin e Këshillit të Ministrave "*Për shtypjen e dokumentacionit tatimor*".

3. Tatimpaguesi që lëshon fatura, pajiset me bllokun e veçantë të faturave në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar.

4. Blloku i veçantë i faturave duhet të ketë numër serial të printuar për çdo faturë që përmban.

5. Faturat e lëshuara nga blloku i veçantë i faturave lëshohen në dy kopje, nga të cilat origjinali i firmosur nga lëshuesi, do t'i jepet klientit, ndërsa një kopje mbahet nga furnizuesi i produktit ose shërbimit.

6. Të gjitha faturat e lëshuara nga blloku i veçantë i faturave duhet të fiskalizohen brenda 5 ditëve. Kjo do të thotë që tatimpaguesi që lëshon

fatura duhet të hedhë të gjitha të dhënat e faturës nga blloku i veçantë i faturave në pajisjen elektronike të faturimit (për pagesa me para në dorë) që ai përdor për lëshimin e faturave dhe të kryejë procedurën e fiskalizimit, sipas nenit 14 të Ligjit.

7. Gjatë ndalimit të funksionit të pajisjeve fiskale, tatimpaguesi lëshon fatura nga blloku i veçantë i faturave pa NIVF dhe NSLF dhe në faturë shënohen fjalët "Ndërprerje e punës së pajisjeve fiskale".

8. Faturat nga blloku i veçantë i faturave do të vazhdojnë numrin rendor që fillon pas numrit të faturës së fundit të lëshuar nga pajisja elektronike. Kur tatimpaguesi rifillon të lëshojë fatura nga pajisja elektronike, ai duhet të vazhdojë numërimin rendor që fillon pas numrit të faturës së fundit të lëshuar nga blloku i veçantë i faturave gjatë periudhës së mosfunksionimit të pajisjes.

9. Depozita fillestare e parave në dorë në fillim të çdo dite pune, si dhe ndryshimet në depozitën e parave në dorë shënohen në bllokun e veçantë të faturës.

Neni 34

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit në zonat ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje për shkëmbimin e të dhënave

1. Tatimpaguesi duhet të njoftojë administratën tatimore për pamundësinë e krijimit të një lidhje elektronike (internet) për shkëmbimin e të dhënave me sistemin e informacionit të administratës tatimore në vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të vendosura në zonë pa lidhje të përhershme në internet.

2. Para njoftimit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të kontrollojë disponueshmërinë e shërbimit të hyrjes në internet për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit në të cilin ai ose ajo kryen veprimtarinë ose një pjesë të veprimtarisë, nga:

a) operatorët që ofrojnë shërbimin e hyrjes në internet përmes një rrjeti fiks të komunikimeve elektronike (qasje fikse);

b) operatorët që ofrojnë shërbimin e hyrjes në internet përmes një rrjeti komunikimi elektronik kabllor (qasja kabllore);

c) operatorët që ofrojnë shërbimin e hyrjes në internet përmes një rrjeti të komunikimit elektronik të lëvizshëm (qasja në celular).

3. Njoftimi referuar pikës 1 të këtij neni do të bëhet përmes platformës qendrore të faturave ose nëse tatimpaguesi që lëshon fatura nuk mund të hyjë në atë platformë, përmes formularit "Informacione për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit", sipas nenit 17 të këtij udhëzimi, që do të dorëzohet në zyrën vendore përgjegjëse të administratës tatimore, sipas vendit për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit ose vendbanimit të tij, të paktën 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

4. Përveç njoftimit të përmendur në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

a) një përgjigje negative ndaj kërkesës së tij për sigurimin e një shërbimi të linjës fikse në internet nga të paktën dy ofrues të internetit, njëri prej të cilëve do të jetë ai më i madhi, ofruesi i shërbimit universal;

b) një përgjigje negative ndaj kërkesës së tatimpaguesit për sigurimin e një shërbimi kabllor të hyrjes në internet nga të paktën një operator që operon në zonën ku ndodhet vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

c) një raport që përmban ditën dhe kohën e saktë të moslidhjes në internet përmes pajisjes për të hyrë në të dhënat celulare të secilit prej operatorëve që ofrojnë shërbimin e qasjes në internet, të cilin kërkuesi e kishte marrë falas për dy ditë.

5. Nëse nga dokumentacioni i dhënë dhe bazuar në informacionin mbi disponueshmërinë e shërbimeve të hyrjes në internet në dispozicion të AKEP-it, administrata tatimore qendrore mund të arrijë në përfundimin se tatimpaguesi që lëshon fatura nuk mund të krijojë një lidhje funksionale për shkëmbimin e informacionit me administratën tatimore, ajo lëshon një konfirmim në formë elektronike, i cili do të ruhet në platformën qendrore të faturave në llogarinë personale të tatimpaguesit dhe me kërkesën e tij/saj të dërguar në postën elektronike të tij/saj, të deklaruar në formularin e aplikimit, sipas pikës 3 të këtij neni (në këtë fushë të shënuar), me një periudhë vlefshmërie prej një viti. Pas një viti, tatimpaguesi duhet të përsërisë procedurën e njoftimit siç përshkruhet në këtë nen.

6. Nëse tatimpaguesi që lëshon fatura nuk ka paraqitur provat e përmendura në pikën 4 të këtij neni, atij nuk i jepet asnjë konfirmim.

7. Në zbatim të nenit 31 të Ligjit, tatimpaguesit që kryejnë biznes në një zonë ku nuk është e mundur të vendosin një lidhje të përhershme në internet për të shkëmbyer të dhëna me sistemin e informacionit të administratës tatimore, lëshojnë fatura dhe përdorin shërbimin fiskal në modalitetin jashtë linje (off-line). E drejta për të vepruar në mënyrë jashtë linje mund të ushtrohet vetëm nga tatimpaguesit që kanë një konfirmim sipas pikës 5 të këtij neni.

8. Tatimpaguesi që lëshon fatura sipas pikës 7 të këtij neni, duhet të paraqesë të dhënat për pajisjen elektronike të faturimit, për vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, për operatorët dhe për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike, duke përdorur platformën qendrore të faturave ose nëse ato nuk mund të hyjnë në platformë, përmes formave të përcaktuara që janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, që do t'i dorëzohet zyrës vendore përgjegjëse të administratës tatimore, sipas vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ose vendbanimit të tij, të paktën 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

9. Gjatë periudhës së punës në modalitetin jashtë linje, tatimpaguesi lëshon fatura që përmbajnë të gjitha të dhënat, sipas nenit 9 ose 11 të Ligjit, përfshirë kodin QR dhe NSLF, përveç NIVF. Fatura gjithashtu përmban fjalët "Punon në modalitetin jashtë linje".

10. Regjistrimi i depozitës së parave të përmendura në nenin 40 të këtij Udhëzimi, do të regjistrohet në sistemin elektronik të tatimpaguesit dhe nënshkruhet me nënshkrim elektronik për ditë pune.

11. Deri në fund të muajit dhe jo më vonë se data 10 e muajit vijues, tatimpaguesi që lëshon fatura në përputhje me pikën 7 të këtij neni, do t'i paraqesë administratës tatimore të gjitha faturat e lëshuara në muajin e kaluar, në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) marrjen e pajisjes elektronike të përdorur për lëshimin e faturave dhe mbi të cilën faturat ruhen në një zonë me lidhje interneti, ku ai gjithashtu mund të lidhë atë pajisje me internet dhe të vazhdojë procedurën e fiskalizimit;

b) shkarkimin e të gjitha të dhënave në median e lëvizshme të rishkrueshme (për shembull USB, ose CD të rishkrueshme, ose pajisje të kujtesës së jashtme) dhe:

i. duke e ngarkuar vetë në platformën qendrore të faturave; ose

ii. duke e paraqitur atë në zyrën më të afërt të administratës tatimore.

12. Pas paraqitjes së të dhënave sipas pikës 11 të këtij neni, sistemi i informacionit të administratës tatimore kryen verifikimin e të gjitha të dhënave të faturave të marra dhe gjeneron NIVF për çdo faturë, si konfirmim për marrjen e faturave të paraqitura më pas.

13. Një listë e numrave të faturës dhe NIVF-ve të tyre të caktuara do t'i sigurohen tatimpaguesit që lëshon fatura në formë elektronike, në të njëjtën mënyrë me të cilën ai ka dorëzuar faturat në administratën tatimore (direkt në pajisje, ose përmes platformës qendrore të faturave, ose ruajtjen e tij në median e lëvizshme).

14. Pas marrjes së NIVF-së për secilën faturë, tatimpaguesi që lëshon faturat është i detyruar të ngarkojë NIVF-në në pajisjen elektronike ose sistemin elektronik të përdorur për lëshimin dhe ruajtjen e faturave, brenda pesë ditëve dhe ta bashkëngjisë atë në çdo faturë të lëshuar më parë.

15. Nëse gjatë verifikimit të faturave të paraqitura gjenden disa parregullsi të përmendura në nenin 23 të këtij Udhëzimi, për të cilat nuk është e mundur të caktohet NIVF, tatimpaguesi do të marrë një përshkrim gabimi dhe do të korrigjojë parregullsitë dhe më pas të përsërisë procedurën.

Neni 35

Fiskalizimi i faturave korrigjuese/saktësuese

1. Nëse tatimpaguesit shitës do t'i duhet të anulojë faturën e lëshuar, sepse blerësi nuk e ka pranuar atë (për shembull nëse ka disa gabime në faturë, ose nëse blerësi ka kthyer disa artikuj tek shitësi, ose nëse ai nuk kryen transaksionin etj.), tatimpaguesi që ka lëshuar faturën nuk mund ta fshijë atë nga libri i shitjeve ose të bëjë një anulim në sistemin e tij elektronik, por duhet të lëshojë një faturë korrigjuese, notë debiti ose notë krediti, sipas akteve ligjore dhe nënligjore për TVSH-në dhe ta fiskalizojë atë.

2. Fatura korrigjuese duhet të përmbajë të dhëna referencë për faturën që po korrigjohet, pra NSLF

e faturës që po korrigjohet dhe të gjithë elementët e tjerë të faturës sipas Ligjit. Fatura korrigjuese duhet të fiskalizohet pas verifikimit nga sistemi i informacionit i administratës tatimore qendrore. Nëse verifikimi ka qenë i suksesshëm, do të marrë një NIVF (numri identifikues i veçantë i faturës).

Shembulli 1.

Kompania A i shet Kompanisë B 500 copë shishe qumësht (paketim 1 litër) me një çmim 300,00 lekë për shishe pa TVSH, në datën 05.08.2020 (kjo është fatura origjinale), pra në total 180 000,00 lekë (150 000,00 lekë + 30 000,00 lekë TVSH).

Kompania A lëshon faturën e mëposhtme:

Faturë tatimore

Kompania A
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Datën dhe kohën: 05/08/2020, 20:01:24
Nr. i Faturës: 156-2020-ab5352mjul
Operator: lke1346787
Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit: abc123456i
Mënyrën e pagesës: kartë monedha

Blerësit: Kompania B, P2222222T, Tirana, Rruga Urani Pano 1, Shqipëri

Mallrave/shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	TVSH
qumësht1 l	copë	500	300,00	150.000,00	1

Tatim	Kodin	Shkalla	Vlera	Vlera e TVSH
TVSH	1	20%	150.000,00	30.000,00
TVSH	2	10%	0	0

vlerën: 150.000,00 lek
TVSH: 30.000,00 lek
vlerën totale me TVSH: 180.000,00 lek

NSLF: 877246-3432-523235-23525
NIVF: 121-4545-55435-23435235-252

Kompania B pagoi faturën në datën 07.08.2020, por në datën 10.09.2020 i kthen kompanisë A 100 copë shishe qumështi, sepse ka pasur probleme paketimi. Pra, kompania B kërkon një kthim prej 30 000,00 lekësh + 6 000,00 lekë të TVSH-së. Më 11.09.2020 kompania A lëshon një shënim korrigjues të faturës, e fiskalizon atë dhe ia dërgon blerësit.

Faturë tatimore (faturë korrigjuese – notë krediti)

Kompania A
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Datën dhe kohën: 11/09/2020, 15:01:24
Nr. i Faturës: 170-2020-ab5352mjul
Operator: lke1346787
Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit: abc123456i
Mënyrën e pagesës: kartëmonedha

Blerësit: Kompania B, P2222222T, Tirana, Rruga Urani Pano 1, Shqipëri

Mallrave/shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	TVSH
qumësht1 l	copë	-100	300	-30.000,00	1

Tatim	Kodin	Shkalla	Vlera	Vlera e TVSH
TVSH	1	20 %	-30.000,00	-6.000,00
TVSH	2	10 %	0	0

vlerën: -30.000,00 lek
TVSH: -6.000,00 lek
vlerën totale me TVSH: -36.000,00 lek

NSLF: 123566-3432-523235-23525
NIVF: 511-222-55435-23435235-252

Lidhur me saktësimin e faturës NSLF: 877246-3432-523235-23525

Kjo faturë korrigjuese duhet të regjistrohet në librin e blerjeve të blerësit dhe në librin e shitjeve të shitësit në muajin kur është lëshuar, në këtë rast në Shtator 2020.

Kjo faturë korrigjuese duhet të lëshohet si faturë e thjeshtë.

Shembulli 2.

Kompania B nga shembulli numër 1 nuk ka paguar faturën dhe ka anuluar porosinë, kështu që mallrat iu kthyen shitësit, kompanisë A, me datë 10.08.2020.

Kompania A në këtë rast lëshon një faturë korrigjuese, e fiskalizon atë dhe ia dërgon blerësit. Kjo faturë korrigjuese regjistrohet në librin e blerjeve të blerësit dhe në librin e shitjeve të shitësit në muajin kur është lëshuar, pra në Gusht 2020.

Faturë tatimore (faturë korrigjuese – notë krediti)

Kompania A
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Datën dhe kohën: 11/08/2020, 15:01:24
Nr. i Faturës: 160-2020- ab5352mjul
Operator: lke1346787
Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit: abc123456i
Mënyrën e pagesës: kartëmonedha

Blerësit: Kompania B, P2222222T, Tirana, Rruga Urani Pano 1, Shqipëri

Mallrave/shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	TVSH
qumësht1 l	copë	-500	300,00	-150.000,00	1

Tatim	Kodin	Shkalla	Vlera	Vlera e TVSH
TVSH	1	20%	-150.000,00	-30.000,00
TVSH	2	10%	0	0

vlerën: -150.000,00 lek
TVSH: -30.000,00 lek
vlerën totale me TVSH: -180.000,00 lek

NSLF: 123566-3432-523235-11111
NIVF: 511-222-12121-23435235-222

Lidhur me saktësimin e faturës NSLF: 877246-3432-523235-23525

Kjo faturë duhet të lëshohet me emërtesën faturë korrigjuese dhe të lidhet me faturën fillestare të furnizimit të mallit.

Shembulli 3.

Kompania A, nga shembulli i parë, pas dy muajsh, zbulon se në faturën e parë, sasia prej 100 shishesh qumësht duhej të ishte faturuar me çmimin 350 lekë për shishe për shkak të paketimeve të ndryshme (1,5 litra në vend të 1 litri). Më 11.10.2020 kompania A lëshon një faturë korrigjuese, e fiskalizon atë dhe ja dërgon blerësit. Kjo faturë korrigjuese regjistrohet në librin e blerjeve të blerësit dhe në librin e shitjeve të shitësit në muajin kur është lëshuar, pra në Tetor 2020.

Faturë tatimore (faturë korrigjuese-notë debiti)

Kompania A
Rruga Morat Toptani 1, Tirana, Shqipëri
J43675678H

Datën dhe kohën: 11/10/2020, 15:01:24
Nr. i faturës: 280-2020-ab5352mjul
Operator: lke1346787
Kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit: abc123456i
Mënyrën e pagesës: kartëmonedha

Blerësit: Kompania B, P2222222T, Tirana, Rruga Urani Pano 1, Shqipëri

Mallrave/shërbimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	TVSH
qumësht1 l	Copë	-100	300,00	-30.000,00	1
qumësht1,5 l	Copë	100	350,00	35.000,00	1

Tatim	Kodin	Shkalla	Vlera	Vlera e TVSH
TVSH	1	20%	5.000,00	1.000,00
TVSH	2	10%	0	0

vlerën: 5.000,00 lek
TVSH: 1.000,00 lek
vlerën totale me TVSH: 6.000,00 lek

NSLF: 333555-3432-123123-12121
NIVF: 333-111-12121-23435235-222

Lidhur me saktësimin e faturës NSLF: 877246-3432-523235-23525

Kjo faturë duhet të lëshohet me emërtesën faturë korrigjuese dhe të lidhet me faturën fillestare të furnizimit të mallit.

3. Në rastin kur fatura e parë nuk është fiskalizuar për shkak të ndërprerjes së lidhjes në internet ose ndonjë gabimi të hasur gjatë procedurës së fiskalizimit dhe fatura korrigjuese lëshohet më pas, tatimpaguesi fiskalizon fillimisht faturën fillestare dhe më pas faturën korrigjuese e cila korrigjon faturën fillestare.

4. Nëse fatura që po korrigjohet nuk gjendet në bazën e të dhënave, sistemi i informacionit të administratës tatimore qendrore gjeneron një mesazh gabimi që do të ruhet në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit në platformën qendrore të faturave dhe tatimpaguesi duhet të korrigjojë parregullsitë e hasura.

5. Në rastet kur një faturë elektronike është lëshuar dhe blerësi e pranon atë, ajo do të regjistrohet në librin e shitjeve të shitësit dhe në librin e blerjeve të blerësit. Pasi blerësi verifikon faturën e marrë në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave, mund ta pranojë atë për ta paguar ose ta refuzojë nëse dëshiron të heqë dorë nga transaksioni. Ky status i faturës elektronike do të regjistrohet në platformën qendrore të faturave. Nëse fatura elektronike është refuzuar nga blerësi, ajo do të hiqet nga libri i tij i blerjeve dhe shitësi, pra tatimpaguesi që ka lëshuar

faturën, do të duhet të lëshojë një faturë korrigjuese dhe ta fiskalizojë atë. Në këtë rrethanë, fatura korrigjuese nuk do të regjistrohet në librin e blerjeve të blerësit, por do të regjistrohet në librin e shitjeve të shitësit. Nëse fatura elektronike është pranuar për t'u paguar nga blerësi dhe tatimpaguesi që ka lëshuar faturën lëshon një faturë korrigjuese më vonë, ajo duhet të fiskalizohet dhe të shkëmbehet me blerësin nëpërmjet platformës qendrore të faturave, dhe kur blerësi e pranon atë, ajo do të regjistrohet në librin e tij të blerjeve. Çdo faturë elektronike e lëshuar (përfshirë faturat korrigjuese) nga tatimpaguesi që lëshon fatura do të regjistrohet në librin e tij të shitjeve pas kryerjes së procedurës së fiskalizimit.

6. Në rastet kur tatimpaguesi duhet të ndryshojë elemente të tjera të faturës të cilat janë të pasakta (për shembull NIPT-i i blerësit, mënyra e pagesës etj.), së pari duhet të lëshojë një faturë korrigjuese me të gjithë elementët e njëjtë si në faturën origjinale (përveç datës së lëshimit dhe numrit të faturës, të cilat janë elementet që lidhen me vetë faturën korrigjuese) dhe e gjithë shuma duhet të jetë negative. Pas kësaj duhet të lëshohet një faturë e re me të dhëna të sakta dhe duke iu referuar NSLF-së së faturës së parë të lëshuar (të origjinalit dhe jo të faturës korrigjuese).

Neni 36
Njoftimi për faturën

1. Në përputhje me nenin 33 të Ligjit, tatimpaguesi që lëshon fatura është i detyruar të paraqesë një njoftim në secilën nga vendet e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tij (vendet fikse), në çdo pajisje elektronike të faturimit ose në ndonjë vend tjetër të dukshëm për konsumatorin, lidhur me detyrimin e tatimpaguesit për të lëshuar faturën dhe detyrimin e blerësit për ta marrë dhe mbajtur atë.

2. Forma dhe përmbajtja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni janë bashkëngjitur në Shtojcën 5 të këtij Udhëzimi.

3. Nëse blerësi është një tatimpagues, person fizik ose juridik, për qëllime tatimore, në bazë të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë është i detyruar të marrë faturën dhe ta ruajë atë për 5 vite të plota kalendarike, duke filluar nga viti pas vitit që u lëshua fatura.

4. Me kërkesë të një punonjësi të autorizuar të administratës tatimore, blerësi duhet t'i tregojë faturën e lëshuar.

5. Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën, në përputhje me Ligjin.

Neni 37
Detyrimet e blerësit

Në përputhje me nenin 34 të Ligjit, blerësi ose marrësi i një fature të lëshuar për pagesë me para në dorë, duhet ta mbajë faturën e lëshuar deri në 30 metra pas largimit nga vendi i ushtrimit të aktivitetit të shitësit, pra të tatimpaguesit që ka lëshuar faturën. Me kërkesë të një punonjësi të autorizuar të administratës tatimore, blerësi duhet t'i tregojë faturën e lëshuar.

Neni 38
Verifikimi i faturës

1. Blerësit dhe të gjithë marrësit e faturave, për të gjitha faturat e marra nga tatimpaguesit që janë të detyruar të lëshojnë fatura, sipas nenit 4 të Ligjit, mund të verifikojnë nëse fatura raportohet në administratën tatimore, brenda 60 ditëve nga data e lëshimit të faturës.

2. Verifikimi do të bëhet duke skanuar kodin QR në faturë nga një telefon inteligjent, nga ndonjë pajisje tjetër elektronike që ka funksionin e skanimit ose përmes platformës qendrore të faturave duke kërkuar faturën në librin e blerjeve (nëse blerësi është një tatimpagues që lëshon fatura dhe NIPT-i i tij shkruhet në faturë). Ka shumë aplikacione në dyqanin e aplikacioneve të disponueshme për shkarkim falas. Kodi QR kodon një lidhje me aplikimin e administratës tatimore qendrore me detaje të faturës së skanuar. Këtu është një shembull i kodit QR i cili mund të gjendet në faturë:

3. Blerësi dhe të gjithë marrësit e faturës, gjithashtu mund të kryejnë verifikimin e faturës duke bërë një kërkesë në shërbimin në internet

ose aplikacionin e telefonit celular të disponueshëm në faqen e internetit të administratës tatimore dhe duke futur manualisht të dhënat e kërkuara (për shembull, NIVF ose NSLF e faturës). Në situatat kur fatura lëshohet manualisht nga blloku i veçantë i faturave ose kur mungojnë disa nga të dhënat e përmendura, blerësi mund të verifikojë faturën në zyrën më të afërt të administratës tatimore.

4. Pas skanimit të kodit QR ose hedhjes së të dhënave sipas pikës 3 të këtij neni, blerësi do të drejtohet në faqen e vlefshmërisë së sistemit të informacionit të administratës tatimore për të konfirmuar statusin e fiskalizimit të faturës. Kur hapet aplikacioni, hapet faqja me detaje rreth faturës. Në këndin e sipërm të djathtë, ka një ikonë e cila tregon statusin e faturës.

i. Ekzistojnë tre raste të mundshme:

ii. Fatura është regjistruar me sukses

iii. Fatura ka një problem që duhet raportuar

Përdoruesi merr një mesazh paralajmërues në fund të ekranit

5. Nëse fatura është regjistruar me sukses, shfaqen informacionet në lidhje me faturën. Në krye ka informacione kryesore si vlera totale e faturës, shuma e TVSH-së, emri dhe adresa e lëshuesit të faturës, data dhe koha e lëshimit të faturës etj. Këtu më poshtë është një imazh i modelit me informacionin e përshkruar:



Në mes të ekranit ka informacione të zgjeruara në lidhje me faturën si kodet unike të faturës (NIVF dhe NSLF), kodi i vendit të ushtrimit të aktivitetit të biznesit ku është lëshuar fatura, kodi i pajisjes elektronike të parave të përdorur për lëshimin e faturës, numri unik identifikues i tatimpaguesit që ka lëshuar faturën, numrin e faturës etj.

Pas kësaj pjese vjen lista e artikujve. Për secilin artikull ka një emër, si edhe çmimin për njësi, sasinë e artikujve të blera, çmimin e përgjithshëm të tyre dhe TVSH-në përkatëse. Gjithashtu, shfaqet shuma e cila përfshin numrin e artikujve, shkallën e TVSH-së, bazën e tatueshme të artikujve të grupuar, çmimin total duke përfshirë TVSH-në e të gjitha produkteve me të njëjtën normë të TVSH-së, TVSH-në totale të të gjithë artikujve me të njëjtën normë të TVSH-së.

Konsumatori mund ta krahasojë këtë përmbajtje të ruajtur me të dhënat në faturën e marrë dhe t'i raportojë drejtorisë së administratës tatimore direkt mbi aplikacionin nëse ka ndonjë problem me atë faturë.

6. Në rast se fatura nuk është regjistruar, do të shfaqet një mesazh që udhëzon blerësin, që të kthehet përsëri më vonë, kjo sepse sipas Ligjit, në disa raste fatura mund të regjistrohet pasi të jetë lëshuar, por ajo duhet të bëhet brenda afatit kohor, siç përshkruhet në Ligj, për shembull:

a) Fatura nuk gjendet në bazën e të dhënave, por fatura është lëshuar gjatë 5 ditëve të fundit. Në këtë situatë, tatimpaguesi që ka lëshuar faturën ka 48 orë ose 5 ditë afat kohor për të fiskalizuar faturën (në varësi të rastit nëse është situata e parashikuar në nenet 29 ose 30 të Ligjit). Për këtë arsye, megjithëse fatura nuk gjendet në bazën e të dhënave, ky rezultat ende nuk do të thotë se ekziston një shkelje e Ligjit. Konsumatori mund të përsërisë procedurën e verifikimit pas 5 ditësh nga dita e lëshimit të faturës.

b) Fatura i nënshtrohet procedurës mujore të fiskalizimit. Kjo do të thotë që fatura nuk gjendet në bazën e të dhënave të administratës tatimore, por meqenëse tatimpaguesi që ka lëshuar faturën ka një konfirmim nga administrata tatimore qendrore që mund të fiskalizojë faturat çdo muaj, sepse kryen biznes në zonë pa lidhje interneti, ky rezultat akoma nuk do të thotë se ekziston një shkelje e Ligjit. Blerësi mund të përsërisë procedurën e verifikimit pas datës 10 të muajit pasardhës në të cilin është lëshuar fatura.

7. Ndonjëherë një faturë e lëshuar duhet të korrigjohet, kështu që tatimpaguesi që ka lëshuar faturë do të lëshojë një faturë korrigjuese dhe do ta fiskalizojë atë duke iu referuar faturës origjinale. Në këtë situatë, blerësi do të marrë një nga mesazhet e mëposhtme paralajmëruese:

a) "Fiskalizimi i suksesshëm, por ky është korrigjim i një fature tjetër" - Në këtë situatë blerësi ka verifikuar faturën korrigjuese dhe do të shfaqet referenca për faturën origjinale që po korrigjohet (NSLF e saj). Nëse blerësi nuk e ka marrë faturën origjinale, me të cilën lidhet kjo faturë korrigjuese, atëherë ka shumë të ngjarë që tatimpaguesi është në shkelje dhe blerësi duhet ta raportojë atë pranë administratës tatimore, direkt në kërkesë.

b) "Fiskalizimi i suksesshëm, por ka fatura korrigjuese të kësaj fature" - Në këtë situatë blerësi ka verifikuar faturën origjinale dhe referenca për faturat e saj korrigjuese është lëshuar dhe fiskalizuar pasi të shfaqet fatura (NSLF e tyre). Nëse blerësi nuk i ka marrë këto fatura korrigjuese, kjo do të thotë që ka shumë të ngjarë që tatimpaguesi është në shkelje dhe blerësi duhet ta raportojë atë pranë administratës tatimore, direkt mbi aplikacionin.

8. Në rast se ka një problem me faturën, e cila duhet të raportohet bazuar në faturën e verifikuar nga blerësi dhe të dhënat e ruajtura në sistemin e informacionit të administratës tatimore, mund të hasen situatat e mëposhtme:

a) Fatura nuk është e regjistruar në bazën e të dhënave - Në këtë rast fatura nuk gjendet në bazën e të dhënave të administratës tatimore, që do të thotë se nuk është fiskalizuar, dhe ka kaluar më shumë se 48 orë/5 ditë nga lëshimi i faturës dhe tatimpaguesi nuk ka një aprovim për fiskalizimin mujor ose nuk ka kaluar afati kohor për fiskalizimin pasues. Në këtë rast, administrata tatimore qendrore do të kryejë një analizë të hollësishme. Rrjedhimisht, tatimpaguesi ka shumë të ngjarë të ketë shkelur Ligjin.

b) NIVF nuk është i vlefshëm - Në këtë rast NIVF nuk është formuar siç duhet dhe gabimi do të shfaqet. Ky gabim tregon se fatura është e dyshimtë dhe duhet të analizohet më tej nga administrata tatimore.

c) Detajet e lëshuara të faturës nuk përputhen me detajet e faturës në kërkesë - Arsyet e mundshme përfshijnë një rast kur software për regjistrimin e faturave përmban disa gabime dhe regjistron faturën me të dhëna të pasakta. Arsye tjetër mund të jetë kur fatura e lëshuar ka një kod të rremë NIVF, NSLF dhe QR të cilat janë vendosur në faturë vetëm për ta bërë atë të duket e saktë, por në realitet, ato mund të lidhen me disa fatura të tjera ekzistuese. Kështu, ka shumë të ngjarë që tatimpaguesi të jetë në shkelje.

ç) Fatura korrigjuese nuk është regjistruar brenda afatit të kërkuar - Në këtë situatë tatimpaguesi ka verifikuar faturën korrigjuese, por kjo faturë nuk ishte në bazën e të dhënave, dhe ka kaluar më shumë se 48 orë/5 ditë nga lëshimi i faturës korrigjuese dhe tatimpaguesi nuk ka një aprovim për fiskalizimin mujor, ose ka kaluar afati kohor për fiskalizimin pasues. Edhe në këtë rast, ka shumë të ngjarë që tatimpaguesi të jetë në shkelje.

d) Parametrat e faturës nuk përputhen me detajet e faturës në aplikim - Në këtë situatë kodi QR në faturat e lëshuara ka një lidhje me aplikacionin në internet me parametrat e pyetjeve të cilat përshkruajnë disa nga detajet e rëndësishme për identifikimin e faturës. Këto parametra përfshijnë NSLF, shumën totale, datën e lëshimit të faturës dhe informacione të tjera. Është e mundur që kodi QR të përmbajë informacion të pavlefshëm, si për shembull ekziston një faturë e regjistruar në NSLF nga kodi QR, por parametra të tjerë, si shuma totale e faturës, nuk përputhen me informacionin në faturën e regjistruar me të njëjtën NSLF. Pritet që ky lloj gabimi të vijë nga gabime në programin e pajisjes elektronike të faturimit që lëshojnë faturën problematike.

9. Nëse një kërkesë për verifikim është zyrtarisht e pasaktë, blerësi ose marrësi i faturës merr një mesazh se është e nevojshme të kontrollojë saktësinë e informacionit të dhënë.

10. Nëse sistemi i verifikimit të faturës nuk është përkohësisht i disponueshëm, blerësi ose marrësi i faturës merr një mesazh ku thuhet se sistemi i verifikimit të faturës nuk është i disponueshëm.

11. Nëse fatura e paraqitur për verifikim nuk është e regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore, ose blerësi has në ndonjë problem tjetër me faturën, blerësi ose marrësi i faturave mund të raportojë direkt në aplikacionin për verifikimin e faturës. Ky do të hapë një formular ku blerësi mund të shkruajë informacion shtesë në lidhje me faturën. Në raport, blerësi mund të përfshijë informacionin e tij të kontaktit në mënyrë që të kontaktohet nga administrata tatimore, nëse ka informacione shtesë që do të ndihmonin për raportin. Blerësi gjithashtu mund të vendosë të qëndrojë anonim dhe të mos paraqesë informacione personale. Shënimet shtesë mund të vihen nga blerësi për të dhënë detaje shtesë rreth faturës ose lëshuesit. Raporti i lëshimit do t'i

përcillet administratës tatimore e cila do të përpunojë raportet dhe do të ndërmarrë veprimet e kërkuara. Blerësi, gjithashtu mund të paraqesë faturat me disa probleme ose parregullsi në zyrën më të afërt të administratës tatimore për qëllime kontrolli.

Neni 39
Ruajtja e faturave

1. Sipas nenit 36 të Ligjit, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të marrë masa për të ruajtur faturat e lëshuara, në përputhje me dispozitat e Ligjit.

2. Sipas pikës 3, të nenit 6, të Ligjit, tatimpaguesi duhet t'i mbajë faturat në formën e tyre origjinale, qoftë kjo në letër ose në formë elektronike, në të cilën ato janë dërguar ose bërë të disponueshme. Tatimpaguesi që lëshon fatura mund, pavarësisht nga forma e tyre origjinale t'i ruajë gjithashtu faturat në formë elektronike, nëse këto metoda ruajtjeje e bëjnë të pamundur ndryshimin, fshirjen e të dhënave ose riprodhimin e faturave në formën e tyre origjinale. Nëse faturat ruhen me mjete elektronike, informacioni duhet të ruhet gjithashtu me mjete elektronike, duke garantuar autenticitetin e origjinës dhe integritetin e të dhënave.

3. Sipas nenit 28 të Ligjit, që nga momenti i lëshimit deri në fund të periudhës së ruajtjes së faturave, tatimpaguesi duhet të sigurojë autenticitetin e origjinës, integritetin e përmbajtjes dhe lexueshmërinë e faturave të lëshuara, qoftë kjo në letër apo në formë elektronike.

4. Origjinaliteti dhe integriteti i të dhënave të faturës elektronike duhet të sigurohen nëpërmjet nënshkrimit elektronik.

5. Autentifikimi i burimit të faturës është sigurimi i identifikimit të furnizuesit ose lëshuesit të faturës. Autenticiteti i origjinës së një fature është një detyrim për tatimpaguesin që merr furnizimin me mallra ose shërbime, ashtu si dhe për tatimpaguesin që kryen furnizimin. Në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, secili mund të sigurojë autenticitetin e origjinës. Tatimpaguesi mund të sigurojë identifikimin e lëshuesit të faturës elektronike nëpërmjet nënshkrimit elektronik. Sidoqoftë, kjo pa përjashtuar faktin që faturat duhet të pasqyrojnë furnizimet reale.

6. Integriteti i përmbajtjes së faturës do të thotë që kërkesat për përmbajtjen e faturës, siç kërkohet nga Ligji, nuk janë ndryshuar që kur është lëshuar fatura. Integriteti i përmbajtjes së një fature është një detyrim për të dy tatimpaguesit, si për furnizuesin, ashtu edhe për marrësin e furnizimit. Të dy mund ta përmbushin këtë detyrim nëpërmjet nënshkrimit elektronik për të siguruar që përmbajtja është e pandryshuar. Duke siguruar që përmbajtja e faturës, siç kërkohet nga Ligji, nuk është ndryshuar, formati në të cilin mbahet kjo përmbajtje mund të konvertohet në formate të tjera (një ndryshim formati mund të jetë një ndryshim në llojin e skedarit, si për shembull XML, në një format tjetër elektronik, pa ndryshuar përmbajtjen). Kjo i mundëson klientit ose një ofruesi shërbimi që vepron në emër të tij, të konvertojë ose paraqesë në një mënyrë të ndryshme të dhënat elektronike, me qëllim që të përputhen me sistemin e tij të informacionit ose si rrjedhojë e ndryshimeve teknologjike me kalimin e kohës. Megjithatë, në konvertimin nga një format në tjetrin, ndryshimi duhet të regjistrohet në gjurmën e auditimit.

7. Lexueshmëria e një fature nënkupton që fatura është e lexueshme nga njeriu. Fatura duhet të paraqitet në një formë ku të gjithë elementet e faturës janë qartësisht të lexueshme, në letër ose ekran, pa nevojën e ekzaminimit ose interpretimit të tepruar, për shembull, mesazhet XML dhe mesazhet e tjera të strukturuara në formatin origjinal nuk konsiderohen të lexueshme nga njeriu (pas një procesi konvertimi, ato mund të konsiderohen si të lexueshme nga njeriu). Për faturat e ruajtura në formë elektronike, ky kusht do të konsiderohet si i plotësuar nëse fatura mund të paraqitet menjëherë, me kërkesë brenda një kohe të arsyeshme, përfshirë pas një procesi konvertimi, në një formë të lexueshme nga njeriu në ekran ose nëpërmjet printimit. Duhet të ekzistojë mundësia për të kontrolluar që informacioni ndërmjet skedarit origjinal elektronik dhe dokumentit të lexueshëm të paraqitur, nuk ka ndryshuar. Për të garantuar lexueshmërinë, fatura e ruajtur elektronikisht duhet të ruhet në një mënyrë të përshtatshme dhe të besueshme gjatë gjithë periudhës së ruajtjes.

Neni 40
Procedurat për regjistrimin në arkë, për pagesat me para në dorë

1. Duke përdorur shërbimin e sistemit të fiskalizimit, tatimpaguesit që lëshojnë fatura dhe që përdorin pajisjen elektronike të faturimit për pagesa

me para në dorë (vetëm kartëmonedha dhe monedha), raportojnë bilancin fillestar të depozitave në para në fillim të çdo dite pune për çdo pajisje individuale të përdorur, përpara lëshimit të parë të faturës. Shuma fillestare është shuma fillestare e parave në dorë në arkë (kartëmonedha dhe monedha), që mund të ketë tatimpaguesi në arkën e tij në fillim të ditës së punës ose të turnit të secilit operator.

2. Sipas mënyrës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, tatimpaguesi është i detyruar të raportojë çdo ndryshim në shumën e depozitës së parave të regjistruar gjatë së njëjtës ditë në momentin kur ndodh ndryshimi:

a) duke vendosur në arkë (pajisja elektronike e faturimit) një shumë parash shtesë. Në këtë situatë, tatimpaguesi regjistron shumën e re të depozitës së parave në dorë të shtuar në depozitën fillestare si "shtesë parash" dhe kjo shumë do t'i shtohet shumës fillestare të parave në dorë të regjistruara dhe/ose;

b) duke tërhequr një shumë të caktuar parash nga arka gjatë ditës së punës. Në këtë situatë, tatimpaguesi duhet të regjistrojë vetëm shumën e "tërheqjes së parave" e cila është shuma e parave në dorë të tërhequra nga arka.

3. Në bazë të të dhënave të raportuara të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, shuma e parave për një pajisje elektronike individuale të verifikuar duhet të korrespondojë në çdo kohë me shumën e parave të mbledhura bazuar në faturën/at e lëshuar/a për pagesa me para në dorë (kartëmonedha dhe monedha) gjatë asaj dite dhe shumën e depozitës së parave të raportuara.

4. Nëse orari i punës së vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit raportohet të jetë 0-24, depozita e parave duhet të raportohet në fillim të çdo dite dhe sa herë që depozitat në para ndryshojnë gjatë ditës.

5. Nëse tatimpaguesi ushtron veprimtari biznesi në një zonë ku vendosja e një lidhjeje të përhershme me internet nuk është e mundur ose ku ka një ndërprerje të përkohshme në shërbimin e komunikimit me sistemin e informacionit të administratës tatimore, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të sigurojë ruajtjen e të dhënave për depozitën e parave, të ruajë informacionin e depozitave të parave në fillim të çdo dite, si dhe ta firmosë atë elektronikisht me certifikatën elektronike. Më pas, brenda 48 orëve, këtë informacion duhet ta dërgojë në sistemin e informacionit të administratës tatimore, duke përdorur shërbimin e fiskalizimit pas rregullimit të problemit ose rivendosjes së lidhjes me internet.

6. Depozita e parave mund të jetë gjithashtu zero (0), por duhet të regjistrohet.

7. Në rastin kur një vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit pranon si metodë pagese vetëm kartat e kreditit ose të debitit (për shembull, në rastet e një dyqani në internet ose aktiviteti të shitjes në distancë) ose ndonjë metodë tjetër pagese të ndryshme nga kartëmonedha dhe monedha, tatimpaguesi nuk ka detyrimin të regjistrojë depozitën e parave çdo ditë.

8. Grupi i të dhënave të mesazhit të kërkesës për raportimin e statusit dhe ndryshimeve në depozitën e parave, si dhe mesazhet e përgjigjes janë specifikuar në specifikimet teknike të publikuara në faqen e internetit të administratës tatimore qendrore.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Shtojca

1: Formulari "Informacion për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit"

"INFORMACION PËR VENDIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË BIZNESIT"										
A) Regjistrim fillestar B) Ndryshim, kodi i vendit të ushtrimit të aktivitetit të biznesit: Data e dorëzimit:										
Nr.	Përshkrimi	Të dhënat								
1	Numri unik i identifikimit të tatimpaguesit (NIPT) që lëshon fatura**:									
2	Emri i tatimpaguesit që lëshon fatura*:									
3	Emri tregtar i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, nëse ka:									
4	Statusi i tatimpaguesit* (Nga Qendra Kombëtare e Biznesit/Administrata Tatimore):	a) Aktiv	b) Kërkesë për çregjistrim		c) Çregjistruar		d) Falimentuar		e) Pasiv	
5	Adresa e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	a) Rruga:		b) Qyteti	c) Qarku	d) DRT	e)Agjencia Tatimore	ë) Kodi postar:		
6	Lloji i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	a) objekt		b) truall			c) automjet			
7	Lloji i veprimtarisë që ushtrohet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	a) fikse		b) e lëvizshme		d) punë në terren		f) magazinë		
		c) tregti online		g) market / treg		h) shërbime		e) vetëshërbimi (automatët)		
8	Targa e automjetit (për automjete të regjistruara si vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit):									
9	Llojet e veprimtarisë ekonomike të kryera në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	aktiviteti kryesor:								
		aktiviteti dytësor:								
10	Data e fillimit të veprimtarisë ekonomike në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:									
11	Data e mbylljes së veprimtarisë ekonomike në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, përfshirë datën e mbylljes së përkohshme, nëse ka*:									
12	Sipërfaqja e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, për vendet fikse (në m^2):	e brendshme:			e jashtme:					
13	Metoda e pagesës e pranuar për furnizimin e mallrave ose shërbimeve në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	a) me para në dorë (cash)				b) pa para në dorë (non-cash)				
14	Situata e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit*:	a) Hapur				c) Mbyllur				
15	A është lidhja me internet e disponueshme*:	a) jo	b) po, Emri dhe NIPT-i i ofruesit të internetit:							
16	Specifikoni nëse hapësira e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është në pronësi ose me qira:	a) në pronësi			b) me qira, Emri dhe ID/ NIPT-i i qiradhënësit:					
17	NIPT-i i mirëmbajtësit të zgjidhjes software-ike:									
18	Orari ditor i punës, ditët e punës në javë, si dhe puna në ditët e festave zyrtare*:	E Hën.	E Mar.	E Mër.	E Enj.	E Pre.	E Sht.	E Die.	Festa	
19	Rregulli i numrave rendorë të faturës*:	a) në nivelin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit			b) në nivelin e secilës pajisje elektronike faturimi			c) sipas mënyrës së pagesës		
20	Shënime:									
* fushat janë të detyrueshme për dorëzimin e formularit të parë; të tjerat janë të detyrueshme nëse aplikohen. ** në rastet e ndryshimeve, fusha NIPT është e detyrueshme, sëbashku me fushat e tjera që kanë ndryshuar.		Nënshkrimi i tatimpaguesit:								

Shtojca 2: Formulari "Informacion për operatorët"

"INFORMACION PËR OPERATORËT"			
A) Dorëzimi i parë	B) Ndryshimet	Data e dorëzimit:	

I. Të dhëna për tatimpaguesin që lëshon fatura	
Emri i tatimpaguesit:	
NIPT-i i tatimpaguesit:	

II. Të dhëna për operatorët		
Nr.	**Përshkrimi**	**Të dhëna**
1.	Emri dhe mbiemri/Emri:	
	Numri i identifikimit personal/NIPT-i:	
	Vlen nga (data e fillimit të lëshimit të faturës):	
	Vlen deri në (data e përfundimit, nëse dihet):	
2.	Emri dhe mbiemri/Emri:	
	Numri i identifikimit personal/NIPT-i:	
	Vlen nga (data e fillimit të lëshimit të faturës):	
	Vlen deri në (data e përfundimit, nëse dihet):	
3.	Emri dhe mbiemri/Emri:	
	Numri i identifikimit personal/NIPT-i:	
	Vlen nga (data e fillimit të lëshimit të faturës):	
	Vlen deri në (data e përfundimit, nëse dihet):	
4.	Emri dhe mbiemri/Emri:	
	Numri i identifikimit personal/NIPT-i:	
	Vlen nga (data e fillimit të lëshimit të faturës):	
	Vlen deri në (data e përfundimit, nëse dihet):	

Nënshkrimi i tatimpaguesit:	

Shtojca 3: Formulari "Regjistrimi i pajisjeve elektronike të faturimit"

"REGJISTRIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE TË FATURIMIT"			
A) Dorëzimi i parë	B) Ndryshimet	Data e dorëzimit:	

I. Të dhëna për tatimpaguesin që lëshon fatura	
Emri i tatimpaguesit:	
NIPT-i i tatimpaguesit:	

II. Të dhëna për pajisjen/t elektronike të faturimit (KASË)		
Nr.	**Përshkrimi**	**Të dhëna**
1.	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	
	Numri rendor i kasës:	
	Kodi i zgjidhjes së software-it:	
	Kodi i mirëmbajtësit të software-it:	
	Kodi i kasës*:	
	E vlefshme nga:	
	E vlefshme deri në (nëse dihet):	
2.	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	
	Numri rendor i kasës:	
	Kodi i zgjidhjes së software-it:	
	Kodi i mirëmbajtësit të software-it:	
	Kodi i kasës*:	
	E vlefshme nga:	
	E vlefshme deri në (nëse dihet):	
3.	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	
	Numri rendor i kasës:	
	Kodi i zgjidhjes së software-it:	
	Kodi i mirëmbajtësit të software-it:	
	Kodi i kasës*:	
	E vlefshme nga:	
	E vlefshme deri në (nëse dihet):	
*vetëm kur dorëzohen ndryshimet		
	Nënshkrimi i tatimpaguesit:	

Shtojca 4: Formulari "Raportim për pamundësinë për të vendosur lidhje me shërbimin fiskal"

"RAPORTIM PËR PAMUNDËSINË PËR TË VENDOSUR LIDHJE ME SHËRBIMIN FISKAL"		
	Data e dorëzimit:	
I. Të dhëna për tatimpaguesin që lëshon fatura		
Emri i tatimpaguesit:		
NIPT-i i tatimpaguesit:		
II. Të dhëna për vendin/et e ushtrimit të biznesit pa lidhje interneti		
Nr.	**Përshkrimi**	**Të dhëna**
1.	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	
	Data dhe ora kur filloi ndërprerja:	
	Arsyet e pamundësisë për të rivendosur lidhjen me shërbimin fiskal:	
	Dokumentacioni i bashkëngjitur:	
2.	Kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit:	
	Data dhe ora kur filloi ndërprerja:	
	Arsyet e pamundësisë për të rivendosur lidhjen me shërbimin fiskal:	
	Dokumentacioni i bashkëngjitur:	
Nënshkrimi i tatimpaguesit:		

Shtojca 5: Njoftimi i detyrimit për të marrë dhe mbajtur faturën



URDHËR
Nr. 132, datë 8.3.2020

PËR MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat "b" dhe "c", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri", si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike të tilla si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, deri në datën 3 prill 2020.
2. Anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, deri në datën 3 prill 2020.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë strukturat përgjegjëse për organizimin e veprimtarive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.156/1, datë 10.3.2020

PËR NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE TË UDHËTARËVE DREJT ITALISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "a" të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, vendimin e Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve të udhëtarëve me mjetet e transportit ajror nga Aeroporti "Nënë Tereza, Tiranë drejt Italisë, deri në një urdhër të dytë.
2. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit detar nga të gjithë portet në vend drejt Italisë, deri në një urdhër të dytë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me Autoritetin Portual Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Tirana International Aeroport.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.156/2, datë 11.3.2020

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EPIDEMISË NGA INFEKSIONI COVID-19

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21 pika 1, të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrotjen e shëndetit të popullatës dhe mospërhapjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19 deri në një urdhër të dytë.
2. Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë institucionet e përcaktuara në ligjin 15/2016 "Për

parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të zbatojë protokollet specifike për ndërhyrje në situatën epidemie të shkaktuara nga COVID-19.

3. Ngarkohen Instituti i Shendetit Publk, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori Qendror i Kujdesit Shëndetësor, të gjithë institucionet e kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, organet e qeverisjes vendore të ndërmarrin të gjitha hapat sipas planeve të veprimit në situatë epidemie.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 164, datë 12.3.2020

PËR MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, LOKALEVE, FAST FOOD DHE KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT

Në zbatimi të nenit 7, pika 4 të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si dhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, në të gjithë vendin, deri në datën 3.4.2020.

2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjenike të miratuara.

3. Përdorimi i shërbimeve të bareve dhe restoranteve në strukturat akomoduese vetëm për qytetarët e akomoduar në strukturën akomoduese përkatëse, deri në datën 3.4.2020.

4. Strukturat akomoduese ndalohen të ofrojnë shërbim bar dhe restorant për qytetarë që nuk janë klientë të stukturës akomoduese, deri në datën 3.4.2020.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.

6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

URDHËR
Nr. 165 datë 12.3.2020

PËR MBYLLJEN E KABINETEVE/KLINIKAVE DENTARE

Në zbatimi të nenit 7, pika 4 të ligjit Nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", ligjit nr 9106 datë 17.07.2003 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë" me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e kabineteve/klinikave dentare, në të gjithë vendin deri në datën 3.4.2020.

2. Rastet e urgjencave stomatologjike të trajtohen në Klinikës Stomatologjike Universitare pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe në institucionet stomatologjike publike që do të funksionojnë vetëm për shërbimin e urgjencës stomatologjike.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.

4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 168, datë 12.3.2020

"PËR NDALIMIN/KUFIZIMIN E LËVIZJEVE ME MJETET E TRANSPORTIT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "ç", dhe "d" të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe referuar udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, brenda Tiranës dhe Durrësit dhe nga Tirana dhe Durrësi drejt zonave të tjera të vendit dhe anasjelltas, duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.3.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.3.2020.

2. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në Shkodër, Lezhë, Elbasan, Lushnje, Fier dhe Vlorë duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.3.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.3.2020.

3. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhëri bëhet për autoambulancat, automjetet që kryejnë funksione shërbimi me funksion publik dhe ato që trasportojnë mallra. Autorizimi për qarkullimin e autoambulancave, automjeteve që kryejnë funksione shërbimi shtetëror dhe ato që trasportojnë mallra kryhet sipas urdhëzimeve të Policisë së Shtetit.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të cilët bashkëpunojnë me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Policinë e Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.168/1, datë 15.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJEVE BRENDA VENDIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat "d" të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e trasportit publik dhe privat të udhëtarëve qytetas, ndërqytetas dhe rrethqytetas deri në një urdhër të dytë.

2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikën 1të këtij urdhri bëjnë mjetet e trasportit të pajisura me autorizim të posaçëm nga autoritetet kompetente dhe mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose privatë të cilët lejohen të qarkullojnë në intervalin kohor 5:00 deri në orën 8:00 dhe midis intervalit kohor nga ora 16:00 deri 17:00.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe strukturat përgjgjëse të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.168/2, datë 18.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES ME AUTOMJETET PRIVATE OSE SHTETËRORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat "d" të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjes me automjetet private ose automjete shtetërore të punonjësve të administratës publike të institucioneve qëndrore dhe atyre vendore, puna e të cilëve lidhet me qëndrimin në zyrë dhe jo në terren.
2. Përjashtim nga ky rregull bëjnë punonjësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përfshirë personelin mjekësor dhe infermjeror, punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Financës apo të prefekturave dhe bashkive që janë të përfshirë në listën prioritare të firmosur nga titullari i institucionit.
3. Ministritë dhe institucionet e administratës publike që nuk janë të përfshira në pikën 2 të këtij urdhri të paraqesin kërkesë pranë autoriteteve kompetente për personelin e tyre që duhet të lëvizë me automjet privat ose shtetëror, për t'u pajisur me lejë të posaçme.
4. Titullarët e institucioneve të vartësisë të institucioneve të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhëri të dërgojnë pranë ministrit ose kryetarit të bashkisë listën e arsyetuar të personave që duhet të lëvizin me automjetin privat ose shtetëror. Lista me emrat i përcillet autoriteteve kompetente për tu pajisur me leje të posacme.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri titullarët e institucioneve qëndrore dhe vendore të përfshira në këtë urdhër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.173/1, datë 14.3.2020

PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME GREQINË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "a" të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e transportit të pasagjerëve përmes rrugëve ajrore për/dhe nga të gjithë aeroportet e Greqisë duke filluar nga dt 15.3.2020 deri në një udhër të dytë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.177/1, datë 16.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES NË ZONAT URBANE

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat "d" të ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane pas orës 18:00, me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

2. Ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve pensionist në zonat urbane deri në një urdhër të dytë me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.177/2, datë 18.3.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 177/1 DATË 16.3.2020 "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES NË ZONAT URBANE"

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germat "d" të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 177/1, datë 16.3.2020 "Për kufizimin e lëvizjes në zonat urbane, bëhen këto ndryshime si vijon:

1. Pika 1 ndryshon si vijon:

"1. Kufizimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane, vetëm në fashat orare 06:00-10:00 dhe 16:00-18:00 dhe të pashoqëruar me personat të tjerë në krah".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si vijon:

"1/1 Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëjnë personat e pajisur me autorizim nga organet kompetente dhe rastet e një emergjence shëndetësore apo shoqëruesit për të sëmurët që marrin shërbim në spital".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.190, datë 19.3.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-2019

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve deri në datën 3.4.2020.

2. Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 153/1, datë 9.3.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19" dhe urdhri nr.135 datë 9.3.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19", shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.193, datë 20.3.2020

PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikëS 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201,"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të

Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00 – 13:00, duke filluar nga dita e hënë, datë 23.3.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet fnanciare.

2. Kufizimin e lëvizjes, në gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, ciklomotor, motomjete dhe mjete) duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 21.3.2020 deri në orën 05:00, të datës 23.3.2020. Përjashtohen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si dhe shërbimet në banesë (delivery).

3. Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1 dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 21.3.2020, deri në orën 05:00, datë 23.3.2020. Lista me aktivitetet e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri hyn në fuqi në orën 05:00 të datës 24.3.2020.

4. Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore, dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itenerarin shtëpi–punë.

5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 208, datë 30.3.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR .193, DATË 20.3.2020 "PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201,"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhërin nr.193 datë 20.3.2020 "Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë", bëhet një ndryshim si më poshtë vijon:

1. Në tabelën bashkëlidhur urdhrit bëhen këto ndryshime:

46	Gomisteri	Lejohen
68	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara	Lejohen
70	Shitje me pakicë për kancelari dhe pajisje të zyrës	Lejohen

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.216, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.190, DATË 19.03.2020 "PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-2019"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr. 190, datë 19.3.2020 "Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019", togfjalëshi "deri në datën 3.4.2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.217, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.164, DATË 12.03.2020 "PËR MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE DHE LOKALEVE, FAST-FOOD DHE KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikat 1, 3 dhe 4, të urdhrit nr.164, datë 12.3.2020 "Për mbylljen e bareve, restoranteve dhe lokaleve, fast-food dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët", togfjalëshi "deri në datën 3.4.2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.218, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.160, DATË 11.3.2020 "PËR NDËRPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË TË GJITHË STRUKTURAT SPITALORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr.160, datë 11.3.2020 "Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në të gjithë strukturat strukturat spitalore publike dhe jopublike", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 219, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 147, DATË 9.3.2020, "PËR NDERPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" DHE SPITALIN UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 10107 datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 9106 datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri", si dhe udhëzimit nr. 395 datë 8.3.2020 të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1.Në pikën 1, të urdhrit nr. 147, datë 9.3.2020, "Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 220, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 158, DATË 11.3.2020, "PËR PEZULLIMIN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE INVALIDITETIT TË PUNËS"

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10107 datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në pikën 3, të urdhrit nr. 158, datë 11.3.2020, "Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 221, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.165, DATË 12.3.2020 "PËR MBYLLJEN E KABINETEVE/KLINIKAVE DENTARE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr.165, datë 12.3.2020 "Për mbylljen e kabineteve/klinikave dentare", togfjalëshi "deri në datën 3.4.2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.222, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.132, DATË 8.3.2020 "PËR MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e

shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 dhe 2 të urdhrit nr.132, datë 8.3.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr.223, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 156, DATË 10.3.2020, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19"

Në zbatimi të nenit 7, pika 4 të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës, me propozim të Komitetit të Ekspertëve dhe Institutit të Shëndetit Publik,

URDHËROJ:

1. Në pikat 1, 2 dhe në të gjithë përmbajtjen e urdhrit nr. 156, datë 10.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", togfjalëshi "deri në datën 3.4.2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 51, datë 26.03.2020

MBI DISA NDRYSHIME TË PËRKOHSHME NË PROCEDURAT E LICENCIMIT NË USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR NË KUADËR TË MASAVE PAS SHFAQJES SË VIRUSIT COVID-19 DHE SHPALLJES SË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE NË VENDIN TONË

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, nenit 16 të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015 "Për sektorin gazit natyror", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", vendimit të datës 9.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Corunavirus i ri, nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2020, pasi shqyrtoi relacionin "Për disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19, dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë",

konstatoi se:

-Aktualisht në vend është shpallur gjendja e epidemisë për shkak të Covid 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte normative mbi masat për parandalimin e Virusit Covid 19 duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizim në qarkullimin e njerëzve por edhe kufizim të disa aktiviteteve që nuk do të lejohen gjatë gjendjes së virusit Covid 19.

-Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020 është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

-Në këtë vendim gjithashtu në pikën 6.2 përcaktohet ndër të tjera që Institucionet publike:

a) të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;

d) të kufizojnë aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë;

e) të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publike;

-Në kuptim të akteve normative dhe siç bërë publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, një sërë aktivitetesh janë mbyllur. Ndërkohë aktivitetet që lidhen me sigurimin e energjisë elektrike vijojnë të ushtrohen.

-Në kuptim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, aktivitetet e prodhimit transmetimit shpërndarjes furnizimit dhe tregtimit në sektorët respektive ushtrohen si aktivitete të licencuara nga ERE.

-Disa akte normative janë nxjerrë në kuadër të gjendjes që lidhen me epideminë e Covid 19.

-Edhe institucionet publike kanë marrë masa përfshirë pezullimin apo reduktimin e aktiviteteve. Të tilla janë vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 127, datë 10.3.2020 "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë", e me tej vendimi nr. 128, datë 24.3.2020 "Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë".

-Mbështetur në aktet normative dhe VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, institucionet e administratës publike po kryejnë funksionet e tyre organike, për aq sa është e mundur, nëpërmjet platformave online, me qëllim kufizimin e aksesit të publikut në ambiente me frekuentim të gjerë.

-Në rregulloret për procedurat e licencimit të miratuar nga ERE, ndër të tjera, kërkohet edhe depozitimi i vërtetimeve që lidhen me gjendjen gjyqësore.

-Në kushtet që siç njoftuar në vendimet e mësipërme, aktiviteti i gjykatave është pezulluar marrja e këtyre vërtetimeve në kuadër të një aplikimi për licencim do të ishte e pamundur.

-Në kushtet e aktivitetit të kufizuar të veprimtarisë së shumë organeve të administratës shtetërore, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për procedurën e rinovimit të licencave apo dhe dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kushteve të licencimit të subjekteve të licencuar me kusht nga ERE, bëhet i pamundur.

-Për adresimin e këtyre problematikave, vlerësohet e përshtatshme vendosja e një periudhe tranzitore në lidhje me disa ndryshimet të përkohshme në procedurat e licencimit për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19-S dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë,

-Kjo masë do të shërbejë për të reduktuar edhe aktivitetet e institucionit siç edhe VKM nr. 243, datë 24.3.2020 përcakton, dhe mbi të gjitha duke ditur që në thelb të procesit të rinovimit të një licence është pajisja me vërtetimet mbi gjendjen gjyqësore, si të tillë gjykohet që:

-Të gjitha licencat, afati i të cilave përfundon jo më vonë se në 30 qershor 2020, nuk do t'i nënshtrohet një procesi rinovimi.

-Subjektet që dëshirojnë të rinovojnë licencën në një nga aktivitetet e licencuara nga ERE do të kenë detyrimin e kryerjes së një procesi rinovimi jo më vonë së 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.

-Të gjitha vendimet e licencimit me kusht, afati i plotësimit të të cilit përfundon jo më vonë se në 30 qershor 2020, u shtyhet afati i kushtit të parashikuar në vendimin e ERE deri jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.

-Së fundmi, një çështje tjetër e lidhur me situatën e epidemisë Coivd 19 ka të bëjë me reduktimin e aktivitetit të subjekteve mediatike ku nga mediat e shtypit të shkruar është bërë me dije se këto media ofrojnë botimet vetëm përmes botimeve online.

-Për të realizuar kërkesat e ligjeve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në lidhje me publikimin në gazetë të njoftimeve për aplikim për licencim, deri në përfundim të epidemisë së Covid 19 mund vlerësohet të vijohet me botimin online në media.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa "d" të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9 pika 1 germa "d", të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 04.07.2017.

2. Subjektet e licencuara gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t'i paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19 vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa "d" të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me vendimin e bordit nr. 215/2019, si dhe nenit 9 pika 1 germa "d", të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

3. Të gjitha licencat që përfundojnë deri në 30 qershor 2020 nuk do t'i nënshtrohen një procesi rinovimi. Këto subjekte kanë detyrimin për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.

4. Subjektet që nuk dëshirojnë të rinovojnë licencat u garantohet e drejta për të njoftuar ERE për këtë vullnet të tyre dhe automatikisht pas përfundimit të licencave të dhëna më parë do të hiqen nga regjistri i të licencuarve në përfundim të afatit të licencës së mëparshme.

5. Pezullimin e afateve të plotësimit të kushteve që lidhen me plotësimin e dokumentacionit, të përcaktuara në licencat e dhëna nga ERE në një nga veprimtaritë e parashikuara në ligjin nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe ligjin nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, deri jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.

6. Vendosjen e një periudhe pa afat nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës njoftimi në median e shkruar sipas nenit 10 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me vendimin e bordit nr. 215/2019, dhe nenit 10 pika 8 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017, do të realizohet përmes botimit online.

7. Të gjitha vendimet e licencimit të marra gjatë kësaj periudhe do të jenë objekt i rishikimit në kuadër të dorëzimit të dokumentacionit përkatës jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19.

8. Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare për veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendrike për aktivitet në sektorin e gazit natyror.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 58, datë 26.03.2020

MBI PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË FATURIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, GJATË PERIUDHËS SË ZBATIMIT TË AKTIT NORMATIV TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 8, DATË, 24.3.2020 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VECANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID – 19", TË NDRYSHUAR, SI DHE VKM NR.243, DATË 24.3.2020 "PËR SHPALLJEN E FATKEQËSISË NATYRORE"

Në mbështetje të neneve 6, 16, 19 dhe 20 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; VKM-së nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore"; VKM-së nr.8, datë, 24.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020,

të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19", të ndryshuar, si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij nr. 14 të datës 26.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.8, datë, 24.3.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19 si dhe relacionin e përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm i ERE,

Konstatoi se:

-OSHEE Group sh.a. me shkresën nr. 3457, datë 17.03.2020, dhe e-mailin e datës 26.3.2020, i është drejtuar ERE-s lidhur me mënyrën e zhvillimit të procesit të leximit dhe faturimit përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës së përhapjes së COVID – 19 në vendin tonë duke kërkuar përdorjen e vlerave referuese për faturimet e të njëjtit muaj të vitit të kaluar duke qenë se në bazë të akteve normative në fuqi e ka të pamundur aksesimin e sistemit të matjes dhe leximin përgjatë kësaj periudhe dhe sasia e klientëve të cilët janë të paaksesueshëm dhe e kanë të pamundur leximin në vend, është shumë e madhe.

OSHEE Group sha, në shkresën e saj pasi citon aktet normative të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, si dhe urdhrin e MIE-s nr.118, datë 10.03.2020 "Për përcaktimin e planit të masave për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19", në zbatim të urdhrit të MSHCS-së "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e COVID – 19"; mbylljes së të gjitha institucioneve të sistemit të edukimit, si dhe kufizimit të veprimtarive dhe numrit të punonjësve në të gjitha ndërmarrjet shtetërore, si dhe mbylljes së një numri të konsiderueshëm biznesesh, kërkon nga ana e ERE-s, që gjatë periudhës së zbatimit të akteve të sipërpërmendura për faturimin e klientëve të energjisë elektrike, nga ana e OSSH sha, të aplikohet parashikimi i nenit 76, pika të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

Bazuar në më sipër rezulton se:

-Për shkak të kufizimeve të parashikuara në aktet e mësipërme kufizohet mundësia për akesimin e plotë të sistemit të matjes nga OSSH sh.a.

-Bazuar në aktet e sipërpërmendura dhe në kushtet aktuale në terren konstatohet se me anë të akteve normative janë ndërmarrë një sërë kufizimesh si për individët ashtu dhe për bizneset. Po ashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve janë bërë me dije në faqen e internetit të kësaj të fundit lista e bizneseve të cilat do të lejohen të kryejnë aktivitet pas datës 24 mars 2020, fakt i cili ndikon në konsumin e energjisë elektrike të këtyre klientëve dhe që duhet të merret parasysh dhe faturimi i tyre të behet per kohen qe kane qene të hapur pre të zhvilluar aktivitetin.

-Vlerësojmë që propozimi i kërkuar nga ana e OSSH sh.a. me e-mailin e datës 26.03 ku si vlerë referencë për faturim për këtë periudhë kohore është propozuar të merret muaji i njëjtë i vitit të kaluar, pra viti 2019, është i drejtë dhe i shërben dhe situatës në të cilën ndodhemi për faktin se kjo mënyrë faturimi do të kryhet për një numër tejet të madh të klientëve në kushtet kur aksesi në sistemin e matjes i lexuesve është i kufizuar nga aktet normative në fuqi.

-Në mënyrë përjashtimore nga ky regjim, duhet të vijojë trajtimi I atyre klientëve të energjisë elektrike të cilët kanë faturim 0 kW h në 3 muajt e fundit e më parë , kanë ankesë për mbifaturim të energjisë elektrike për muajt për të cilët do të përdoret referenca, ose kanë bërë ose do të bëjnë kërkesë për pezullim/mbyllje të kontratave të energjisë elektrike në proces, për trajtimin e së cilës OSSH ka detyrimin të vazhdojë procedurën e pezullimit/mbylljes së kontratave sipas legjislacionit në fuqi.

-Një tjetër mase që duhet marrë parasysh është dhe për klientët të cilët janë në procese të mbylljes apo pezullimit të kontratave për të cilët procesi duhet të vazhdojë normalisht dhe nuk duhet të ndërpritet pasi ky është një proces i cili mund të zhvillohet dhe në kushtet e akteve normative në fuqi për parandalimin e përhapjes së pandemisë.

-Leximi përsa i takon matjes on-line duhet të vazhdojë normalisht. Një tjetër masë që duhet marrë parasysh është dhe fakti që nëse do të ketë ankesa për zbatimin e kësaj vendimmarrjeje OSSH sh.a. duhet të marrë masat për verifikimin dhe leximin e tyre në një kohë më të shpejtë se standardi normal i trajtimit të ankesave në situatë normale. Për këtë arsye duhet që OSSH dhe FSHU të lejojë mundësinë e ankimimit on linë, si dhe në sportelet e kujdesit të klientit vetëm sipas rregullave të përcaktuara sipas protokollit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, planit të masave të ndërmarra në vendin tonë për ndalimin e përhapjes së pandemisë si dhe akteve normative për ruajtjen e distancave ndërmjet personave, duke marrë për bazë për ankimimin në përmjet vetëdeklarimit të klientit për moskonsumim të energjisë elektrike.

-Në rast se do të rezultojnë diferenca ndërmjet faturimit me vlerë referuese zëvendësuese sipas këtij vendimi dhe vlerës reale të konsumit, duhet që ato të sistemohen brenda muajit të parë të përfundimit të afateve kohore të akteve normative të sipërpërmendura.

-Duhet mbajtur në konsideratë edhe njohja e klientëve me këtë vendimmarrje nëpërmjet mediave televizive, komunikimeve publike, në shtypin online apo dhe në faqen e internetit të shoqërisë dhe KNK-ve për t'i dhënë mundësinë këtyre të fundit për t'u njohur me të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. ERE do të vazhdoje monitorimin e veprimtarive të OSHEE sh.a. dhe FSHU sh.a. të cilat vijojnë të kenë detyrimin e raportimeve periodike në përputhje me kushtet e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë modalitetet e faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.8, datë , 24.03.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid – 19", të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore" si më poshtë:

2. Faturimin e klientëve të energjisë elektrike duke filluar që nga cikli i leximit të muajit mars 2020 përgjatë kohëzgjatjes së fuqisë juridike të akteve normative të Këshillit të Ministrave në lidhje me përhapjen e COVID – 19 si dhe VKM nr. 243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore", sipas përcaktimeve të mëposhtme:

2.1 Të gjithë klientët aktivë të kategorisë familjare për të cilët është e pamundur aksesimi i sistemit të matjes, do të faturohen me vlerë referuese zëvendësuese me të njëjtin konsum të muajit mars 2019 dhe në vijim me muajt respektivë të 2019 përjashtuar klientët si më poshtë:

a) Që kanë faturim 0 kWh në 3 muajt e fundit e më parë.

b) Kanë ankesë për mbifaturim të energjisë elektrike për muajt për të cilët do të përdoret referenca

c) Kanë bërë ose do të bëjnë kërkesë për pezullim/mbyllje të kontratave të energjisë elektrike në proces, kjo nuk heq detyrimin e OSSH për vazhdimin e procedurës së pezullimit/mbylljes së kontratave sipas legjislacionit në fuqi.

2.2 Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

2.3 Të gjithë klientët aktivë të kategorisë jofamiljarë për të cilët është i pamundur aksesimi i sistemit të matjes, do të faturohen me të njëjtin konsum të muajit mars 2019 dhe në vijim me muajt respektivë të vitit 2019, përjashtuar klientët si më poshtë:

a) Që kanë faturim 0 kWh në 3 muajt e fundit e më parë.

b) Kanë ankesë për mbifaturim të energjisë elektrike për muajt për të cilët do të përdoret referenca

c) Kanë bërë ose do të bëjnë kërkesë për pezullim/mbyllje të kontratave të energjisë elektrike në proces, kjo nuk heq detyrimin e OSSH për vazhdimin e procedurës së pezullimit/mbylljes së kontratave sipas legjislacionit në fuqi.

2.4Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet

bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

2.5 Të gjithë klientët e kategorisë jofamiljare të cilët sipas përcaktimeve të akteve normative që lidhen me COVID – 19, rezultojnë të ndaluar për të ushtruar aktivitetin, sipas publikimeve të Drejtorisë së Tatimeve apo organeve të tjera të evidentuara nga aktet normative, të faturohen për muajin mars 2020 vetëm për një periudhë 15-ditore. Për muajt në vijim të faturohen në bazë të ditëve që do të rezultojnë me aktivitet.

2.6 Për të gjithë klientët me matje on line procesi i faturimit të vazhdojë i pandryshueshëm.

3. Faturimi i konsumit i ambienteve të përbashkëta të vazhdojë i njëjtë për të gjithë kategoritë e klientëve që ju ofrohet ky shërbim.

4. Faturimin e tarifës së shërbimit 240 lekë (përfshirë TVSH) për të gjithë klientët familjarë dhe jo familjarë me konsum 0 kWh.

5. Për klientët me matës të dëmtuar (që kanë rezultuar gjatë faturimit të muajit dhjetor 2019 - shkurt 2020) të vazhdojë faturimi me vlerë referuese sipas këtij vendimi deri në rikthimin e plotë të aktiviteteve.

6. Kur klienti dokumenton mos-konsumim të energjisë elektrike gjatë periudhës së faturimit objekt i këtij vendimi OSSH është e detyruar të bëjë leximin dhe verifikimin e matësit për këta klientë. Fshu do të faturojë këta klientë në baze të leximeve me matje.

7. Diferencat që do të rezultojnë ndërmjet faturimit me vlerë referuese zëvendësuese sipas këtij vendimi dhe vlerës reale të konsumit do të sistemohen brenda muajit të parë të përfundimit të afateve kohore të akteve normative të sipërpërmendura.

8. Raportimin në ERE të gjithë ankesave të klientëve që do të rezultojnë nga aplikimi i kësaj mënyre faturimi, dhe zgjidhjen e tyre brenda një periudhe 10 ditore nga regjistrimi i ankesës duke mbajtur në konsideratë kushtin e pranimit të ankesave online dhe në sportelet e kujdesit të klientit vetëm sipas rregullave të përcaktuara sipas protokollit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, planit të masave të ndërmarra në vendin tonë për ndalimin e përhapjes së pandemisë, si dhe akteve normative për ruajtjen e distancave ndërmjet personave.

9. Pezullimin e përkohshëm të pikës 2 të vendimit të ERE-s nr. 181/2016 "Për disa ndryshime në vendimin nr.104 datë 23.6.2016 të bordit të ERE, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE nr.49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146 datë 24.12.2013"

10. OSSH të marrë të gjitha masat për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit të shoqërisë si dhe në median elektronike e të shkruar për sa është e mundur.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje si dhe të ndjekë ecurinë e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 324/4, datë 6.4.2020

PËR SHPRONËSIM

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit tokë truall dhe ndërtesë që preken nga realizimi nga realizimi i objekteve "Rikostruksioni i shkollës 'Thanas Bozo', ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë", Bashkia Lushnje. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnje.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" dhe të VKM nr. 138 dt. 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së sasës së

shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes Ppblik", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e proçedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale e shpronësimit është 1,930,435 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
DHE KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli

Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i objektit "Rikostruksioni i Shkollës 'Thanas Bozo', Ndërtimi i Palestrës dhe Terrenet Sportive Kolonjë"

Nr	ZK	Nr. i Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja truallit (m²)	Cmimi i truallit (lekë/m²)	Vlera truallit (lekë)	Sip. Ndërtesës (m²)	Cmimi i ndërtesës (lekë/m²)	Vlera ndërtese (lekë)	Vlera totale truall dhe ndërtesë (lekë)	Shënime
1	2207	3//36	Kolonjë Lushnje	Asqeri Çela	100	451	45,100	74	Me situacion	1,885,335.0	1,930,435.0	Shkresa nr. 7272/1 prot. dt. 11/09/2019; Vërtetim Hipotekor dt. 07/08/2019
Total											**1,930,435**	

Shënime:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt.03.02.2016 "Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138 dt. 23.03.2000 "Për Kriteret Teknike të Vlerësimit dhe të Përllogaritjes së Masës së Shpërblimit të Pasurive Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik", i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 532 lekë